



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 4 QERSHOR 2010

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
4. JUNA 2010. GODINE

QERSHOR - JUNI
2010

E premte, 4 qershor 2010, ora 10:00

Drejtton seancën Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë, mund t'i zëni vendet e juaja. Në sallë kemi 72 deputetë.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Po i hapim punimet e seancës së sotme plenare.

Konstatoj se në sallë kemi 72 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 15, paragrafi 3 dhe 42 të Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare, andaj po procedojmë sipas rendit të ditës.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se në bazë të nenit 47 të Rregullores së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta.

Diskutimet e deputetëve janë 3 minuta.

Diskutimet, në emër të grupit parlamentar janë 5 minuta.

Besoj se tani këtë e keni të qartë!

Fjalën e ka Naim Rrustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 maj, ka vendosur që të miratojë një udhëzim administrativ që përcakton që nënshkrimi i këtyre kontratave, përveç nga drejtori i Prokurimit publik, të bëhet edhe nga sekretari i përhershëm, përkatësisht nga zyrtari më i lartë administrativ dhe nga ministri, përkatësisht udhëheqësi kryesor i Agjencisë buxhetore.

Arsyetimi që u paraqit nga kryeministri i Kosovës, përmes diskutimit të tij publik, në seancën plenare të datës 27 maj, ishte se po përpiqet të luftohet korrupsioni dhe që të ndalen praktikat e keqmenaxhimit me rastin e prokurimeve të mallrave dhe shërbimeve në institucionet e Kosovës dhe në ndërmarrjet publike.

Gjithashtu, në të përditshmen "Koha Ditore" të datës 27 maj, zëvendëskryeministri arsyetoi se kjo është bërë së bashku me Komisionin Evropian.

A thua, a janë të vetëdijshëm se kanë bërë shkelje dhe sulm ndaj sundimit të ligjit, me fjalë të tjera, kanë bërë atentat në ligj.

Nuk mjafton ta kishe bërë me dikë dhe të shfajësohesh për mungesë përgjegjësie profesionale për menaxhimin e parasë publike, e sa për përgjegjësi morale as të mos flasim.

Me këtë rast u mor vesh dhe u pranua nga kryeministri dhe zëvendëskryeministri se gjendja në prokurime – blerje nuk është e mirë dhe se ka nevojë për ndërhyrje emergjente në sektorin e prokurimeve, por, një gjë më e madhe ndodhi me këtë rast, u korraptua sistemi.

Me udhëzimin administrativ u zhvleftësua neni i Ligjit të prokurimit publik, saktësisht neni 24, i cili tekstualisht e përcakton se kush është i vetmi – i vetmi person i cili ka të drejtë të nënshkruajë kontratë. Dhe, e citoj nenin 24 “Zyrtari i prokurimit, i një autoriteti kontraktues është i vetmi person i autorizuar që të lidhë ose të nënshkruajë një kontratë publike në emër të autoritetit të tillë kontraktues.”.

Kontrata publike, e nënshkruar nga zyrtari i prokurimit në kundërshtim me këtë nen ose në kundërshtim me një urdhër ose njoftim të marrë nga OSHP-ja një panel shqyrtues ose një gjykatë kompetente, po ashtu është e pavlefshme dhe e pazbatueshme. Gjithashtu, me këtë udhëzim administrativ ka ndodhur që kemi ndërhyrje flagrante në sistem. I janë marrë përgjegjësitë Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, si organ që është përgjegjës që gjatë ushtrimit të funksioneve të saj, sipas nenit 32.2 të Ligjit të prokurimit publik është përgjegjëse për përgatitjen dhe shpalljen e masave të hollësishme zbatuese, të përshkruara në këtë ligj. Masat zbatuese përbëhen nga rregulla, udhëzime, direktiva, dokumente e tjera. Me fjalë të tjera, nuk ka qenë e lejuar që me udhëzim administrativ të ndryshohet ligji. Ligji i ka rregullat e veta, si amendamentohet, si ndryshohet.

Duke mos dashur t’ ju lodh, por edhe të gjithë ata që po na dëgjojnë, ju lutem, zotëri kryetar që t’i ndalni këto praktika ad-hoc.....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, 3 minuta.

(Ndërhyrje)

Kanë të drejtë edhe ministrat në 3 minuta. Lexoni Rregulloren që e keni miratuar vetë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Zoti Rustemi,

Unë i kuptoj këto ndjenjat e diskutimeve që mund të jenë pak populliste dhe i kuptoj edhe ato ndjenja që thuhet atentate e gjëra tjera. Nëse më lejohet, kam një sqarim të shkurtër për ju. E para, është që jemi të interesuar shumë që të bëjmë reformim në pjesën, do të thosha të prokurimit publik në Kosovë, besoj se të gjithë pajtohemi dhe në këtë drejtim jemi duke bërë ndryshime edhe në Ligjin për prokurim publik sipas kriterëve të Unionit Evropian. Sipas nenit 24 që përmendët ju, e harruat pikën 4, ku thuhet që në rastet ceremoniale mund të nënshkruajnë edhe të tjerët. Ky udhëzim administrativ nuk ia humb të drejtën që ta nënshkruajnë zyrtarët e prokurimit publik, por ky udhëzim administrativ e rrit përgjegjësinë e secilit zyrtar politik dhe të tjerëve që mund të jenë në cilësinë do ta quaja të dëshmitarit, po e quaj kështu, në nënshkrimin e kësaj deklarate. Besoj, zoti Rustemi keni durim, toleranca në demokraci nënkupton të kesh durim të dëgjosh dikë çka s’të pëlqen. Dhe mbi të gjitha besoj që kjo nuk ka bërë asnjë shkelje, përkundrazi ka bërë një rritje të përgjegjësisë, shpeshherë në opinionet publike është thënë që ndikimi në procedurat e prokurimit mund të jetë nga niveli politik, ndërsa përgjegjësia mbetet te dikush tjetër. Kësaj radhe, përveç ata që kanë pasur deri më tani, po e them prapë, nuk largohen nga përgjegjësia ata që kanë qenë deri më tani, por rritet përgjegjësia edhe e të emëruarve politikë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ju duhet ta dini, këto janë vetëm deklarime, fjalë hava, po urdhëroni flisni, shfrytëzoni 3 minuta.

Fjalën e ka deputetja Drita Maliqi.

DRITA MALIQI: Faleminderit!

Zoti kryetar i Kuvendit, e mora fjalën ta ngris një shqetësim, që ditëve të fundit i ka preokupuar shumë qytetarët e Gjilanit, me rrethinë dhe gjithë qytetarët e Kosovës. Humbja e jetës së një 14 vjeçari në mënyrë tragjike nga ana e një bashkëmoshatare të tij, është më tepër se rast tragjik dhe alarm për institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës. Po flas në radhë të parë si punëtore e arsimit, por edhe si deputete e Kuvendit të Kosovës.

Të nderuar, kërkoj nga ju zoti kryetar, kryeministër, ministër i Arsimit, i cili që 3 muaj nuk është këtu dhe ministër i Punëve të Brendshme, ministër i Drejtësisë, që deri më shtator kur të fillojë viti i ri shkollor, të hartohet një plan emergjent i veprimit për t'i parandaluar njëherë e përgjithmonë këto raste shqetësuese me përfundime tragjike dhe urgjentisht t'i fillojmë procedurat për hartimin e një ligji shumë rigoroz kundër delikuentëve, në mënyrë që siguria e fëmijëve tonë nëpër shkollat e Kosovës të jetë e nivelit që fëmijët të ndihen mirë, të sigurt dhe të mësojnë dhe të edukohen ashtu si duhet dhe jo të traumatizohen nga rastet e tilla tragjike.

Sa për njoftim, të nderuar zonja dhe zotërinj dhe opinionit në Gjilan, pas Vitit të Ri, gjatë këtij viti, domethënë, tre fëmijë kanë vdekur nga rastet e tilla tragjike, si rasti i fundit i cili ndodh më 1 qershor 2010 në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit, pesë minuta i ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar,

Janë deklarime të deputetëve dhe të mos krijojmë përshtypjen që e kemi edhe replika të ministrave se atëherë vetëm priset arsyeja pse e kemi sjell këtë rregullore.

Sidoqoftë dy tema Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, do t' i ndajë me ju. Tema e parë është diçka që ka qenë dashur kryetari i Kuvendit ta bëjë vetë, ajo është t' i thotë ministrit të Financave: mos e fyej Kuvendin. Edhe po ju tregoj qysh. Në vend se të vijë ministri i Financave të na thotë neve: unë kam dështuar t' ju shpjegoj juve, të nderuar deputetë, përfaqësues të popullit se ky vetë s' është, ne jemi, ky ka ardhur e ka thënë: deputetët s' po marrin vesh dhe s' e kanë ditur çka kanë bërë kur kanë votuar kundër kredisë, e ky ministri nuk i ka marrë as dy minuta t' iu shpjegoj deputetëve se pse është kaq e rëndësishme kjo çështje. Do të thotë për këtë s' ka qenë hiq e rëndësishme, e ne ka qenë dashur ta vetëkuptojmë diqysh sa e rëndësishme është të marrësh kredi kur në të njëjtën kohë mjetet tona të buxhetit i nxjerrim jashtë. Kjo është çështja e parë, çështja e dytë ka të bëjë me kulturë të komunikimit, me popullin, se të mirë e të këqij ne jemi populli. Kur komunikim me popullin duhet të paktën ta kesh minimumin e kurtuazisë dhe të thuash po ju kërkoj ndjesë ndoshta nuk kam mbërri t' ju shpjegoj, po provoj edhe një herë e jo me thënë jeni të papërgjegjshëm dhe po i shkaktoni vendit humbje ekonomike. Sa për humbje ekonomike, për pengesë të investimeve, për mos thithje të donacioneve që i ka përmendur ministri, po ju them diçka. Nuk janë fajtorë as populli as përfaqësuesit e tij në Kuvend, fajtor është Qeveria dhe nëse donë ta dijë kush po e shkatërron vendin, unë ju kisha sugjeruar ta marrin një pasqyre dhe ta shohin veten natje për çdo ditë, për çdo ditë sa herë t' i çelin sytë ta shohin vetën mirë dhe të kuptojnë kush po e shkatërron vendin. Pra, nëse s' ju mjafton pasqyra mund ta bëjnë një fotografi të përbashkët, por ta thërrasin edhe kryeministrin në mes të dalë ai, të dalë në fotografi ta vjerr në mur dhe të shohë se çka janë duke i bërë vendit, ta shohin veten, jo deputetët. Çështja tjetër ka të bëjë me diçka që e kam thënë një herë në këtë Kuvend të Kosovës, po e them edhe një herë. Kjo kulturë qeverisëse ka filluar të shpikë armiq të jashtëm dhe të brendshëm dhe në vend që ta këqyr veten për problemet që i kanë, këta njerëz e gjejnë fajtorin ose te bashkësia ndërkombëtare ose te opozita, domethënë e gjejnë fajin në kojshi, po ju them qysh ka thënë Zoti, zoti kryetar: Këqyre veten, këqyre veten,

këqyre veten, tri herë, gjeje fajin te vetja, mos e gjej fajin të tjerët, mos shpik armiq të brendshëm dhe të jashtëm se kjo logjikë ka mbaruar diku që një 25 vjet. Çështja e fundit, është kjo, që ka të bëjë me logjikën e dy të parave që i thash. Kur një pushtet nuk e ka më as minimumin e mundësisë të dëshmojë që nuk është i korruptuar çfarë është ky pushteti pas meje, çka duhet bërë atëherë, duhet provuar ta bind botën që krejt janë njësoj, që krejt janë hajna dhe me ia qitur faqen e zezë vendit edhe për së dyti, domethënë edhe arushat e malit po e dinë që kjo qeveri është e korruptuar, tash çka me bë, qysh ta shpëtosh lëkurën e vet, duhet thënë krejt botës që shqiptarët janë të korruptuar kështu e ashtu, në gjen e kanë, tanë janë njësoj, çka jeni tekur te ne, çka po na gjuheni neve, kushdo që vjen tanë janë njësoj? Kjo është faqja e dytë e zezë që po ia qesin këta njerëz vendit se e kanë strategji tash të dëshmojnë që krejt janë njësoj. Mbani mend popull se ju jeni populli, që këta njerëz tash e kanë strategji të thonë që krejt shqiptarët janë të këqij, nuk jemi veç ne, mos u tekni te ne, tanë njësoj janë. E unë dua t'ju them juve sot, s'janë krejt shqiptarët të këqij, nuk janë krejt shqiptarët hajna, jeni ju edhe nuk keni nevojë për të provuar edhe një herë më zi ta bindni botën që krejt jemi njësoj. Faleminderit!

KRYETARI: Këto janë deklaramë, është mirë secili ta shoh veten.

Fjalën e ka deputeti Rexhep Hoti.

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryetar,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Samiti i BE-së, Ballkani Perëndimor ma kujton thënien e Faik Konicës, i cili tha – shqiptarët në shtet, pozitë dhe opozitë, kur është në pyetje politika e jashtme duhet të ketë një qëndrim. Më lejoni në këtë rast të veçoj disa suksese që u quajtën edhe triumfi i diplomacisë së shtetit të Kosovës në samitin e BE-së, vendet e Ballkanit Perëndimor në Sarajevë, shënoi një sukses të institucioneve të Kosovës dhe të politikës dhe subjekteve të Kosovës. U arrit që Samiti i Sarajevës me qëndrime të prera e me këmbëngulje se shteti i Kosovës domosdo duhet të trajtohet i barabartë me shtetet e tjera në Evropë.

Me këtë rast dua të veçoj, e para dhe më e rëndësishmja që duhet shkoqitur është, në samitin e Sarajevës 27 vendet anëtare të Bashkimit Evropian, pra edhe 5 shtetet që deri më tani nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, në mënyrë informale apo në mënyrë të heshtur, në fakt e pranuan shtetin e Kosovës dhe kjo sigurisht që e përshpejton jo vetëm qarkullimin e lirë të qytetarëve të Kosovës në vendet e BE-së, por edhe të gjitha proceset integruese drejt Bashkimit Evropian.

E dyta, shefi i diplomacisë franceze Bernard Kouchner, shteti i të cilit përfaqëson një prej shtyllave të Evropës sot, i bëri të qartë Beogradit që përpara samitit që me shtetin e Kosovës nuk do t'i lejohet më të sillet ashtu si është sjell deri më tani dhe kjo u zbatua drejtpërdrejt në Samitin e Sarajevës.

E treta, diplomacia e Kosovës kurrë nuk ka qenë agresive ndaj asnjë subjekti tjetër ndërkombëtar, pra as ndaj Serbisë, por në Samitin e Sarajevës u dëshmuua se politika bashkëpunuese gjithherë ka përparësi ndaj politikës së jashtme agresive. Shteti ynë me hapa të sigurt shkon drejt rrumbullakimit si subjekt i barabartë në arenën ndërkombëtare dhe kjo nuk është një çështje që s'duhet vënë re edhe para opinionit të gjerë edhe para Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe meqë kam kohë pjesën e parë të diskutimit e Ardian Gjinit e mbështes plotësisht kur tha se nuk është kushtuar kujdes në nivel i Qeverisë ndaj huas që nuk u aprovua. Ju falënderoj shumë.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, predsedniče!

Dozvolite da pozdravim ovoga puta i dosta brojan sastav kabineta premijera. Ja obaveštavam ovo telo da je na jučerašnjem sastanku Komisije za prava i interese zajednica došlo do jednog incidenta, u kojem je jedan član te iste komisije napao drugog člana Komisije i to fizičkom pretnjom u prisustvu svih članova komisije, a potom i u prisustvu predstavnika međunarodne zajednice, dakle međunarodne misije. Međutim, za to nisu postojali nikakvi razlozi, to nije neparlamentarni rečnik, nego nedozvoljeno ponašanje. Na insistiranje člana Komisije za prava i interese zajednice iz koalicije Vakaf, odnosno “7+” i predsednik komisije reagova je, međutim i predsednik je bio uvređen. Mi smo danas imali sastanak Parlamentarne grupe na kome smo doneli odluku da ukoliko Skupština i drugi relevantni faktori ne reše ovaj problem i ne preduzmu mere analogno našim zakonima, mi nećemo do daljnjeg prisustvovati na sastancima Komisije za prava i interese zajednice, gde Parlamentarna grupa “7+” ima dakle četiri člana. S toga vas molim, predsedniče, nakon pismene primedbe koju dobijate od naše grupe i od samog predsednika komisije, da se preduzmu odgovarajuće mere kako bi smo nastavili ili pak bojkotovali rad Komisije za prava i interese zajednica. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryetar i Kuvendit, Zëvendëskryeministër, ministra dhe deputetë të nderuar, Do të apostrofoj një preokupim timin të përfutur nga kontaktet me qytetarë në zyrën e kontaktit në komunën e Pejës dhe ai konsiston në këtë fakt. U mor vesh se krejt Kosova ka qenë dëmtuar rënd në persona dhe në materiale. Peja, komuna e Pejës është evidentisht më e dëmtuara materialisht. Është një numër i madh i qytetarëve të Pejës dhe rrethinës të cilët janë krejtësisht të pa përkujdesur, të pastrehë mbi kokë dhe do të kisha shfrytëzuar këtë oportunitet për të apeluar në Qeverinë që të ndërmerr atë që mund ta ndërmarrë dhe t’i ndërtojë disa objekte banesore, sociale, do të bëhej një punë e mirë, e dobishme dhe e justifikueshme edhe nga aspekti social edhe humanitar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Kabinet qeveritar,

Unë në këtë rast mendoj të ngre dy çështje, për mendimin tim shqetësuese, e para ka të bëjë me një konstatim tashmë publik dhe të konstatuar edhe nga faktorët e rëndësishëm rreth 100 mijë lëndëve që gjyqësori i Kosovës, domethënë, i ka bllokuar. Dhe në këtë rast unë i isha drejtuar ministrit të ri që megjithatë ky segment, me rëndësi të shtetit të Kosovës duhet të funksionojë dhe të marrin masa qeveria që të bëjë një pako ligjesh e cila do ta zhbllokojë këtë situatë e cila megjithatë është konstatim i të gjithëve se kjo shtyllë faktikisht i ka zënë frymën zhvillimit të Kosovës në të gjitha porët e jetës. Gjithqysh unë këtë pako ligjesh që mendoj të bëhet rreth gjyqësorit të përcjellët edhe me rastin e rishikimit të buxhetit në një mbështetje financiare, sepse faktikisht konstatimet rreth gjyqësorit veç tash janë të njohura edhe nga sondazhet si segment më i korruptuar në Kosovë dhe ne nuk mund të pretendojmë si shtet i ri të ecim para deri sa këtë segment e kemi në gjendje katastrofale. Ajo që është shqetësuese që unë mendoj që Parlamenti megjithatë duhet ta japë fjalën e vet është edhe çështja e stemës së Lidhjes së qytetit të Prizrenit, ku identifikohet me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, unë kam tentuar dhe më herët ta ngre këtë çështje edhe pse kryetari i Parlamentit nuk ma ka dhënë fjalën dhe ne qytetarët e Prizrenit, por edhe më gjerë, me të drejtë janë të shqetësuar rreth këtij vendimi të njëanshëm për mendimin tim të gjykatës. Unë jam i vetëdijshëm si të gjithë qytetarët se Gjykata Kushtetuese e ka rolin që e ka, mirëpo nëse Gjykata Kushtetuese nuk i jep përgjegjësi kurrkujt, atëherë shtrohet pyetja çka është Parlamenti. Në fakt unë në këtë rast zotin Krasniqi dhe të gjithë deputetët i kisha ftuar, më 10

qershor edhe pse është caktuar seancë e Parlamentit, të marrin pjesë në protestat që organizohet në Prizren për ta mbrojtur, domethënë këtë vlerë të shenjtë të popullit shumicë në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit edhe për ftesën!
Fjalën e ka deputeti Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Deputetë,

Unë dua t'ju njoftoj se pas një vizite që kam pasur javën e kaluar në Senatin e Republikës së Italisë, në një konferencë që kemi marrë pjesë, e dini ju zotëri kryetar se ju kam njoftua, edhe anëtarët e Kryesisë, këtu dua të ngre çështjen e aktivizimit edhe më të madh të diplomacisë parlamentare ku ka të bëjë me çështjen e ngritjes së njohjeve për Kosovën dhe anëtarësimin e Kosovës në mekanizma ndërkombëtarë që janë të rëndësishëm. Në Itali kemi iniciuar siç e dini formimin e shoqatës në mes Senatit Republikan Italian dhe Parlamentit të Kosovës. Këtë e ka premtuar zëvendëskryesuesja e Senatit, zonja Ema Bonina dhe Marco Perduca, ka marrë obligim që të bëjë listën e senatorëve italianë që do të jenë në Shoqatën e Miqësisë me Parlamentin e Kosovës. Kërkoj të njëjtën gjë ta bëjë edhe Kryesia që ta përgatisim këtë themelim të shoqatës në muajt në vazhdim. Njëkohësisht me ndihmën e miqve italianë është iniciuar formimi i të njëjtës shoqatë me Parlamentin Spanjoll, që mendoj është e rëndësishme për Kosovën. Mendoj që edhe Kryesia e Kuvendit, Komisioni për Politikë të Jashtme dhe ai për Integritet duhet të jenë aktivë që të iniciojnë formimin e grupeve të miqësisë, në mes vendimeve të ndryshme, posaçërisht parlamenteve dhe shteteve që ende s'e kanë njohur Kosovën, sepse kjo do ta përshpejtonte sadokudo procesin e njohjeve.

Njëkohësisht do të kërkoja edhe nga Ministria e Drejtësisë që të na sjell çështjen e ratifikimit të Traktatit për Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut. Mendoj që është mirë Kosova të jetë pjesë e të gjitha mekanizmave ndërkombëtarë ku janë anëtarët e të gjitha shteteve të Kombeve të Bashkuara dhe të mos mendojmë që e kemi zgjedhur në rast se janë disa amendamente në Kushtetutë, sepse ratifikimi i traktateve është procedurë që duhet të ndiqet përmes parlamenteve. Thjesht në këtë njoftim që e bëra para Kuvendit, kërkoj që të jetë vëmendja e konsideruar edhe të gjithë deputetëve, komisioneve përkatëse, sepse çështja e njohjeve, çështja e anëtarësimit të Kosovës në mekanizmat ndërkombëtar, mosmbetja e Kosovës vrimë e zezë në Ballkanin Perëndimor, është preokupim për të gjithë dhe konsideroj se të gjithë do ta japim kontributin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje Kabinetit qeveritar.

Të nderuar deputetë,

Është shqetësuese për mua dhe për shumë qytetarë dhe fshatarë nëpër Kosovë ku KEK-u ua ndërprente rrymën në mënyrë kolektive qytetarëve. Kjo që ka ngjallur shqetësim pikërisht ne na thërrasin vazhdimisht nëpër telefona të intervenojmë ose të ndikojmë nëpër organet e ndryshme të KEK-ut pikërisht t'ia lëshojmë rrymën. Është shqetësuese se për një person që nuk paguan rrymë ose një familje që nuk paguan rrymën të dëmtohen familjet tjera që e paguan rrymën. Për dëmet që u bëhen familjeve të cilat e kanë paguar rrymën, kurrkush nuk e merr përgjegjësinë... ndërsa shkyçja kolektive është gjëja më e dëmshme që ka ndikuar deri më tash nëpër Kosovë dhe në fshatrat tona. Unë kam kërkuar disa herë, po edhe tash kërkoj nga Kuvendi

dhe nga Kabineti qeveritar, edhe nga Qeveria komplet që ta hartojnë strategjinë ose ta ndryshojnë këtë strategji dhe të shkojnë në shqyçje individuale e jo kolektive, sepse kjo është dëmtimi më i madh që i bëhet qytetarëve në Kosovë. Ka pasur rast para do dite, është bllokuar rruga Prizren – Gjakovë dhe ka pasur nxënës që u ka rënë të fikët pikërisht nga shqyçjet kolektive që i kanë bërë dhe banorët kanë dalë, ua kanë bllokuar rrugën. Kërkesë e banorëve është që të shkojnë në shqyçje individuale, ata që e paguajnë le të kenë rrymë, ata që s’e paguajnë mos ta kenë rrymë. Prandaj kërkoj edhe një herë nga Qeveria që nëse ka mundësi ta bëjë strategjinë edhe Ministria e Energjisë edhe Ministria e Financave edhe kabineti i Qeverisë dhe kryeministri që kjo strategji të ndryshohet, sepse kjo po na shkakton dëme dhe kokëçarje vazhdimisht nëpër fshatra. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Driton Tali e ka fjalën!

DRITON TALI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Kjo është hera e dhjetë që unë kërkoj nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës, që garancionin bankar prej 16.200.000 eurove, të cilën e pati paguar fituesi i tenderit për operatorin e dytë mobil, ta marrin nga ART-ja, pra nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit dhe ta dorëzojnë në Departamentin e Thesarit, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, aty pra ku e ka vendin.

Por, deri më tani as Qeveria e as Kuvendi nuk ndërmorën asgjë në këtë drejtim. Bile javën e kaluar e luta edhe EULEX-in që të na ndihmojë, por edhe EULEX-i nuk bëri asgjë, të paktën jo publikisht. Me siguri se EULEX-i është i zënë me “peshqit e mdhenjë” të cilët kanë keq menaxhuar me më shumë se 16 milionë e 200 mijë euro, andaj EULEX-it 16 milionë e 200 mijë euro i duken pak.

Prandaj, pasi që as Qeveria e as Kuvendi, për të cilat siç po shihet se më të vlefshme janë rreth 20.25 milion dollarë apo rreth 16.6 milionë euro prej të cilave rreth 9.2 milionë euro janë kreditë me kamata të buta, kurse 7.4 milion euro grante, pra rreth 16.6 milion euro më të rëndësishme, përsëri po them, të cilat duhet kthyer mbrapa dikur dhe disi sesa 16 milionë e 200 mijë euro, të cilat sipas ministrit të Ekonomisë dhe Financave gjenden në ART që 3 vite e 4 muaj.

Duhet cekur se për këto 16 milionë e 200 mijë euro askush nuk paguan kamatë për mbajtjen e tyre, gjersa për kredinë për të cilin aq shumë insiston Qeveria dhe ministri Shala Kosova do të paguaj kamatë, siç thonë ata - kamatë të butë. Derisa, edhe një herë po e ceku, se për këto 16 milionë e 200 mijë euro kurrfarë kamate nuk është paguar deri më tani - as e butë e as e lehtë.

Të nderuar qytetarë, pasi që as EULEX-i nuk mundi që çekun ta marrë nga ART-ja, unë do ta lusja z. Peter Feith, përfaqësuesin civil ndërkombëtar, si instancën më të lartë, post të cilin e emëroi ky Kuvend i nderuar më 12 shkurt të vitit 2007, që konform kompetencave të veta të ndërhyjë dhe dorëzojë çekun në Thesar. Mundësisht ta kërkojë edhe kamatën prej 6 shkurtit të vitit 2007 nga personat të cilët e kanë mbajtur dhe e mbajnë sot e kësaj dite këtë çek, krejtësisht në kundërshtim me ligjin.

Pra, zoti Feith, po ju drejtohem juve: Nuk është ndonjë mundim i madh, krejt se çka ju duhet zotëri për të bërë është që të shkoni në selinë e ART-ës dhe ta merrni çekun i cili është aty. Se, është aty çeku i 16 milionë e 200 mijë eurove s’ka dilemë, sepse ashtu pati deklaruar ministri Shala, i cili, unë jam i bindur se nuk do të deklaronte ashtu sikur mos të ishte.

Unë nuk besoj, dhe nuk dua të besoj, që ministri i Ekonomisë dhe Financave e ka dezinformuar opinionin, për mos thënë e ka gënjer apo rrejt siç themi ne kosovarët rrejt, sepse gënjeshtria dhe mashtrimi nuk janë në personalitetin dhe etikën e ministrit, por as në etikën e kësaj Qeverie e cila është betuar se do ta luftojë korrupsionin me mish e shpirt. Bile, edhe “zero tolerancë”, siç e dini e kanë zgjedhur sloganin.

Andaj, Zoti Feith, ju lutem, t’i ndihmoni Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës sepse kanë nevojë për ndihmën tuaj!

Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Veç ke harruar edhe një adresë të kërkuar ndihmë!
Fjalën e ka deputeti Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti kryetar! Do të vazhdoj në gjuhën turke.
Saygıdeğer bakanlar, değerli Meclis arkadaşlarımız, sözü almamın sebebi Kosova Demokratik Türk Partisi milletvekilleri adına ve Türk topluluğu adınadır. Malumunuz Prizren Kosovanın bir aynasıdır, yüzyıllardır Prizrende tüm topluluklar birlik ve beraberlik içinde yaşamışlardır ve yaşamaya da devam edeceklerdir. Dolayısıyla Türk topluluğu Boşnak topluluğu, Rom topluluğu ve diğer topluluklar Kosovanın yapılanmasında ve Kosova kurumlarının güçlenmesinde çok önemli bir rol oynamıştır. Ne mutlu bizlere ki bu yapılanma çerçevesinde Kosova Cumhuriyeti Anayasa Mahkemesi de tarafsız tavırlarını ortaya sergilemektedir. Dolayısıyla Prizren belediyesindeki sorunların bundan böyle de yasalar doğrultusunda başta Türk topluluğu başta olmak üzere tüm toplulukların haklarını koruyacak şekilde, logo başta olmak üzere bütün konularda yasaların uygulanacağından eminim. Türk topluluğu ve diğer topluluklar olarak da bundan böyle de Kosovanın yapılanmasına katkı sunacağız.

Teşekkür ederiz.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami!

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Kolegë deputetë,

Do të ngriti një çështje parimore që mund të jetë me rëndësi për aktivitetin legjislativ të Kuvendit të Kosovës. Vitin e kaluar Kuvendi i Kosovës kur ka shqyrtuar projektligjet organike siç është projektligji për të drejtat e deputetëve, për qeverinë dhe projektligji për kryeqytetin e Prishtinës, ka marrë një qëndrim parimor të harmonizuar me kryesinë e Kuvendit dhe me grupet parlamentare që këto tri projektligje organike të shqyrtohen në pako dhe të miratohen për shkak se këto ligje dalin drejtpërdrejtë nga zbatimi i Kushtetutës dhe në Kushtetutë është një afat brenda të cilit duhet të miratohen ligjet organike. Unë dëshiroj të përsëris që sot do të diskutojmë Projektligjin për të drejtat e deputetëve, po kërkoj nga Kryesia e Kuvendit dhe nga Qeveria e Kosovës që të bëjnë përpjekje që edhe këto dy projektligje tjera, sidomos Projektligji për Qeverinë, i cili është i gatshëm dhe ka një vit që po pret miratim dhe Projektligji për kryeqytetin të harmonizohen në mënyrë që t’i miratojmë para pushimeve vjetore të kësaj legjislature. Miratimi i këtyre dy projektligjeve do të ketë një inpakt të drejtpërdrejt në Raportin e progresit, sepse raporti i progresit ka pasur kërkesa eksplicite që këto projekte të miratohen nga Qeveria. Në anën tjetër me miratimin e këtyre dy projektligjeve të mbetura, pra për Qeverinë dhe kryeqytetin ne e përmbushim një detyrim kushtetues që lidhet me përgatitjen dhe draftimin e legjislacionit organik, aq më parë kur ne kemi miratuar ligjet sa i përket gjyqësorit, ligjet tjera organike dhe sa e di unë kanë mbetur këto dy ligje organike të cilat ende i mungojnë Kosovës

dhe me një përpjekje të shtuar, sidomos të ligji për kryeqytetin do të tejkalohen problemet dhe mendoj se do të ishte një sukses i madh i kësaj legjislature që para pushimeve verore t'i debatojë këto dy projektligje.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri. Në emër të Grupit apo...?

ISMET BEQIRI: Jo, me 3 minuta, më pak se 3 minuta! Jo në emër të Grupit.

Po është thënë qëndrimi më herët dhe mund të them se në një formë është edhe mendim i Grupit, por këtë e tha që në këtë renditje zoti Bajrami. Edhe një herë po e përsëris kërkesën dhe qëndrimin që ka qenë i Grupit Parlamentar për Projektligjin për Prishtinën.

Po ju lus, absolutisht konsiderojmë që janë të tejkaluara dhe ka asnjë pengesë që ky projektligj të miratohet dhe ato arsyetime që kanë qenë vazhdojnë të mbeten të paqëndrueshme, prandaj po e përsëris zotëri kryetar kërkesën e cila është edhe e mëhershme dhe qëndrimin tonë – të Grupit që ky projektligj të vjen në Parlament për miratim. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar! E mora fjalën pas shumë bisedave me punëtorët shëndetësorë, me përfaqësuesit e udhëheqësve të qendrave të mjekësisë familjare nga shumë komuna të Republikës së Kosovës, dihet se vitin e kaluar për një marrëveshje për 44 euro të shkreta u patën involvuar edhe presidenti i vendit, kryeministri dhe ministri i shëndetësisë, ministri aktual nuk ka qenë i involvuar, mbi 60% të punëtorëve shëndetësorë në komunat e Republikës së Kosovës nuk i kanë marrë këto mjete. Ka komuna që i kanë marrë për janar dhe shkurt dhe ka komuna që janë më mirë, por ai premtim nuk është mbajtur. Kam biseduar edhe me përfaqësuesit e Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës, të cilët paralajmërojnë tani edhe protesta edhe mjete të tjera që po e dëmtojnë dhe rëndojnë në radhë të parë gjendjen e rëndë të pacientëve të lodhur të Kosovës, mos të flasim për një sistem shëndetësor që këto vite të pavarësisë e kemi degraduar vetë. Andaj kur jepet fjala publike e krerëve institucionalë dhe aq më keq kur qitet nënshkrimi në letër dhe iu premtohet mjekëve që është një shtyllë e përkujdesjes shëndetësore po edhe një shtyllë e shtetit dhe nuk iu mbahen premtimet, atëherë çfarë shteti, çfarë qeverie dhe çfarë përgjegjësie institucionale? Kemi përgjegjësi edhe ne si deputetë që t'i obligojmë në radhë të parë krerët institucional, në këtë rast kryeministrin dhe Ministrinë e Shëndetësisë, por edhe ministrin e Pushtetit Lokal të ndikojë me autoritetin e tij dhe konform normativave që janë me ligjet për rregullimet e pushtetit lokal, të ndikojë te ata njerëz të papërgjegjshëm që po luajnë me dinjitetin e punëtorëve shëndetësorë. Vërtet është tepruar. Premtojmë, nënshkruajmë, nuk zbatojmë dhe kredibiliteti i institucioneve po bie çdo ditë. Kërkoj që ministri aktual i Shëndetësisë, ministri i Ekonomisë dhe i Financave, ministri i Pushtetit Lokal, të marrin hapa konkret që ai premtim i nënshkruar, ajo marrëveshje e nënshkruar institucionale, sepse atëherë mjekëve të Kosovës dhe punëtorëve shëndetësorë nuk po u mbetet tjetërkund të drejtohen

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Për seancën e radhës kanë mbetur, do ta kenë fjalën në fillim të seancës: Gani Geci, Flora Brovina dhe Gjylnaze Sylja. Vazhdojmë me pikën e radhës.

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta.

Fillojmë me pyetjen e parë. Deputeti Rexhep Hoti, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar.

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Duke pasur parasysh faktin që prej detyrimeve të rëndësishme për të hyrë në Bashkimin Evropian është edhe ndërtimi i impianteve bashkëkohore për trajtimin e ujërave të zeza në të gjitha vendbanimet në Kosovë, me popullatë mbi 10 mijë banorë, gjithashtu duke pasur parasysh edhe mundësinë e derdhjeve të ujërave të zeza, kryesisht nëpër lumenj dhe eksploatimi jo i rregullt i zhavorrit, i nderuar ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ju lutem na thoni- a ka Ministrisë projekte të tilla, nëse po kur priten të zbatohen dhe pse në Skenderaj është i ndërtuar, sa kemi ne informacione impiantin dhe nuk po funksionon atje? Faleminderit shumë!

Drejtimin e seancës e merr zoti Naim Maloku, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit!

I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

I nderuari deputet Rexhep Hoti,

Së pari dua të falënderoj për pyetjen tuaj dhe desha t' ju njoftoj se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit i Hapësinor, për ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza që në vitin 2004 – 2005, ka kryer studimin e fizibilitetit për trajtimin e ujërave të ndotura në regjionin e Prizrenit, të financuara dhe implementuara nga Banka Gjermane- KfV-ja.

Ndërsa, në vitin 2009 – 2010 është kryer studimi i fizibilitetit për trajtimin e ujërave të zeza për shtatë qendra të mëdha të Kosovës: Prishtinë, Pejë, Gjiilan, Gjakovë, Ferizaj, Prizren. Projekti është në procedurë zbatimi.

Në vitin 2010 – 2011 është duke u implementuar projekti për kadastrën e ujërave të ndotura në nivel shtetëror dhe të financuar nga Qeveria finlandeze dhe implementuar nga..... Projekti është në procedurë zbatuese prapë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit.

Sa i përket infrastrukturës ekzistuese vlen të theksohet se impianti për trajtimin e ujërave të ndotura në Skenderaj është ndërtuar në vitin 2006 me përkrahje të AER-it, por problemi ende ekziston, problemi është te kompensimi i një parcele dhe besojmë se edhe kjo çështje do të rregullohet së shpejti, por është problemi te shpronësimi ose rregullimi i parcelës private.

Gjithashtu, ekzistojnë edhe projekte në kompleksin industrial “Trepça” dhe ekzistojnë edhe projektet tjera si në KFOR-in Amerikan, në Bonstil, por në këtë periudhë gjithashtu përmes përkrahjes së Komisionit Evropian janë disa projekte për disa komuna, si komuna e Deçanit, Junikut, Lipjanit dhe fshatit Skivjan në Gjakovë, i cili është financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, në bashkëpunim me Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Keni pyetje shtesë, deputet? Jo. Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet për pyetje deputeti Adem Hajdaraj.

DRITON TALI: Zoti kryesues,

Unë e kam pyetjen për ministrin e Shëndetësisë, zotin Bujar Bukoshi, që ke këtu e s'di ku shkoi.

Ka të bëjë me këtë tokën që i është uzurpuar apo që i është tjetërsuar QKUK-ës, vlera sillet rreth 20 milionë euro. Janë 6 hektarë dhe s'di, ndoshta po i duken pak atij. Këtu ke që pak para, por po çuditem ku humbi!

Po e pres, ndoshta vjen gjatë seancës. S'është pyetje e tij direkte, është e qeverive të mëparshme.

KRYESUESI: Ju mund ta shtroni pyetjen zoti deputet, se nuk ua jap fjalën më për këtë pyetje.

DRITON TALI: Jo, unë prej tij e pres këtë përgjigje.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Adem Hajdaraj, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi, apo ministrin Enver Hoxhaj.

Doni të parashtroni pyetjen zoti deputet? Fjalën e ka deputeti Adem Hajdaraj!

ADEM HAJDARAJ: Zoti kryesues,
Edhe unë mendoj se duhet ta shtyjmë për mbledhjen tjetër, për seancën e ardhshme.

KRYESUESI: Mirë. Deputeti Gani Geci, pyetje për ministrin Lutfi Haziri. Nuk është deputeti këtu.

Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Doni të lexoni pyetjen, deputet? Deputeti Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Ju faleminderit, kryesues!
Pyetja ime ka pasur të bëjë me zgjedhjet serbe në pjesën veriore të Kosovës, meqë unë atë ditë mendimin tim e kam shprehur përmes diskutimit, heq dorë nga pyetja ime.

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet! Deputetja Myrvete Pantina, pyetja për ministrin Nenad Rashiq.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!
Pyetjen që do ta lexoj sot, i nderuar ministër Rashiq, e kam parashtruar më herët para disa muajve në këtë Kuvend, por jo juve.
Pasi që nuk kam marrë përgjigjen në kërkesë të një grupi të qytetarëve që ka të bëjë me këtë pyetje, do ta lexoj edhe një herë dhe shpresoj se kësaj radhe nuk do të mbetem pa përgjigje. Me datën 23 të muajit të tetë të vitit 2001 është lidhur marrëveshja për kompensim të përkohshëm të pagës për ndërprerje të marrëdhënies së punës në mes të Korporatës Energjetike të Kosovës dhe 450 punëtorëve të KEK-ut, të cilët ishin lënduar në vendin e tyre të punës. Në bazë të kësaj marrëveshje, KEK-u ka për obligim që 45 të pensionuarve invalidorë t'u paguajë 105 euro pension në muaj deri në ditën e fillimit të funksionimit të Fondit mbi sigurimin pensional invalidor. Por, prej shtatorit të vitit 2006, 223 pensionistëve invalidorë të KEK-ut u është ndërprerë paga, derisa të tjerët vazhdojnë të marrin pagën sipas marrëveshjes deri në ditët e sotme.

Zoti ministër, pensionistët invalidorë të KEK-ut, të cilëve u është ndërprerë pagesa e pensionit, pyesin se pse marrëveshja e lidhur në mes të KEK-ut dhe 450 punëtorëve të KEK-ut nuk vlen për të gjithë pensionistët invalidorë të KEK-ut në mënyrë të njëjtë? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ministër, e keni fjalën!

MIINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Poštovane kolege ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Gospodjo Pantina,

Moram da napomenem da je ovo jedan slučaj koji je možda, da kažem, vrlo vanredan, odnosno jedan od slučajeva koji se dešavaju ad-hoc u određenim momentima. Samo da naglasim nešto da nisu svi invalidi rada obuhvaćeni u ovoj grupi za kompenzaciju, a sa druge strane moram da napomenem da je to jedna slučaj koji se desio sporazumom između KEK-a i tih radnika, tako da mi kao Ministarstvo, na žalost, na žalost kažem, nemamo instrumente koji bi mogli da pravno nateraju ili da bilo koju od strana obavežu da ispoštuje svoj deo dogovora i ja znam da je slučaj čak došao i do Ustavnog suda, da Ustavni sud treba da rešava to. Mi tehnički i pravno-tehnički gledano, nemamo nikakvu nadležnost zbog toga što, opet kažem nažalost, Zakon za invalidno i penziono osiguranje nije još na snazi, nije još prihvaćen u Parlamentu, tako da ćemo morati svi mi zajedno da sačekamo odluku Ustavnog suda. Mi smo kao Ministarstvo dali svoj doprinos, naši stručnjaci su bili pozvani na predstavljanje slučaja pred Ustavnim sudom i mislim da smo to uradili onako kao što je i trebalo, odnosno sa pravnim aspektima i u tome mi nemamo stvarno neke velike ingerencije, opet kažem na žalost, ali ja verujem da će Ustavni sud da donese pravu odluku i na osnovu te odluke, kroz Zakon o penzijama, o penzionom sistemu koji će biti donešen, nadam se vrlo skoro ćemo imati prvi draft, u stalnom smo kontaktu sa Svetskom bankom i ekspertom koji radi na tom zakonu, prema tome očekujemo u ovom konkretnom primeru neke pomake, naravno kad se bude taj sam zakon prezentovao, kada budete vi usvojili zakon i možda posle toga možemo i da budemo mnogo dinamičniji i konkretniji u vezi ovog slučaja.

U međuvremenu mi nemamo, stvarno nemamo instrumente pravne da bi mogli da reagujemo u ovom slučaju. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Keni pyetje shtesë, deputete? Jo! Faleminderit!

Deputetja Suzan Novobrdaliu, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për të gjithë,

Prishtina, Fushë-Kosova, Kastrioti, Mitrovica, Drenasi dhe Hani i Elezit janë vetëm disa nga komunat në të cilat ndotja e ambientit në vlera shumë të larta të emetimit të dyoksid-karbonit dhe dyoksid-sulfurit i tejkalon për disa herë vlerat e lejuara me standardet evropiane. Për më tepër, niveli kaq i lartë i ndotjes paraqet rrezik potencial për shëndetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Pyetja: Zoti ministër, çfarë po bën konkretisht Ministria, që ju e drejtoni, për eliminim apo së paku edhe uljen e këtij niveli kaq të lartë të ndotjes?

KRYESUESI: Ju faleminderit! Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Edhe një herë ju faleminderit zoti kryesues, i seancës!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

E nderuar deputete Suzan Novobrdaliu,

Së pari dëshiroj t'ju falënderoj për pyetje dhe interesimin për çështjen se sa është angazhuar Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në eliminimin apo zvogëlimin e nivelit të ndotjes CO₂, SO₂ e të tjera nga operatorët në Kosovë, ku në këtë rast është fjala për KEK-un, Ferronikelin, Sharrcem e të tjerë.

E nderuara deputete, lidhur me KEK-un, problemi madhor është dihet termoelektrana A, e cila as afërsisht, sigurisht që nuk i plotëson standardet për shkak të teknologjisë së stërvjetruar. Siç e dini po punohet së bashku me Komisionin Evropian dhe termocentrali edhe sipas ligjeve të aprovuar në Parlament por gjithashtu edhe me studimin e fizibilitetit duhet të dekomisionohet pas vitit 2015 ose deri në fund të vitit 2017, ndërsa Termocentrali B do të riparohet sipas standardeve evropiane, por gjithashtu sigurisht edhe ndërtimi i termocentralit "Kosova e re" do të bëhet sipas standardeve.

Lidhur me Ferronikelin, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka bërë përcjelljen permanente të ndikimit në mjedis me ç'rast e ka detyruar operatorin që ta instalojë sistemin për pastrimin e gazrave në dy furrat elektrike, e që tani veprojnë dhe janë në fazën testuese tremujore, pas së cilës fazë presim që të kemi eliminimin ose zvogëlimin e ndotjes në kufijtë e vlerave maksimale të lejuara sipas ligjeve në fuqi. E njëjta gjë vlen edhe për Sharrcem-in me ç'rast, pas intervenimit të inspektoratit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kemi një situatë shumë më pozitive mjedisore, gjë që shihet edhe në terren.

Vlen të theksohet e Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit vazhdimisht ka bërë presione në të gjithë operatorët në fjalë, ku ka bërë edhe denoncime gjyqësore. Ferronikeli është dënuar kurse për operatorët tjerë lëndët janë në procedurë.

Ministria është duke e realizuar projektin e rrjetit të stacioneve matëse për monitorimin e ndotjes së ajrit në nivel vendi, në bashkëpunim me komisionin Evropian. Besojmë edhe nesër për ditën botërore të mjedisit do të përurojmë dhe monitorin

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputete a keni pyetje shtesë? Urdhëroni, e keni fjalën!

SUZAN NOVOBRDALIU: Zoti ministër, faleminderit për përgjigjen. Ju përmendet që keni bërë përcjellje permanente të Ferronikelit, presione keni bërë, Ferronikeli punon ende pa filtra, përkundër presioneve tuaja. Kosova A punon ende pa filtra, ndotja ende vazhdon.

Konkretisht më intereson sa është ulja e ndotjes në Kosovë, nëse keni ndërmarrë diçka konkrete, për uljen? Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri e ka fjalën!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: ...uljes, unë thash na jemi në fazën e instalimit të stacioneve, monitorimit dhe matjes. Derisa nuk matet saktë, atëherë nuk mundemi me thënë edhe për zvogëlimin ose edhe për zvogëlimin e ndotjes ose intervenimet tjera. Besoj vitin e kaluar filluar me tri stacione, këtë vit do të instalojmë edhe 5 stacione tjera dhe do të veprojmë me një stacion mobil, të kemi gjendje të saktë të ndotjes së ajrit edhe në Prishtinë por edhe në qytetet tjera.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Naim Rustemi, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

Në bazë të një marrëveshjeje bashkëpunimi në me të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Aleancës Kosovare të Biznesit, e cila është nënshkruar një vit më parë, Ministria juaj ka lansuar projektin “Berza e punësimit Kosova 2010”.

Sipas të dhënave nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, pra Ministria që ju e drejtoni, numri i përgjithshëm i punëkërkuësve të regjistruar si të pa punë, në shërbimet publike të punësimit në Kosovë është 338.534 persona, deri në fund të qershorit 2009. Duke përfaqësuar kështu një ngritje për 12 muaj për diku rreth 1%. Me fjalë të tjera, numër të punë kërkuësve ka sa të duash. Kërkesa si berzë e punësimit, të kërkuash njerëz për t’i futur në punë, është e ngjashme si të kërkuash zall në Saharë, se ka të pa punë sa të duash.

Pyetja që ju drejtohet juve, është: Sa i ka kushtuar ky projekt Ministrisë, që ju e drejtoni, dhe cili është ndikimi i këtij projekti në punësim?

KRYESUESI: Ju faleminderit! Ministër!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Poštovani narodni poslanici, kao što ste i sami pitali, prošle godine je po prvi put održana berza za zapošljavanje i to, ja sam više puta rekao, pokušaćemo da napravimo nešto što će u buduću biti toliko značajno i za poslodavce i za nezaposlene i da će imati konkretne rezultate. Doći će do toga, sigurno!

Prošlogodišnja konferencija, odnosno breza zapošljavanja koštala je 36.000 evra, od kojih je zapošljeno 576 radnika, od kojih i danas njih 540 imaju ugovor o radu. Prema tome, po meni, mislim da smo započeli nešto što će biti vrlo interesantno i značajno.

Što se tiče rezultata za 2010. godinu, znate i sami da je berza tehnički završena, završena do pre nedelju dana i mi još nismo objavili zvanične podatke, jer to ide kroz procese u kojima poslodavci treba da završe sa intervjuima, sa radnicima koji su zainteresovani i koji nisu. Inače, bilo je prijavljeno u ovih 4 meseca 6.000 ljudi koje je tražilo posao. Prema tome, u finalnoj fazi su realizacije toga, o tome ćemo objaviti zvanične podatke ili preliminarne, jer ovi u ponedeljak neće biti završni, ali će biti sigurno preliminarne na konferenciji za štampu, obavestićemo vas o tome. I pored toga, i pored onih informacija koje ćete imati u ponedeljak, tu treba da dodamo plus jedan strateški partner koji nam je svima poznat, Bektel-aninka, koji će biti ti koji zapošljavaju jedan veći broj ljudi i kod kojih je, vrlo bitno je da ovo znate, konkurs za inžinjere otvoren stalno. Znači, za inžinjere, ja bih ovom prilikom pozvao sve naše mlade ljude, naše inžinjere da znaju tu informaciju, da imaju poziv na neograničen broj inžinjera. Prema tome, još jednom ponavljam, što se tiče breze za zapošljavanje, u ponedeljak ćete za 2010 imati informacije a posle toga naravno da svako drugo pitanje u vezi toga mogu da vam odgovorim onako kao što budete hteli. To možete u dodatnom pitanju to što vas interesuje, i zbog toga što se ja tačno držim pitanja koje ste vi postavili, gospodine. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Keni pyetje shtesë deputet? Po. Naim Rrustemi, urdhëroni!

NAIM RRUSTEMI: Për vitin e kaluar, është e ditur që kanë qenë 36.000 euro. Sipas të dhënave që ne disponojmë, këtë vit, thuhet, se i keni dhënë 100.000 euro për organizimin e kësaj berze të punësimit. A janë ministër, këta të punësuar vetëm me emra që kanë qenë të punësuar, apo janë edhe si ndikim i drejtpërdrejtë i këtij projekti tuaj dhe pyetja ime e sinqertë kishte për të qenë: - a të dhimbsen paratë e kosovarëve?

KRYESUESI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, predsedavajući!

Da vam kažem, vrlo kratko i jasno: Ti rezultati koji su ostvareni, znači su ostvareni stvarno na realnoj bazi. E sad, vi trebate da razmišljate samo nešto. Inače, sad na Evropskoj Uniji kosto ili utrošak za zapošljavanje jednog čoveka je oko 8.000 evra. Kod nas se procenjuje, zbog toga što, za održivo radno mesto, molim vas, za održivo radno mesto, možete i da zapišite ovo – za održivo radno mesto utrošak po jednom radniku je oko 8.000 evra, u Evropskoj Uniji. Kod nas se procenjuje negde između 3,5 do 4 hiljade evra. Još jednom ponavljam, prošle godine smo zaposlili 576 ljudi. Rezultati ove berze će biti vidljivi u ponedeljak, na prvoj konferenciji za štampu, a u toku daljnje ćemo vas takođe obavestavati. Jer, ne znam koliko si u toku, koliko ste pratili. Ja znam da samim hovim, molim vas, vi možete i više da se uključite, možete i da pogledate i kroz naš sistem, kroz sistem zapošljavanja i kroz druge partnere koliko će to biti uspešno. I možete čak i vi da date saglasnost za to. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministër! Deputetja Drita Maliqi, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Ministri nuk është këtu. A doni ta parashtroni, pyetjen? Deputetja Drita Maliqi e ka fjalën.

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Me të vërtetë i kam parë sot nja dy shqetësime shumë të rëndësishme sa i përket të drejtave të fëmijëve dhe braktisjes së shkollave, të paraqes para ministrit të Arsimit, mirëpo shqetësimi bëhet edhe më i madh kur ministri... sepse që nga marsi i kam parashtruar këto dy pyetje dhe ministrin nuk e kemi prezent, do të thotë në seanca plenare. Andaj, kërkoj falje, besoj dhe shpresoj që në takimin e ardhshëm të seancës do të jetë prezent. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, besoj që e keni pasur fjalën edhe për pyetjen e radhës, sepse njëjtë e keni pasur për ministrin Enver Hoxhaj. Faleminderit!

Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kosova ka marrë obligimin për kthimin e huave ndaj kreditorëve të huaj, që është obligim ndërkombëtar që duhet ta kryejë, duke marrë parasysh se obligimet ndaj institucioneve ndërkombëtare në parim nuk shuhën.

Detyrimi për pagimin e borxhit të jashtëm është edhe pjesë e përmbushjes së obligimit që del nga Aneksi VI i Pakos së Ahtisarit, por siç janë ose kanë qenë të evidentuara obligimet, atëherë sigurisht do të jenë të evidentuara edhe asetet.

Zotëri ministër, çka është me asetet?

KRYESUESI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete, Gjylnaze Syla,

Siç e dini, Qeveria e Republikës së Kosovës është zotuar, pra edhe gjatë negociatave që të bëjë pagesën e të gjitha borxheve, të cilat rrjedhin nga institucionet financiare ndërkombëtare e të

cilat kanë pasur për destinim të fundit, në atë kohë, Kosovën, tani Republikën e Kosovës dhe qytetarët e saj i kanë pas benefite.

Sipas evidencave, Qeveria e Kosovës dhe sipas aprovimit të Parlamentit këtu ka marrë obligim për të paguar 381 milionë e 200 e 8 mijë e 965 euro e 90 centë për obligimet ndaj Bankës Botërore, të cilat janë bërë, pjesa e kësteve, është bërë në mars, është paguar në mars, në shtator, më 15 shtator të vitit 2009, prej 8 milionë e 484 mijë e 709 euro e 78 centë dhe interesi prej 737 mijë e 212 euro. Po ashtu, më 13 tetor 2009 është parapaguar kësti në vlerë prej 123 milionë e 711 mijë e 413,70 euro, prej të cilave nga buxheti 34 milionë e 592 e diçka dhe shuma prej 84 milionë ndihmë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pra nga donacionet për shlyerjen e borxhit dhe pesë nga Komisioni Evropian. Të gjitha këto janë kryer nëpër afate të caktuara, ndërsa sivjet, më 15 mars janë kryer 5 milionë e 668.000 euro të tjera, në emër të principalit dhe 4 milionë e 400 mijë euro në emër të interesit.

Bilanci i mbetur, është me rëndësi për qytetarët, bilanci i mbetur i huas nga 15 marsi i vitit 2010 është 243 milionë e 344 mijë e 304 euro, dhe i cili është në dy transhe, transhi i parë është me interes prej 1,58% prej 128 milionë euro dhe transhi i dytë është prej 126 milionë e 527 mijë e 585 euro me interes - libor plus six months prior, pra edhe gjashtë muaj paraprake, mesatarja gjashtë mujore paraprake.

Më lejoni t'ju them se ne supozojmë që do të jemi të ngarkuar edhe me borxhet tjera të Klubit të Parisit dhe të Klubit të Londrës, të cilat sipas shënimeve që kemi nga institucionet financiare nga Klubi i Parisit janë rreth 250 milionë euro, nga Klubi i Londrës 90 milionë euro dhe borxhet tjera bilaterale që i ka trashëguar ish-Jugosllavia. Ne këto borxhe nuk do t'i paguajmë tani dhe nuk kemi obligim për t'i paguar deri sa të shlyhet suksesioni, përkatësisht raportet në mes Serbisë dhe Kosovës ose njohjet reciproke.

Duke qenë se trashëgimia e ish-Jugosllavisë është transferuar prej një ish....

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESI: Faleminderit! Deputete, a keni pyetje shtesë? Po! Gjylnaze Syla e ka fjalën!

GJYLNAZE SYLA: Ministër, unë thashë që borxhet ne kemi obligim t'i paguajmë. Pyetja ime është: çka me asetet dhe po ju numëroj?

Me ndarjen e ish-Jugosllavisë, Kroacia nga kuota në FMN ka marrë 28.5%, që është 1.200.000 euro, Serbia 36.5%, Sllovenia 16%, Bosnja e Hercegovina 13%, Maqedonia 5.4%. Për dy vjet të pavarësisë, çka keni bërë ju si Qeveri për ta realizuar këtë të drejtë dhe ju kujtoj se kjo kuota në FMN dhe në Bankën Botërore është njëra prej asetëve. Çka me asetet tjera, ku është hisja jonë, çka ka punuar Kosova për ta marrë hisen tonë, e jo të marrim veç borxhe? Faleminderit!

KRYESUESI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, kryesues!

E nderuara deputete, këtë edhe desha ta sqaroj! Me Malin e Zi, konsideroj ekziston një vullnet politik shumë i mirë dhe është formuar grupi i përbashkët, i cili përbëhet nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit, ku shumica e asteve kanë qenë pronë shoqërore në Mal të Zi dhe është treguar një gatishmëri e nivelit të duhur, konsideroj nga Qeveria e Malit të Zi, për të biseduar për mënyrën e transferimit të atyre asetëve në pronë të Republikës së Kosovës dhe në interes të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Për asetet tjera, të trashëguara në Jugosllavi, pas Jugosllavie, e që janë tani të alokuara faktikisht në Fondin, nëse mund të themi të aseteve të Serbisë, ne nuk do të mund ta zgjidhim këtë çështje deri sa nuk vjen raporti i njohjeve reciproke në mes shtetit të Kosovës dhe të Serbisë.

Lista e shumë aseteve të ndërmarrjeve shoqërore që janë në Serbi ekziston në Agjencionin Kosovar të Privatizimit dhe lista e aseteve të ndërmarrjeve publike, po ashtu në të njëjtin institucion. Kur t'i vijë koha, sigurisht se ne duhet të debatojmë, ne, natyrisht insistojmë me çdo kusht që këto dhe menaxhimi i aseteve tjera, qofshin të likuidueshme, e kam fjalën në para apo në Thesarin, në forma të ndryshme të mbajtjes së instrumenteve të pagesave që Serbia i mban në emër të trashëgimisë së Jugosllavisë, të jenë pjesë e negociatave përfundimtare në mes të dy shteteve.

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministër!

Deputetja Mimoza Ahmetaj, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar. Ministri nuk është këtu. A doni ta parashtroni pyetjen?

MIMOZA AHMETAJ: Jo, faleminderit kryesues!

KRYESUESI: Pyetja e radhës: Deputetja Mimoza Ahmetaj, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi. Deputete, e keni fjalën.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Zoti ministër, një ndër çështjet me rëndësi të veçantë të sigurisë shtetërore, kombëtare e qytetare është edhe kontrolli dhe ruajtja e kufijve të vendit, por edhe një nga shumë obligimet për t'u plotësuar për integrimin e shtetit tonë në proceset e BE-së.

Para një kohe KFOR-i ia ka kaluar në kompetencë Ministrisë së Punëve të Brendshme, kontrollin dhe ruajtjen e vijave kufitare në mes Kosovës dhe Shqipërisë, rrjedhimisht Policisë kufitare pranë Ministrisë që ju drejtoni.

Pyetja është: Çfarë mund të na thoni mbi obligimet dhe përgjegjësitë e reja që janë marrë në këtë drejtim, pra si po shkon kjo punë kaq e rëndësishme dhe çfarë mund të na thoni mbi faktin se kjo çështje ka ndodhur fillimisht në mes kufijve shqiptaro-shqiptar? Faleminderit!

KRYESUESI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete,

Edhe pse s' më është përcjell pyetja nëpërmjet shërbimit, megjithatë do të provoj t' ju përgjigjem.

Natyrisht, në muajin prill të këtij viti është bërë transferimi i kompetencave nga KFOR-i te Policia e Kosovës, konkretisht te Policia kufitare. Ky është një sinjal i mirë dhe kjo është bërë pas një vlerësimi nga ana e KFOR-it dhe institucioneve tjera, po edhe vetë Policisë së Kosovës se ne kemi ngritur kapacitete dhe kemi kapacitete të plota të bëjmë menaxhimin e vijës së gjelbër dhe të kaltër. Për momentin kjo mbikëqyrje e kufirit dhe kontrollimi i kufirit është shumë i mirë dhe lëvdatat janë nga ndërkombëtarët të cilët në një mënyrë i japin vlerësimet e veta. Natyrisht se është një bashkëpunim shumë i ngushtë edhe në prevenimin e trafiqeve ilegale të luftës kundër

korupsionit, po edhe të lehtësimit të qarkullimit të qytetarëve në vendkalimet zyrtare kufitare dhe jemi në proces që të kemi sa më tepër vendkalime kufitare edhe në pjesët rurale, sidomos në disa pjesë gjatë sezonit të verës. Pse kjo ka ndodhur së pari me Shqipërinë, është plotësisht e natyrshme se ka qenë një bashkëpunim shumë i mirë edhe i KFOR-it me strukturat e policisë në Shqipëri edhe më herët. I kanë paraprirë shumë marrëveshje të nënshkruara më parë me Shqipërinë edhe sa i përket bashkëpunimit kufitar të policive të dy vendeve ku një numër i tyre janë miratuar ose janë ratifikuar në Parlamentin e Shqipërisë, ndërsa te ne do të bëhen në fazat e mëvonshme. Bashkëpunimi është shumë i mirë, të mos hymë në detaje, ka edhe mundësi që policitë bashkërisht të depërtojnë brenda kufirit të njëri-tjetrit deri në largësi prej 5 kilometrave që bashkërisht ta luftojnë krimin dhe format tjera. Në procedurë ose në përgatitje jemi që kah fundi i vitit të marrim kontrollin e një pjese të kufirit me Maqedoninë për momentin nuk kemi kapacitete të mjaftueshme se kufiri është shumë i gjatë, nuk kemi kapacitete të mjaftueshme, edhe një herë them, për shkak të mundësive buxhetore nuk mund të bëjmë rekrutim të policëve shtesë, por duhet nga rezervat e brendshme t'i rekrutojmë, për momentin nga pjesë tjera janë rekrutuar 187, sa janë në kufi me Shqipërinë, po ashtu pritet edhe me Malin e Zi, ndërsa me Serbinë edhe më gjatë do të jenë bashkërisht me KFOR-in. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Keni pyetje shtesë, deputete? Po. Deputetja Mimoza Ahmetaj e kërkon fjalën.

MIMOZA AHMETAJ: Vetëm desha ta falënderoj ministrin, për atë që mendova ta pyes në pyetjen shtesë edhe për tejkalimin e kompetencave në Policinë tonë kufitare në shtetet tjera të regjionit, u përgjigj, e përmendët Maqedoninë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Blerand Stavileci.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues!

I nderuar zotëri ministër, Stavileci,

Bujqësia, veprimtari ekonomike për prodhimin e ushqimit për njerëz, për kafshë, për bimë industriale, biokarburante dhe produkte me origjinë bimore e shtazore, edhe për shkak të insufiencës së politikave bujqësore, strategjisë për bujqësinë dhe për zhvillimin rural, si dhe të planit kombëtar për bujqësi dhe zhvillim rural, në vendin tonë në masë të konsideruar është neglizhuar, e lënë pas dore dhe ekstensive. Edhe pse në vendin tonë ka premisa të volitshme për krijimin e mbi prodhimeve bujqësore e së andejmi edhe për eksportimet e tyre, gjithnjë, madje me të madhe, blihen produkte të jashtme dhe në atë mënyrë na dobësohet edhe bilanci pagesor i jashtëm, në disfavor të eksportimeve vendore.

Në anën tjetër, tregu kosovar nuk është i mbrojtur sa e si do të duhej nga importimet e subvencionuara, të garantuara me çmime stabile të shteteve respektive, herë-herë dampinguere në ç'mënyrë stimulohet prodhimi vendor, pasivizohet aktiviteti bujqësor, ulet punësimi produktiv dhe krijohet pozitë subordinuese e vendit tonë nga endet e jashtme importuese të produkteve bujqësore.

Në këtë kontekst, zoti ministër, çfarë janë politikat qeveritare referuar Ministrisë të cilën ju e menaxhoni? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BLERAND STAVILECI: I nderuar kryesues,

Të nderuar dhe të çmuar deputetë,

I nderuar deputet zoti Smaka,

Duke iu falënderuar për pyetjen, me kënaqësi do t'ju përgjigjem.

Qeveria e Republikës së Kosovës, që nga viti 2008 ka rritur në mënyrë progresive buxhetin për bujqësinë dhe zhvillimin rural, konkretisht për skemën e projekteve të investimeve kapitale dhe për grandet e subvencionit. Krahas rritjes së buxhetit, Ministria ka punuar në planin e zhvillimit institucional për krijimin e kapaciteteve dhe të infrastrukturës për menaxhimin e fondeve në përkrahje të sektorëve me potencial për mbulimin e tregut vendor me produkte bujqësore.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, politikat e veta bujqësore i bazon në planin e bujqësisë dhe zhvillimit rural 2009-2013. Në këtë plan janë të paraqitur hapat konkretë, të cilët ne si Ministri tashmë jemi duke i ndërmarrë për të ristrukturuar sektorin agro-rural, në mënyrë që të përmbushim detyrimet me të cilat do të përballemi si një vend kandidat i Bashkimit Evropian.

Objektivat e parapara në tetë masat e këtij plani, kanë filluar të realizohen përmes projekteve që Ministria e Bujqësisë është duke i implementuar. Për realizimin e këtyre objektivave vetëm për vitin 2010 janë ndarë rreth 5 milionë euro grande dhe subvencione në mbështetje të projekteve që mëtojnë rritjen e të ardhurave në ferma, përmirësimin e aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve bujqësore dhe agro-përpunuese, zëvendësimin e importit me produkte vendore, rritjen e eksportit dhe përmirësimin e jetës në zonat rurale.

Duke pasur nevojën e rimëkëmbjes dhe zhvillimit të agro-kulturës, Ministria e Bujqësisë është duke stimuluar rritjen e prodhimit të bujqësore përmes dizajnit të politikave të qëndrueshme bujqësore dhe në këtë sens jemi në përfundim të realizimit të projekteve në mbështetje të sektorëve si në vijim.

Mbështetja e fermerëve përmes ofrimit të pagesave direkte për sektorin e lopëve qumështore dhe mbarështimit të mështjerrave (mëshqerrave) shuma e ndarë për këtë projekt është 1.2 milionë euro. Mbështetja e fermerëve të kafshëve të imëta, pra dele dhe dhi, shuma e ndarë për këtë projekt është 1.5 milionë euro. Kjo është ndihma më e madhe që ndonjëherë i është dhënë sektorit të qumështit.

Për vitin 2010 po ashtu kemi hartuar programin e graveve investuese në mbështetje të projekteve investuese të fermave dhe të ekonomive bujqësore. Ministria ka bërë thirrje publike për aplikim për dhënien e grantit për investime në fermë në kuadër të nën-masës së parë, që është mbështetje e ekonomive bujqësore për prodhimin e qumështit. Për këtë qëllim janë ndarë rreth 400 mijë euro. Po ashtu është bërë thirrje publike për aplikim për dhënien e grantit për investime në fermë në kuadër të nën-masës së dytë që ka të bëjë me sektorin e pemëtarisë, perime-kulturës dhe vreshtarisë. Për këtë qëllim janë ndarë 1.4 milionë euro....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministër! Deputet, keni pyetje shtesë? Deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: Duke vlerësuar afirmativisht angazhimin dhe përkushtimin e juaj, zotëri ministër, kam dëshirë që ta potencoj, sepse është në funksion edhe të Ministrisë edhe të Qeverisë edhe të Kuvendit të Kosovës, pra edhe të Kosovës... këtë fakt që është i dhembshëm. Përafërsisht nga 1 mijë hektarë tokë buke e klasit të parë që brenda një viti në Kosovë, uzurpohen, degradohen, devastohen. Vetëm të marrim një udhëtim Prishtinë-Mitrovicë, Prishtinë-Pejë, Prishtinë-Prizren apo Gjilan. Zemra i dhemb kujt do që ka ndjenja elementare pro çështjes së vendit tonë, apo jo. Tokat pjellore uzurpohen dhe ekzekutivi jonë ka mundësi për të bërë

shumëçka më tepër dhe unë do t'ju kisha inkurajuar që të ndërmerrni masa se fundi i fundit këto nuk varen vetëm nga....

KRYESUESI: Keni të drejtë të komentoni, zotëri ministër? E keni fjalën!

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Jo, në rregull, pajtohem me konstatimin tuaj. Ato probleme që ju i përmendet dhe disa probleme të tjera të cilat janë të lidhura zinxhir, janë të adresuara në strategjitë përkatëse, ne po ashtu jemi duke dizajnuar edhe disa strategji të tjera të cilat pikërisht i adresojnë këto probleme dhe jo vetëm Ministria e Bujqësisë po të gjithë aktorët, të gjitha palët e interesit duhet të jenë të përfshira, pra në këtë sistem i cili përfundimisht mund ta rimëkëmbë dhe ta zhvillojë sektorin e bujqësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministër!

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministren Edita Tahiri.

E keni fjalën, deputet!

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues,

E nderuara ministre Tahiri,

Një numër i konsiderueshëm i institucioneve publike në Republikën e Kosovës gjithnjë janë të vendosura në objekte private për të cilat nga buxheti, përkatësisht nga paraja publike e vendit tonë paguhen shuma të konsiderueshme të rentave mujore. Në këtë kontekst, zonja ministresh me konsideratë ju pyes: sa është shuma e rentave mujore për qira-marrëdhënie të lokaleve private destinuar akomodimit të institucioneve publike? Nga ato lokale përkatësisht objekte, sa sosh janë të ndërtuara ilegalisht, përkatësisht legalisht, si dhe çfarë është plani dhe programi qeveritar për eliminimin përfundimtar të marrëdhënieve qira-marrëdhënies qeveritare me pronarët privatë, në radhë të parë referuar objekteve informale? Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja ministre, e keni fjalën!

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Smaka,

Së pari, arsyeja pse një pjesë e institucioneve kanë qenë dhe një pjesë tjetër edhe më tutje mbeten në objekte private, lidhet me mungesën e objekteve publike që do të mund të plotësonin nevojat e institucioneve të Kosovës, ndërsa për sa i takon pyetjes tuaj se sa është qiraja mujore që paguhet për këto objekte që janë në shfrytëzim, mund t'ju them se Ministria e Administratës Publike nuk menaxhon me objekte private. Në kompetencën tonë janë vetëm objektet publike, prandaj kjo pyetje duhet t'i shkojë veç e veç ministrive që ende vazhdojnë të kenë objekte private në shfrytëzim dhe e njëjta vlen edhe për pjesën tjetër të pyetjes tuaj, pra çfarë është statusi i këtyre objekteve, a janë legale apo ilegale?

Plani dhe programi qeveritar për kalimin në institucione qeveritare, pra që të kalojmë definitivisht nga ato private në objekte publike, është në implementim e sipër dhe më lejoni t'ju njoftoj për disa arritje në këtë drejtim. Së pari, siç e dimë, tashmë në objektin e "Rilindjes" janë akomoduar 4 ministri. Është fjala për Ministrinë e Administratës Publike të Drejtësisë, të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, si dhe është fjala për Ministrinë për Pushtetin Lokal dhe ne po punojmë pra që në një proces sa më të shpejtë të bëjmë zgjidhje edhe për nevojat tjera që kemi. Në bazë të informacioneve që kam, një pjesë e objekteve të UNMIK-ut është e lirë dhe do të mund të merret në shfrytëzim, si dhe po ashtu kemi informacion se OSBE-a do të largohet nga ato objekte që është sot, dhe ne do të mund të bëjmë plane që të bëjmë bartje të institucioneve

tona nga pjesa e objekteve private në këto publike. Po ashtu, pritet që Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, pra të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Keni pyetje shtesë, deputet? Urdhëroni!

RIZA SMAKA: Unë, zonja ministre, do t'ju kisha lutur, meqenëse jeni anëtare e Qeverisë dhe bashkëpunoni me kolegët me ministrat që për seancën e ardhshme t'ju mblidhni të dhënat dhe ato mund të jenë.... Unë si deputet kam të dhëna se ka objekte janë punuar ilegalisht dhe marrin qira të majme. Ju lutem, kjo ose bie fjala, si mund të tolerojë buxheti i Kosovës të paguajë qira shumë të larta që janë shumë të dyshimta janë në disproporcion me standarde. Bie fjala vetëm për auditorin gjeneral paguan nga 18 mijë euro muaj për muaj. Ju lutem! E përmendët "Rilindjen," le që tender i parë, tenderi i dytë, vendosja mirë, në rregull, por tani do të duhet të paguajë qira, Qeveria për atë objekt, ka probleme shumë serioze, kjo temë është shumë ndjeshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Ministre, e keni fjalën.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Zoti deputet, por ju jeni doktor i shkencave juridike dhe më lejoni t'ju them se unë punoj sipas ligjit. Në qoftë se menaxhimi i objekteve private nuk është kompetencë e imja dhe e Ministrisë sime, unë nuk kam mundësi të merrem me këtë çështje dhe të ndërhyjë në punët e brendshme të ministrive tjera. Unë ju dhashë udhëzimin e drejtë. Ju lutem, ju i dini, ju e paskeni listën, i dini cilat ministri në çfarë niveli dhe segmenti janë në objekte private, bëni pyetjen atyre dhe merrni përgjigjen!

KRYESEUSI: Deputeti Rexhep Hoti, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj.

Nuk është deputeti këtu, e as ministri!

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Deputeti është, ministri nuk është. Deputet, a e doni fjalën? Urdhëroni!

DRITON TALI: Zoti kryesues, të të them të drejtën, është pyetja për tenderin për pajisjen e shkollave me teknologji informative, që u dha 24 milionë më shtrenjtë se oferta më e lirë.

Njëherë e kam pas bërë këtë pyetje në dhjetor, ministri nuk ma ka dhënë përgjigjen. Tash jam duke e pritur që katër muaj, s'po vjen. Unë do ta përsëris këtë pyetje, shpresoj se në të ardhmen e afërme do të vijë zoti ministër, Enver Hoxhaj dhe do të na shpjegojë se çka është puna me këto 24 milionë, pse të jepet tenderi më shtrenjtë? Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti, Basri Musmurati, pyetje për ministrin Haziri. Ministri nuk është. Doni ta bëni pyetjen? Po. Atëherë deputeti Basri Musmurati e ka fjalën.

BASRI MUSMURATI: Konsideroj se ministri do të duhej të ishte këtu dhe të jepte përgjigje në këto pyetje të cilat eventualisht mund t'ju bëhen. Unë e kaloj pyetjen për seancën tjetër.

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet! Dhe, prapë pyetja e fundit, deputeti Basri Musmurati, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Nuk është ministri këtu. Konsideroj se edhe për këtë pyetje të jepet përgjigje në seancën e radhës. Ju faleminderit!

Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seancat plenare, do të publikohen në Revistën e Kuvendit. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Ratifikimin e Marrëveshjeve të nënshkruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për financimin e Projektit për modernizimin e sektorit publik dhe financimin e Projektit për regjistrimin e pasurisë së patundshme dhe kadastër,

Në sallë janë 55 deputetë. Nuk kemi kuorum për vendimmarrje. Ftoj regjinë që t'i ftojë deputetët të kthehen në sallë.

(Ndërprerje e incizimit)

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit të punës

Konstatime hyrëse. Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zotëriun Nenad Rashiq që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin. Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, poštovani predsedavajući!

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Ja mislim da je ovo jedan stvarno značajan događaj anas, jer smo puno pričali o Zakonu o radu i stvarno ja znam da sam često hteo da vam prenesem sve one informacije koje imam ja, informacije kroz saradnju sa raznim međunarodnim faktorima, kroz saradnju koja omogućava da ovaj naš zakon bude na istom nivou kao što su evropski zakoni, kao što su zakoni u rejonu, jer ukoliko i naša legislacija teži ka tome da bude na evropskom nivou, moramo da imamo i zakone koji će pružiti mogućnosti i radnicima, i poslodavcima i napraviti jednu početnu bazu za dalju dogradnju našeg sistema.

Ja ću ukratko naznačiti neke tehničke detalje. Naravno, kao i uvek do sada, pozivam sve vas da pored učestvovanja u debati, učestvujete i u razgovorima daljim sa nama, sa Ministarstvom za rad u cilju eventualnog poboljšanja, u cilju eventualnog amandamentiranja dodatnih članova zakona, sve u cilju da ovaj naš zakon bude na nivou jednog zakona koji će pružiti jedan osnovni sistem progresa našeg društva.

Ovaj zakon ima za cilj da reguliše prava i obaveze iz radnog odnosa, način i postupke njihovog ostvarivanja koja se regulišu ovim zakonom, kolektivnim ugovorom i ugovorom o radu u skladu sa međunarodnim konvencijama rada i zakonodavstva Evropske Unije.

Odredbe ovog zakona sprovode se za zaposlene i poslodavce privatnog i javnog sektora, zdravstva i javnih preduzeća koja su u vlasništvu ili u kompetencijama Kosova ili bilo koje opštine na Kosovu.

Odredbe ovog zakona sprovode se za zaposlene i poslodavce, čija zapošljavanja reguliše se sa posebnim zakonom ako poseban zakon ne predviđa rešenje za određena pitanja iz radnog odnosa.

Prema odredbama ovog nacrtu zakona, radni odnos može biti uspostavljen sa nepunim radnim vremenom, na određeno ili neodređeno vreme. Takođe, ovim nacrtom zakona uređuje se skraćeno radno vreme, porodijsko odsustvo, posebno staranje, kao i druga pitanja iz radnih odnosa.

Nacrt zakona se odnosi i na pravo na platu, dodatne zarade, naknadnu platu i drugih primanja koje zaposleni ostvaruju. To je kao puno radno vreme, rad duži od punog radnog vremena, rad na državnim praznicima, noćni rad i slično.

Nadziranje sprovođenja odredbi ovog zakona, koji reguliše radni odnos, sigurnost i zaštitu na poslu, čini Inspektorijat rada na osnovu Zakona o inspekciji rada.

Znam da će ovaj naš zakon biti diskutovan i da neka od osetljivih pitanja, kao što se već sad desilo, biti napomenuto a to je, na primer, kao deo o porodijskom odsustvu, porodijskom bolovanju i mogu da vam kažem da u svim tim analizama koje smo radili, da je ovo što mi predlažemo danas stvarno u istoj meri sa onim zakonima koji su na snazi i u Evropi. I u rejonu, možda će neko od vas pomenuti neke primere koje jesu bliski nama, ali vas još jednom uveravam da stvarno smo dali svoj maksimum, da smo pokušali da ga tako modifikujemo i da bude jedan od zakona koji daje podršku poslodavcima i ja moram to da naglasim još jednom, jer u našem društvu ima visok stepen nezaposlenosti i mi moramo biti svesni da uz jednu podršku – zakonsku podršku našim poslodavcima moramo da stvaramo uslove za veće zapošljavanje.

Ne možemo imati sve odjednom. Ne možemo praviti zakon koji će dati velike privilegije, nešto što ne možemo budžetom da izdržimo. Moramo da budemo svesni našeg skromnog budžeta. Ja vas molim da danas stvarno razmislite dobro o ovome i da ovaj zakon, onakav kakav jeste, onakav kakav ga mi predlažemo – usvojimo, a da kasnije, naravno vašim amandmanima omogućimo i radnicima da imaju bolje uslove, radnicima da imaju bolju zaštitu na radu i ja sam siguran da ćemo ovim sistemom ne samo ostvariti da možemo imati dobru podlogu, nego će samim tim zakon nama dati zeleno svetlo da možemo kroz naš Inspektorijat za rad i braniti interese radnika, povećati registrovanje tih naših ljudi koji su zaposleni po privatnom sektoru, jer meni lično deluje poražavajuće kad vidimo, recimo po tom penzionom sistemu našem da samo 295.000 radnika uplaćuje doprinos za penzijom. Mi znamo da ih ima bar duplo više, ja verujem da ih ima bar duplo više, ali zbog toga što naša legislacija je bila tako puna nekih nepravilnosti, odnosno nejasnoća, nismo bili u stanju da zakon sprovedemo u potpunosti.

Prema tome, ovaj zakon koji će doprineti da se broj registrovanih radnika, kada kažem udvostruči, možda sam optimista, ali postepeno povećava ovu našu bazu. Ako želimo da sistem dovodimo u red, ako želimo da sistem napravimo funkcionalnim, ja mislim da je tehnički zakon pripremljen na najvišem mogućem nivou.

Ja se u ime Vlade, kao ministar za rad u ovom momentu, izvinjavam što je zakon toliko dugo čekao, odnosno što je već četiri ili pet godina bio u priremi, a nikada nije video svetlost dana. Možda je bila pogrešna i percepcija sa naše strane, misleći da zakoni mogu da budu od iznosa od 20 do 50 ili sto miliona, to nije realno. U ovom momentu, bitan nam je status, status radnika, status poslodavaca, baza tehnička koju pravimo za budućnost.

Ovo jeste zakon za budućnost. Ja vas molim da imate to na umu, da ovaj zakon verovatno može biti stvarno jedna osnovna baza, jedna dobra baza. I još jednom, kao i uvek do sad, vas pozivam na bilo kakvu saradnju, da kažem na tehničkom nivou, političkom, na izgrađivanju politika Ministarstva za rad i socijalno starenje, sve u cilju našeg društva, sve u cilju naših ljudi i naših poslodavaca, naših radnika jer ja mislim da je krajnje vreme da sa reči pređemo na dela i da uz tehničku bazu damo i bolju mogućnost za sve naše ljude na Kosovu.

Hvala vam puno, i stvarno iskreno želim da ovaj zakon shvatite kao što jeste, baza za budućnost. Hvala, još jednom!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Unë po i ftoj deputetët që i kanë kartelat e vendosura, e që janë 94, të kthehen në sallë. Ose, nëse nuk janë këtu, t'u hiqen kartelat atyre deputetëve që s'janë në sallë.

Këtu kemi 86 deputetë prezentë, kurse me kartela tregohen 93, a 92. Edhe 2 kartela le të hiqen!

Kërkoj nga administrata që ta evidencojë prezencën e deputetëve. Ju njoftoj se edhe me këtë prezencë të deputetëve nuk mund të hyjmë në votim.

Atëherë, vazhdojmë debatin për Ligjin e punës. Radha është për kryetarin e komisionit. Fjalën e ka deputeti Sadik Idriz, në emër të Komisionit.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedniče!

Kolege poslanici, ministri,

Komisija je razmatrala Predlog zakona o radu prije prvog čitanja i ocenila je da je zakon više nego neophodan, ali su članovi Komisije imali dosta primedbi na Predlog zakona. Između ostalog, članovi komisije žele doznati od Vlade, najmanje dve stvari: koje su realne budžetske implikacije ovog predloga zakona kojim će se dodatno opteretiti budžet Kosova...

KRYETARI: Një moment, deputet! Ftoj shefat e grupeve parlamentare të Partisë Demokratike, të Lidhjes Demokratike dhe të koalicionit që t'i ftojnë deputetët të vijnë në sallë. Urdhëro, vazhdoni deputet!

SADIK IDRIZ: Komisija smatra da 1,8 miliona evra je nerealno. Takođe komisija želi da dobije odgovor od Vlade da li su tri meseca predviđena za porodijsko odsustvo diskriminacija prema ženama. Ukoliko Predlog zakona bude usvojen, komisija će raditi da ovaj zakon bude što kvalitetniji, angažovaće eksperte, radiće na njemu svim svojim kapacitetom, organizovaće javne debate da bi zakon bio bolji.

Sada želim nekoliko reči u svoje ime. U načelu mislim da treba podržati ovaj zakon iz razloga što mi do sada nismo imali ovaj zakon i u prošlom mandatu nije prošao. Nadam se da ukoliko bude prošao, da ćemo učiniti sve da taj zakon poboljšamo, ali ako ne prođe u parlamentu, on će biti na čekanju i ništa nismo dobili kao parlament i mislim da to je najgore rešenje da on ne prođe u ovom parlamentu.

Mi smo izvršili čitanje ovog predloga zakona. U okviru ovoga ocenili smo i budžetska opterećenja. Takođe sam izvršio poređenje ovog nacrt zakona sa važećim zakonima o radu okolnih država Albanije, Crne Gore, Hrvatske, Makedonije i Srbije i mislimo da ocena budžetskog opterećenja koje je dalo Ministarstvo privrede i financija je bazirana na pretpostavkama koje su naznačene. Na osnovu ovih pretpostavki došlo se do zaključka da će ovaj zakon dodatno opteretiti budžet Kosova za ukupno 1,8 miliona evra, što je i komisija smatrala da je nerealno.

Značajna tačka ovog zakona je što je on poboljšana u određenim segmentima kada su u pitanju zaštita radnika i zaštita osoba sa posebnim potrebama, zaštita omladine i tako dalje, međutim pitanje porodijskog odsustva ostaje problematično jer je prema ovome što vidimo, u odnosu na dosadašnju regulaciju UNMIK-a, izvršena restrikcija i u mesto dosadašnjih 3+3 mesta, mi imamo samo 3 sa mogućnošću da se produži za još 1 mesec.

U okruženju je ovo rešeno drugačije. U Makedoniji je 9 meseci sa plaćanjem od 50 procenata, u Crnoj Gori je 365 dana porodiljsko odsustvo, time se kolektivnim ugovorom se određuje kako će biti isplata. U Srbiji je 365 dana, time što porodiljsko plaćanje odsustvo je 3 meseca, ostalo može biti neplaćeno. Znači, različita su rešenja. Rešenje da porodiljsko odsustvo traje 3 meseca sa naknadom od 70%, na Kosovu prema ovom predlogu je smatramo diskriminatorno prema ženama jer ih dovodi u situaciju da se odluče da li će radati ili drugo, da li će se zapošljavati. U svakom slučaju, u mnogim evropskim zemljama je ovo rešenje ponuđeno, u vodećim razvijenim zemljama, međutim tamo su i druge mogućnosti, moguće je da deca posle 3, 4 meseca budu smeštena u obdaništa. Kod nas mi u zakonu koji to reguliše imamo od godinu dana i na više i tu je taj problem koji se javlja kako sa djecom, sa bebom za žene koje rade, tako da staranje dece kome da poklone staranje dece.

Mislim da ovakav predlog može imati uticaja i na smanjenje nataliteta na Kosovu, ali ne znam da li je to neka strategija Vlade, da li je do sada negde bilo naznačeno da Kosovo ima tu nameru da vrši smanjenje nataliteta. Ja ne znam da li je to u nekom dokumentu naznačeno.

Ovde u objašnjenje date su neke budžetske implikacije, prije svega u članu 51 koji govori o izostanku sa posla zbog posebnog staranja o detetu i došlo se do neke sume od 88.560 evra po obračunu od 123 evra za 60 slučajeva. Nije jasno kako se došlo do ovih cifara i brojeva. Slično je to i kod nekih drugih kategorija povrede na radu, uzima se od prilike oko 80, da li su to neki podaci koji su do sada bili...

Takođe veoma je indikativno i nije najbolje rešenje po pitanju kolektivnog otpuštanja sa posla. Po ovom članu, maksimalna otpremnina od 5 mesečnih plata sleduje radniku koji je 30 i više godina, odnosno celi svoj radni vek proveo na radu. Ovo je zaista neprihvatljivo rešenje i treba pogledati kako će se ovo naći, jer 5 plata nekome koji je radio 31, 32 ili 33 godine, to bi bilo najlakše za poslodavca da ga otpusti i da mu da 5 plata i ovo rešenje nigde ne verujem da je u okruženju dato i to mora da se dobro razmotri.

Ovaj predlog nacrtu zakona kakav jeste, nije kompletan, ima nedostataka, negde stvara opasnost od diskriminacije žena, dovodi zemlju u opasnost od nenormalnog i neprirodnog pada nataliteta, svojim rešenjima o minimalnim naknadama i u opšte minimalnim pravima ide u korist poslodavaca u privredi a na štetu radnika, jer će poslodavci uvek nastojati da se zadrže na zakonskom minimumu. Ovo će u najvećoj meri pogađati radnike koji obavljaju teže fizičke poslove, naročito noću. Ovim radnici su inače podložni dužem radnom vremenu, takođe je opasnost da kod nas nedostaje tradicija sindikalnog organizovanja i sindikalne borbe, tako da kolektivnim ugovorima neće moći da se zaštite sva radnička prava jer će verovatno biti pomerena na minimum.

Takođe, uglavnom Predlog zakona o radu ima i suštinskih i gramatičkih grešaka, na šta ćemo ukazati svojim amandmanima, ali sam ja sam u domet predloga da ovaj zakon u načelu bude prihvaćen i tako će i naša grupa glasati, ali ćemo svoj doprinos u toku daljeg rada, maksimalno ćemo se angažovati jer smatramo da je jedan od najznačajnijih zakona koji su došli u parlament i jedan od bazičnih zakona sa kojim su povezani i mnogi drugi zakoni. Hala lepo!

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha në emër të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike kush e kërkon fjalën? Fjalën e ka deputetja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Ligji i punës është një lig bazik që rregullon marrëdhëniet e punës në çdo vend. Kosova që prej dhjetë vjetësh funksionon akoma me një rregullore të UNMIK-ut në relacion me rregullën e punës. Deputetët pothuaj se në çdo mandat kanë insistuar që të nxirret ligji i punës, sikur që bëhet në çdo shtet. Ç’është e vërteta, në mandatin e kaluar ky Kuvend pati nxjerrë një ligj të punës i cili nuk është nënshkruar për shkak të kostos që pat. Tashmë na është paraqitur nga Qeveria një variant tjetër i Ligjit të punës. Pritja për këtë projektligj ka qenë shumë e gjatë dhe tepër e lodhshme dhe acaruese, sepse relacionet në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit ishin të brishta dhe të drejtat e të dy palëve kërkonin një qasje ma serioze midis tyre.

Ky projektligj është ligj bazik dhe shumë ligje të aprovuara në Kuvend kushtëzoheshin apo rrjedhin nga Ligji i punës, siç është Ligji i grevës, Ligji për organizimin sindikal, Ligji për Inspektoratin e punës, Ligji për mbrojtjen në punë, Ligji për sigurimin shëndetësor, Ligji për sigurimin pensional, Ligj për mbrojtjen e fëmijëve, Ligji për aftësimin dhe punësimin e personave me nevoja të veçanta etj. Është pritur shumë që Rregullorja e punës, e cila kishte shumë mangësi dhe ligji i pamandaturar të jenë një motiv i madh që të nxirret një ligj i mirë i punës.

Në debatet e organizuara në mandatin e kaluar në lidhje me këtë temë, por edhe në debatet që rrodhën këto ditë në lidhje me Ligjin e punës, është theksuar se kostoja e lartë e ligjit, në rend të parë të pushimit të lehonisë, është një pengesë për nxjerrjen e një ligji të mirëfilltë të punës. Madje është thënë se benificionet dhe të drejtat e punëtorëve dhe pushimi i lehonisë mund t’i trembin investitorët e mundshëm, gjë shumë e pabesueshme, sepse as me këtë rregullore që e patëm për dhjetë vjet, ne nuk patëm investitorë të mjaftueshëm dhe mund të themi se nuk i patëm fare.

Mund të them se një nga shkaqet e rënies drastike të natalitetit, që e theksoi edhe kryetari i Komisionit për Shëndetësi dhe Çështje Sociale, në Kosovë, që është një rënie gati 50%, është pasiguria në punë, pushimi i ulët i lehonisë, më i ulëti në regjion dhe që është edhe çështje e diskriminimit gjinor në këtë aspekt. Argumentet e një shoqërie se pushimi i lehonisë është shumë i shtrenjtë dhe është barrë dhe çështje e një gjinie, është i gabuar, sepse kjo është detyrë e të dy gjinive dhe e gjithë shoqërisë. Pushimi i shkurtër i lehonisë do të kishte kuptim vetëm nëse shoqëria jonë do të kishte më shumë çerdhe, më shumë kopshte për përkujdesjen e fëmijëve dhe foshnjave, më shumë përkujdesje të fëmijëve të sëmurë dhe ne nuk kemi çerdhe, asnjë çerdhe të tillë që do të kujdesej për fëmijët e sëmurë, infrastruktura rrugore dhe transport të lirë që nënat të mund t’i ushqenin fëmijët në gjë për nëntë muaj, ashtu siç është paraparë në bazë të Ligjit për ushqimin obligativ të fëmijëve për 9 muaj.

Sakrifikimi i natalitetit ose punësimi i grave është i padrejtë dhe ndikon drejtpërdrejt edhe në standardin e familjes. Gjithashtu, vlen të përmendet edhe orari i punës, që për kushtet tona kërkon një trajtim më ndryshe. Thuhet: “ më mirë një ligj i keq, se sa një shtet pa ligj”, në këtë rast pa Ligjin e punës.

Mendoj se amendamenti i mirë i këtij ligji do ta bëjë më të përshtatshëm dhe më funksional vetë ligjin. Është afati i fundit që ta kemi një ligj të punës, qoftë që edhe pas 6 muajve të kërkojmë ndryshimin e tij.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është i gatshëm ta miratojë këtë ligj me shumë vërejtje, por edhe të japë kontributin e vet në përmirësimin e tij. Gjithashtu, flas në emrin e Grupit të Grave Deputete dhe pres që pas një paneli të gjerë, dialogu me shoqërinë civile, me sindikatën, me gratë akademike dhe të tjerë, do të japim kontributin në përmirësimin e ligjit.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike kush e kërkon fjalën? Nurishahe Hulaj.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit! I nderuar kryetar i Kuvendit, Kabinet Qeveritar dhe deputetë të nderuar, Projektligji i punës është promotori i rregullimit të marrëdhënies së punës dhe zhvillimit të bizneseve në vend. Tanimë, pas shumë përplasjeve të këtij projektligji, në relacionin Qeveri – Kuvend, Qeveri – Fond Monetar Ndërkombëtar dhe drejt te Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për ta reduktuar në atë masë sa për të nxjerrë produktin e fundit bazë të ligjit të punës sa solid aq edhe i varfër.

Të gjithë ne këtu e kemi kërkuar këtë projektligj, të domosdoshëm për një mirëqenie më të mirë për të punësuarit, ku do të rregullohen të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës. Gjithashtu procedurat e realizimit të tyre, kontratat kolektive dhe kontratat e punës, në përputhje me konventat ndërkombëtare të punës dhe legjislacionin e BE-së, por kjo e fundit me këtë projektligj parashihet të rregullohet në vazhdim me hartimin e akteve normative ligjore shtesë për të qenë projektligji më i përafërt me legjislacionin e BE-së. Vlerësimi i ndikimit buxhetor për bazë ka vitin 2010, ku është vlerësuar se do të ketë një vlerë rreth 1.8 milionë euro në vit. Unë konsideroj se kjo vlerë nuk është aq e madhe për një segment shumë të rëndësishëm, për një ligj të punës për qytetarët e Republikës së Kosovës. Konsideroj se po kjo vlerë, domethënë, 1.8 milionë t'i shtohet gjatës shqyrtimit të kornizës afatmesme 2011 – 2013 për ta plotësuar dhe për të avancuar nenin 48 të pushimit të lehonisë.

Unë kam disa vërejtje në dispozitat e këtij projektligji të cilat do t'i paraqes. Vërejtja e parë. Neni 48, pushimi i lehonisë të mos jetë 3 muaj me mundësi zgjatje edhe për 1 muaj, por të jetë 6 plus 6 muaj, që donë të thotë 6 muaj me pagesë dhe 6 muaj me gjysmë orari, pra gjithsej 12 muaj ashtu siç e kanë edhe vendet e rajonit si Shqipëria, Mali i Zi, Kroacia, Maqedonia e të tjera. Pse duhet me qenë 6 plus 6 muaj. Unë do t'i paraqes disa arsye që janë shumë të rëndësishme. Konsiderohet se nataliteti në Kosovë është në rënie sipas ekspertëve, vlerësohet se faktorët që kanë ndikuar në rënien e natalitetit respektivisht të lindjeve janë faktorët: socio-ekonomikë, legjislacioni jo i favorshëm për shtatzëna dhe lehona, mungesa e masave stimuluese, kujdesi jo në nivel të duhur artenatal e tjera. Në bazë të dhënave të Entit Statistikor të Kosovës dhe të ekspertëve të Klinikës Opstretrike – Gjinekologjike, vlerësohet se në vend në vitin 2000 janë raportuar 39 mijë e 91 lindje, domethënë për periudhën 2001-2008 ka rënë nataliteti në Republikën e Kosovës 27.9% që është një indikator shumë i lartë. Të dhënat janë ende më të shqetësuese kur dihet se shkalla e lartë e vdekshmërisë tek ne është ende e lartë.

Vërejtja e dytë në projektligj të punës. Neni 7 paragrafi 4 thotë, të miturit 12 deri 15 vjet mund të kryejnë punë të lehta deri në 6 orë pune në javë, konsideroj se 12, grupi 12-15 vjeç ende është moshë e re për t'u ngarkuar me punë. Ky grup moshë rrezikohet të mbetet e pa arsimuar në nivel të duhur duke vrapuar pas punës jot ë sigurt.

Vërejtja e tretë. Neni 9, për kontratën e punës, paragrafi 1 thotë: “kontrata e punës mund të lidhet në formë të shkruar apo verbale.” Konsideroj se forma verbale e kontratës nuk del serioze dhe korrekte andaj duhet të hiqet nga projektligji.

Vërejtja e katërt, paragrafi 10 i nenit 9 të projektligjit nuk i jep të drejtë të punësuarve për punë specifike për ditë të pushimit. Pra vjen në kundërshtim me paragrafin 1 pika 1.1. dhe 1.2 të nenit 35 të projektligjit që thotë kështu: “i punësuari ka të drejtë së paku 1 ditë e gjysmë të pushimit për çdo muaj kalendarik të kaluar në punë nëse në vitin kalendarik në të cilin për herë të parë i punësuari ka themeluar marrëdhënie pune nuk i ka 6 muaj të punës së pandërprerë dhe nga

paragrafi 1.2 thuhet “nëse në vitin kalendarik nuk e ka fituar të drejtën për pushimin e shfrytëzimit vjetor për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës”.

Dhe, vërejtja e pestë, e fundit. Neni 87 i Ligjit – e drejta e grevës, konsideroj se duhet të hiqet sepse paragrafi 2 i nenit 86 e rregullon këtë çështje ku thuhet të drejtat dhe liritë e organizimit sindikal rregullohen me ligj të veçantë. Tanimë ekziston ligji për grevat.

Dhe në fund shpresojmë se në 6 mujorin e dytë të vitit 2010 Projektligji për punën do të jetë i zbatueshëm, ky ligj shumë i kërkueshëm nga ne dhe ne e përkrahim, pra Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet në parim këtë projektligj dhe ne, unë personalisht, në komisionin funksional do të jap kontributin tim që të jetë një ligj sa më i avancuar dhe sa më i mirë e në veçanti për grupin e nënave, periudha riprodhuese shumë sensitive, shumë e ndjeshme që e kërkon një përkrahje të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar për Aleancën, është deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar qeveritarë,

Deputetë të nderuar,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mirëpret shqyrtimin e sotëm të Projektligjit të punës edhe pse pritjet tona kanë qenë që Qeveria do të ofrojë zgjidhje më të mira se sa që këto aktualisht i shohim në këtë projektligj.

Deri më sot projektligji ka kaluar nëpër disa epizoda në Kuvendin e Kosovës, nganjëherë është tërhequr nga Qeveria dhe nganjëherë ia ka kthye Kuvendi për shkak të mangësive që ka pas projektligji. Prandaj, që në fillim dëshiroj të theksoj se Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar me një seriozitet të jashtëzakonshëm këtë projektligj.

Koncepti i këtij projektligji është i bazuar në arritjen e balancit në mes të mbajtjes së mundësive maksimale ekonomike dhe të drejtave të punonjësve, megjithatë vërehet se më shumë ka anim kah punëdhënësit, nëse merren parasysh dispozitat për pushimin e lehonisë, prezantimin e punës së fëmijëve, kontratat verbale dhe kapacitetet e vogla të Ministrisë për Mbikëqyrje.

Zgjidhjet e ofruara në Projektligj zbatojnë kryesisht për të punësuarit në sektorin privat dhe publik, për ata në fushën e shëndetësisë, arsimit dhe në ndërmarrjet publike. Megjithatë Qeveria nuk ka pas guximin që t’i adresojë çështjet vitale për punëtorët dhe familjet e tyre.

Në një mënyrë ky projektligj ka hije dhe dritë. Hija është, arsyen që e përmenda, mungesa për t’i adresuar çështjet vitale kurse drita sepse përmban më shumë, më pak në të vërtetë gabime teknike dhe profesionale dhe me këtë ka shans më shumë të kalojë në Kuvendin e Kosovës pas 10 vjetëve të kemi një ligj të punës.

Por po i kthehem prapë përmbajtjes së ligjit. Për fat të keq nuk është adresuar fati i punëtorëve të shumë ndërmarrjeve shoqërore të cilat e kanë humbur punën për shkak të privatizimit. Personat të cilët e kanë humbur punën dhe nuk kanë arritur moshën e pensionimit nuk mundtë gëzojnë të drejtën e pensionimit dhe në këtë mënyrë detyrohen që në moshën 40-50 vjeçare të kërkojnë punë dhe në lëmshë nga të tjerët edhe pse kanë pasur një stazh shumëvjeçar dhe një kontribut të madh në këto ndërmarrje shoqërore. Theksin e veçantë dëshiroj të vë sidomos në çështje e pushimit të lehonisë të përcaktuar në nenin 48. Është më e disfavorshme se sa Rregullorja aktuale e UNMIK-ut, për arsye se parashihet vetëm 3 muaj pushim të lehonisë

pagesë dhe 1 muaj shtesë, derisa rregullorja aktuale parasheh 3 plus 3, do të thotë 3 muaj paguhen nga punëdhënësi dhe 3 muaj tjerë nga Ministria, nuk kemi zgjidhje të tillë dhe për Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës kjo është diskriminim dhe është i papranueshëm. Propozimi ynë është që kjo të zgjatet dhe të jetë 12 muaj. Çështja tjetër është se si duket punësimit janë bërë në të vërtetë në kurriz të të drejtave të grave sa i përket sidomos të drejtave të lehonisë.

Në anën tjetër zgjidhjet të cilat janë ofruar është se çfarë do të bëhet pas 3 muajve të lehonisë. Në Kosovë nuk ka çerdhe ose ato çerdhe janë për fëmijët pas moshës njëvjeçare, po ashtu nuk ka ndonjë zgjidhje për gratë të cilat lindin bineqë, apo çka për gratë të cilat lindin më shumë fëmijë, pas fëmiut të tretë e tjerë, të gjitha këto të cilat i bëjnë shtetet tjera dhe përkujdesen për nënën. Prandaj, të nderuar kolegë, nuk duhet kuptuar çështjen e pushimit të lehonisë si çështje të trajtimit të veçantë të gruas, por si çështje e familjes dhe e vetë shoqërisë së Kosovës, sepse mospërkujdesi do të sjellë pastaj në një familje jo të shëndoshë.

Nënën tjetër, edhe sa i përket kostos, kjo kosto do të jetë më e vogël në qoftë se nëna ashtu siç e promovon Qeveria do të bëjë gjidhënien diku 6 muaj ose edhe siç e kemi edhe Ligjin për nxitjen dhe mbrojtjen së ushqyerit me gji. Fëmija nuk do të sëmuret, nëna do të jetë më e shëndoshë dhe në këtë mënyrë kontributi i saj ekonomik do të jetë gjithashtu më i madh dhe po ashtu edhe i vetë familjes. Në fund të fundit edhe vetë ligjet tjera garantojnë një gjë të tillë - Ligji për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri që garanton 6 muaj dhe Ligji për shëndetin riprodhues që garanton amësinë e sigurt.

Një çështje tjetër që dëshirojmë të ngrisim është ajo që e ka prezantuar Qeveria, është puna e fëmijëve. Ne jemi të mendimit se nuk është sqaruar mirë se cilat janë punët e lehta të fëmijëve, a janë punët e lehta të fëmijëve shitja e cigareve në rrugë apo janë punët e lehta të fëmijëve ndoshta punët që mund t'i kenë fëmijët në teatër dhe kjo çështje gjithashtu duhet sqaruar. Projektligji, po ashtu nuk parasheh një çështje shumë të rëndësishme që është paga minimale e që në Kosovë është e domosdoshme të përcaktohet, sepse duhet të mbrohen punonjësit nga eksploatimi i padrejtë dhe kanë të drejtë në mbrojtjen e dinjitetshme të tyre. Po ashtu, sa i përket mekanizmave për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit këto nuk janë fuqizuar dhe nuk janë të mjaftueshëm. Edhe ekziston po ashtu një mosharmoni me ligjet tjera, pos dy ligjeve që i përmenda dhe Ligji për shërbimin civil, për shërbyesit civilë, sepse parashihet në këtë ligj 2 vjet përvojë pune dhe 5 ditë pushim, kurse në projektligjin aktual 5 vjet pune dhe 1 ditë pushim. Me fjalë të tjera ministrin e dëgjova me shumë kujdes tha se problem ka qenë kostoja. Zoti ministër kostoja nuk mund të jetë barrierë për respektimin e të drejtave bazike të punëtorëve, për të drejtat e qytetarëve për punë dhe jetë të dinjitetshme. Te kontrata verbale, duhet të rregullohet me dispozitë të veçantë e drejta për kontratë ashtu që punëdhënësi t'i ofrojë kontratën e punës me shkrim, punëdhënësi duhet të mbajë edhe regjistrin për punëtorin, të dhënat për kontributet, obligimet gjithashtu.

Po shkoj në vërejtjet e veçanta, neni 2.2. duhet të definohej lëndimet në punë dhe jashtë punës.

Neni 77, duhet të caktohet afati për ngritjen e kontestit të punës kur punëtori bën ankesë. Kontrata kolektive nuk i mbulon të gjithë punonjësit, prandaj duhet me akt nën ligjor kjo të definohej mirë ashtu që të jenë përfshirë të gjithë.

Sa i përket nenit 58 te rastet e lëndimit në punë që parashihet 10 deri në 90 ditë, çka do të bëhet në qoftë se punëtori nuk rehabilitohet për 10 deri në 90 ditë, a do të thotë se duhet të vijë i sëmurë në punë?

Prapë po kthehem te dispozitat e mbikëqyrjes. Inspektorati duhet të fuqizojë që të mund të ekzekutojë vendimet dhe dispozitat e këtij projektligji. Neni 89 është shumë i përgjithësuar, para se të bëhen gjokat, duhet të bëhen vërejtjet, janë paraparë dënimet diku prej 100 euro deri në 10 mijë euro, po nuk është e përcaktuar se në cilat raste a do të gjobitet 100 euro e në cilat raste 10.000 euro apo edhe dyfishimi dhe trefishimi i kësaj.

Neni 80 duhet të bëhet jo vetëm mbrojtja e punësuarit, nga inspektorati, por edhe i punëdhënësit me këtë ligj.

Në fund të nderuar kolegë, Grupi Parlamentar i Aleancës do të angazhohet në amendamentimin e Ligjit në Kuvend lidhur me vërejtjet të cilat i prezantova por në parim e mbështesim me qëllim që më në fund të miratohet në Kuvend dhe punonjësit të kenë ligjin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Para se t'ia jap fjalën kryetarit të Grupit Parlamentar të AKR-së, në emrin tim dhe tuajin po e përshëndesim Delegacionin e Sindikatave të Pavarura, të udhëhequr nga kryetari me bashkëpunëtorë. Në emër të AKR-së, kush e do fjalën? Në emër të AKR-së fjalën e ka deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zotëri kryesues.

Zoti kryetar,

Përshëndetje për të gjithë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re e ka shqyrtuar këtë projektligj të rëndësishëm. Në parim e përkrahim, shumë normal sepse është shumë me rëndësi, mirëpo i kemi edhe vërejtjet tona të cilat do t'i paraqes tani.

Neni 2, fusha e zbatimit thotë se dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe sektorit publik, sektori privat duhet të jetë nën dy, sektori publik duhet të jetë nën një.

Neni 9, kontrata e punës. Kontrata e punës, pika 1 do të thotë, mund të lidhet në formë të shkruar apo verbale nëse për të pajtohen i punësuarit dhe punëdhënësi. Menjëherë në pikën 2 paraqiten rastet kur mund të lidhet kontrata në formë verbale gojore do me thënë dhe parashihen raste që mund të lidhet deri në një muaj me familjarët, do të thotë shpjegohen rastet mirëpo ne nuk jemi të pajtimit, kontratë verbale nuk duhet të ketë, vetëm në formë të shkruhet edhe nëse ka të bëjë edhe për një muaj duhet të jetë në formë të shkruar.

Pika 7 e të njëjtit nen thotë, kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se 10 vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pa caktuar kohore. Këtu kur kemi të bëjmë me kontratat në kohë të caktuar dhe në kohë të pa caktuar ligji më mirë me thënë projektligji parasheh se kontratat në kohë të caktuar mund të lidhen deri në 10 vite çka jemi kundër sepse çdo ripërtirje e kontratës është stres për të punësuarin. Ky afat duhet të jetë shumë, shumë më i shkurtër se 10 vite, sepse parasheh 10 vite për kohë të caktuar, pas 10 viteve të drejtën për me u lidhë kontrata në kohë të pacaktuar.

I njëjti nen pika 8 thotë se, në të vërtetë pika 8, kontrata për një detyrë specifike nuk mund të jetë më e gjatë se 120 ditë brenda një viti. Neve na intereson çka nënkuptohet me punë specifike dhe na intereson se këta punëtorë që punësohen për 120 a kanë të drejtë në stazh apo në përvojë, sepse mund të bëhet keqpërdorim nga punëdhënësi të merret për 3 muaj dhe pastaj t'i ndërprehet marrëdhënia e punës dhe prapë të merren për 3 muaj punëtorë tjerë, kjo është mirë të definohet.

Pastaj i njëjti nen, domethënë neni 9 pika 10, thotë se të punësuarit për një punë specifike nënkuptohet në këtë 120 ditëshin nuk i takon e drejta në pushim vjetor, pushim mjekësor dhe të drejtat tjera të përcaktuara me kontratë kolektive dhe kontratën e punës. Nuk i takon e drejta e pushimit mjekësor e çka bëhet nëse ai sëmuret, këtu duhet të rregullohet, do të thotë ai ka të drejtë, ai duhet me marrë pushim mjekësor nëse sëmuret mirëpo nuk i takon pagesa për pushimin mjekësor që e merr. Pastaj neni 12 pika 4, për mua është e pa kuptueshme, është mirë i njëjti, domethënë e njëjta pikë të sqarohet. Neni 15, thotë: praktikantët, pika 3, mbrojtja dhe siguria në punë duhet të përfshihet për të gjithë e jo vetëm për praktikantët, sepse mbrojtjen dhe sigurinë në punë e përfshin vetëm për praktikantët, do të thotë, këtu duhet të përfshihet mbrojtja edhe për të punësuarit tjerë.

Neni 19, faqe 21 thotë, pika 3, për të punësuarin i cili është më i ri se 18 vjet nuk mund të jetë më shumë kur është orari i punës, orari i punës javor 35 orë. Për punëtorët, do të thotë, mbi 18 vjet është 40 orë, 5 orë dallim është shumë pak, si te orari i punës thotë 15 deri 18 vjet nuk përcaktohet orari javor i punës, sa orë është, si dhe prej 12 deri në 15 është përcaktuar 6 orë, ajo është në rregull sepse lejohet puna e fëmijëve për punë të lehta, që është për shembull palosja i teshave e kështu me radhë.

Në shumë nene kam has në përdorimin e termit “me kompensim page”, do të thotë paga është rrogë, paga shpërblehet me të holla, pagesë mujore, ditore që i jepet një punonjësi për punën e tij, mujore apo varësisht qysh merren vesh. Kompensim është dëmtim, do të thotë merret, është një kuptim ndryshe, tash të dyja janë përdorur, kompensim page, këtu e ka marrë edhe pagën mujore edhe kompensimin – zhdëmtimi. Çdo kund duhet fshirë kompensimi po të jetë vetëm paga.

Neni 26, faqe 26, thotë puna e natës. Punën e natës për një javë, gjatësinë e punës së natës e parashohin për një javë, domethënë, 7 netë pa pushim dhe thotë nuk mund të jetë më e gjatë se 7 netë, unë mendoj se është 7 netë shumë për të punuar një javë dhe mendoj se është mirë me u shkurtua në ditë më pak.

Gjithashtu thotë, neni 29, pushimi ditor ku thotë i punësuar ka të drejtë në pushim ditor midis dy ditëve të njëpasnjëshme të punës në kohëzgjatje së paku 12 orë, së paku 12 orë, 12 orë konsideroj se janë pak dhe së paku mendoj se në ligj nuk është mirë të lihen së paku apo më së tepërmi, por duhet përkufizuar sa, përndryshe me siguri se kjo së paku do të respektohet gjithmonë 12 orëshi, nuk do të jepet kurrë më shumë orë pushimi, për këtë arsye duhet të specifikohet sa është.

Neni 40, thotë pezullimi i përkohshëm i të drejtave dhe detyrave nga marrëdhënia e punës, te pika 1.3 deri në marrjen e vendimit të formës së prerë nga gjykata në kohëzgjatje deri në 6 muaj, kjo duhet të sqarohet sepse është e paqartë.

Neni 44, pika 1 dhe 2 janë në kundërshtim me njëra-tjetrën, flet për mbrojtjen e të rinjve. Neni 1 thotë se nuk mund të punësohen të rinjtë në punët ku dëmtojnë shëndetin e të rinjve, neni 2 thotë se duhet të sigurohet për të rinjtë masat t’ia mbrojnë shëndetin, domethënë, me një anë nuk mund të punësohen, në tjetrën anë thotë duhet për t’i mbrojtur, kështu që nuk janë në pajtim me njëra-tjetrën, 1 dhe 2.

Neni 48, shumë i përfolur dhe i diskutuar, është pushimi i lehonisë. Sipas këtij projektligji para lindjes shtatëzëna, domethënë, mund të shkojë në pushim 45 ditë para lindjes, si dhe është një periudhë, do të thotë, nëse ka probleme mjekësore dhe 28 ditë me marrëveshje me punëdhënësin, këtu jam shumë kundër me marrëveshje me punëdhënësin, 28 ditë duhet të jenë me ligj të parashikuara që ajo të shkojë në pushim, sepse për të fillon një periudhë më e rëndë dhe e re,

kështu që 28 ditëshi nëse e lëmë këtu në marrëveshje me punëdhënësin e ia heqim ditët e pushimit pas lindjes, atëherë me siguri se secila shtatzënë do të këqyrë të punojë deri në momentin e fundit duke rrezikuar shëndetin e vet. Kjo duhet të hiqet gjithqysh.

Pas lindjes, ky projektligj i parasheh 12 javë apo 3 muaj. Konventa 183 për mbrojtjen e lehonave i parasheh bile 14 javë, 2 javë bile më shumë, mirëpo ju keni shkua 2 javë më pak, 12 javë – 3 muaj. Këtu Grupi ynë propozon që 6 muaj të jenë me pagesë të plotë pushim i pandërprerë për lehonat dhe 6 muaj të jenë 50% prej rrogës, ti marrë. Këto vërejtje do të thotë i kemi. I kemi disa vërejtje tek neni 58 pika 4. Për të lënduarit në vendin e punës parashihet pushimi mjekësor me pagesë prej 10 deri në 90 ditë, çka pastaj, nuk është shëruar, ka lëndim trupor dhe pas 90 ditë s'ka pagesë, përndryshe ai u lëndua në punë dhe do të jetë kërkaq hiq kështu që kjo një mbrojtje e punëtorëve nuk është. Këtu duhet të parashihet deri në shërimin e plotë se është lëndim lidhur me punën, në detyrat e punës. Nuk është kufizim i mirë jo me kufizuar 10 deri

(Ndërprerje nga regjia)

Drejtimin e seancës e merr zoti Naim Maloku, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit parlamentar të LDD ftoj deputetin Naser Rugova ta marrë fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Më në fund pas shumë odiseadave dhe premtimeve historike erdhi para deputetëve në një seancë plenare Ligji i punës që nuk është ndojfarë arritje e jashtëzakonshme po është një ligj normal që i ka mungua për shumë vite sidomos këtë vitin e tretë të qenunit shtet, krijimit të raporteve ligjore të mirëfillta në mes punëdhënësit, punëmarrësve, në përputhje me rregullat e ekonomisë së tregut dhe të punës. Ka qenë gjithmonë një arsye e mosmiratimit të këtij ligji bazik, implikimet buxhetore, me arsyetime se janë shumë të larta, patën filluar një herë me shumë astronomike, 64 milionë euro, 22 milionë dhe tash së fundi 1.8 milionë euro. Jemi të mendimit që gjithmonë ka munguar ekspertiza e mirëfilltë financiare për këtë ligj të rëndësishëm si rezultat i qasjes jo serioze të Qeverisë dhe kalkulimeve jo profesionale. Po t'i shikosh me vëmendje deklaratën financiare dhe vlerësimin e ndikimit buxhetor të krijohet përshtypja që një asociacion i letrarëve apo dramaturgëve e kanë bërë kalkulimin dhe vlerësimin e nevojshëm financiar. Ju lutem ky është projektligj i hartuar nga mekanizmat më të lartë të shtetit nga institucionet relevante kompetente. Këtë e ilustrojmë me fakte, po e citoj deklaratën financiare apo vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligjit të punës. Kostoja shtesë buxhetore është një supozim dhe parashikim përlllogaritja e së cilës është ballafaquar me mungesa të shumta të të dhënave, pa qartësi dhe rreziqe financiare. Çfarë mesazhi është ky për punëtorinë kosovare, për punëdhënësit për punëmarrësit, për sindikatat, çfarë mesazhi përçon kjo deklaratë financiare kur e dëgjojnë punëtorja kosovare, kush përkujdeset për zbatimin në praktikë të këtij ligji duke i ditur ambientet e punës, rrethanat po edhe krizën e madhe ekonomike dhe sociale që mbretëron në vendin tonë. Gjithashtu këtë vlerësim dhe identifikim të kostove buxhetore e përshkon edhe një shkallë e lartë e pasigurisë, po e citoj deklaratën financiare të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Edhe një citat i kësaj deklarate të famshme. Për shumicën e sektorëve nuk kemi të dhëna për shtesat dhe pagesat e tyre nga buxheti aktual, kush duhet ta bëjë këtë vlerësim, këtë kalkulim financiar dhe buxhetor? Vallë, a duhet të presim dike nga Bashkimi Evropian apo nga Shtetet e Amerikës Latine apo të Afrikës, atje? Ju lutem, kur dokumentacione të tilla të vijnë në organin më të lartë legjislativ të shtetit tregon që Qeveria ose është duke e lënë në stihë punën e vet ose

atëherë është një dilemë tjetër që në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave nuk është i punësuar asnjë ekonomist. Dhe këtu definicion tjetër nuk ka.

Përkundër nevojës së madhe për këtë ligj hartuesi i këtij draftligji në këtë rast Qeveria e Kosovës nuk ka guxuar ta sjell një projektligj të tillë të rëndësishëm organik që prek një fokus të gjerë të shoqërisë kosovare në këtë gjendje.

Projektligji i punës tani i sjell në këtë vend, në këtë mënyrë dhe në këtë përmbajtje e sfidon Kuvendin duke pasur parasysh kërkesën e arsyeshme dhe të pakontestueshme që e parashtrojnë qytetarët e vendit tonë që ta kenë një ligj normal bazik të punës. Tani ai është shumë restriktiv, qoftë në aspektin e mendimit, përmbajtjes së strukturës dhe qëllimit të tij dhe në njëfarë forme nuk është asgjë më i mirë se Rregullorja e UNMIK-ut. Mos të harrojmë që jemi shtet, shtet i pavarur po themi dhe sovran dhe kemi përgjegjësi si institucione, më nuk jemi nën protektorat.

Shumë parafolës, kolegë të mi të nderuar, shprehen shqetësimet e tyre për nenet e caktuara, paragrafet e caktuara. Ky është një ligj i zbehtë, i cili bie ndesh edhe me Ligjin për shërbyesit civilë, ka interferime, paqartësi. Në atë ligj tani definohen gjërat me afate kohore dhe dinamika tjera, kurse në këtë projektligj që e ka hartuar e njëjta qeveri ka diskrepanca serioze.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, do ta përkrahë në parim me vërejtje esenciale dhe kontributin tonë do ta japim në punën e mëtutjeshme në komisionet profesionale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar 7+ deputeti Xhezair Murati e ka fjalën!

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Dozvolite da pozdravim i prisutne članove Vlade. Mislimo da je Predlog zakona o radu dobar jer drugi do sada nismo imali, a loš jer ima dosta manjkavosti, nedorečenosti i tako dalje. Mi smo kao retko kada do sada izvršili detaljan uvid u Predlog zakona o radu i ja se dobrim delom slažem sa kolegama dosadašnjim govornicima da te manjkavosti i nedostatke u daljnjoj proceduri popunimo, jer kad ga uporedimo sa istim zakonima u okruženju, videćemo da je sadržajno, znatno uži, dakle manje tretira mnoga pitanja, pogotovo izražavamo rezervu kada je u pitanju budžet, odnosno budžetske implikacije, jer ako je to samo toliko, onda šta on to dodatno zaobilazi dok je samo 1,8 miliona tih implikacija.

Kažem, kao deo ovoga opterećenja odnosi se naravno i trošak za naknade štete za neiskorišćavanje godišnjeg odmora i ja bi se tu zadržao na član 37, gde nije jasno predviđeno zašto je u opšte ovaj član tu ubačen, ako već ne predviđa neiskorišćavanje godišnjeg odmora. Tu je moglo da se nađe neko drugo rešenje, da radnik mora iskoristiti godišnji odmor i da se ne može odreći s time što mu treba da mu se pruži mogućnost produženog iskorišćavanja do 6 meseci ili do godinu dana, kako to već neki drugi rade. Dakle, to ne bi bilo u suprotnosti sa Konvencijom o međunarodnoj organizaciji rada o godišnjim odmorima i odsustvima.

Pošto je meni demografija i po struci bliža kao grana, ja ću ovde napraviti ovako jednu možda skeptičnu primedbu da kada je u pitanju, svi su govorili, ja bih rekao jedan oktroisan period korišćenja porodiljskog odsustva, možda je to stvarno neko namerno uradio u poređenju sa, to kažem skeptično, sa kineskim zakonom koji je tako restriktivan kada je u pitanju kratkoća bolovanja porodiljskog i da sam tu takođe u skladu sa predlozima mojih kolega da se ovaj rok znatno produži kako žene ne bi bile na taj način diskriminisane.

Dalje, kada je u pitanju član 55, ja bih rekao da recimo noćni rad kod nas nije adekvatno predviđen. Recimo, uzmimo samo iskustvo ovog zakona u Albaniji, koji kada se radi noću od 19 do 22 sata, nadoknada se plaća od 20% a u periodu od 22 do 06, recimo sutradan, nadoknada je od 50%. Ne želim da se to bukvalno prenese, ali postoji ovde dakle šansa i mogućnost da se onima koji rade noću izađe u susret kako bi bili adekvatnije nagrađeni.

Dalje, kada je u pitanju član 75, o ovoj otpremnini, takođe smo mišljenja da je ona ponižavajuća za one koji su najveći deo radnog veka proveli u organizaciju u kojoj su radili. Dalje, ja bih takođe pomenuo još neke nedostatke kada je u pitanju recimo ugovor o radu. U predlogu nije razgraničeno šta je interni akt i da li je to pravilnik o radu i da li ima veze sa kolektivnim ugovorom i da li je poslodavac obavezan da ga izradi, donese i tako dalje, tako da to nije dovoljno pojašnjeno i treba sigurno još malo ima tu prostora da se on pojašni.

O tome da ima mnogo suštinskih i jezičkih grešaka, svi su govorili i mislim da niko nije naveo da u verzijama na različitim jezicima takođe postoje suštinske razlike i želim da se u naknadnoj proceduri one ublaže ili otklone.

Sve u svemu, mi dakle se pridružujemo svim ostalim do sada izlagačima da mi ovaj nacrt zakona podržavamo, ali smo za to da mu se ozbiljno pristupi u naknadnom radu kako bi smo zaista ozbiljne propuste koji postoje u njemu do sada dopune i zahvaljujemo konačno Ministarstvu za rad i socijalnu politiku da smo makar i sa ovolikim zakašnjenjem uspeli da ga danas iznesemo i mislim da ovo predstavlja jedan veliki iskorak u našem zakonodavstvu usvajanjem ovog zakona. Hvala vam!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, ftoj deputetin Mursel Halili ta marrë fjalën.

MURSELJ HALJILJI: Zahvaljujem, gospodine predsedavajući!

Gospodo ministri i uvaženi resorni ministre,

Dame i gospodo poslanici,

Parlamentarna grupa SLS je vrlo ozbiljno razmatrala ovaj Predlog ili Nacrt zakona o radu. Naše primedbe su terminološke i suštinske, odnosno sadržajne prirode i ja ću odmah krenuti sa izlaganjem.

U članu 2, recimo reč „sprovode se” – “odredbe ovog zakona sprovode se” trebalo bi da se zameni rečju „primenjuju se”. I to bi trebalo da prati čitav tekst ovog nacrta zakona.

Naravno, u istom članu trebalo bi da se doda još jedno vrlo značajno poglavlje, a to su grupa zaposlenih koji se upućuju na rad u inostranstvo od strane poslodavca. Znači, to je jedna velika grupa ljudi koja nije obuhvaćena ovim nacrtom zakona.

Takođe, u članu 3. stav 1.1, zaposleni se definiše kao fizičko lice, mislim da bi bolja formulacija bila „koji je u radnom odnosu kod poslodavca”.

Takođe, član 3. stav 1.2. poslodavac može da bude domaći i strano prano i fizičko lice, a ne samo fizičko lice. Znači u pitanju je jedna dopuna, to je vrlo bitna.

Takođe, u stavu 3. stav 1.10, radni ugovor bi trebalo da se preformuliše i da nosi naziv “ugovor o radu”.

U istom članu, stav 1.11, pripravnik se definiše kao kvalifikovano osoblje, reč osoblje bi trebalo da se izbaci, to je lice koje po prvi put ostvaruje radni odnos, ono „ostvaruje“ trebalo bi da se izbriše i postavi reč adekvatna a to je „zasniva radni odnos“.

Takođe, konfuzna je definicija plate. Najjednostavniji primer bi bila, ili definicija da je plata novčani iznos vrednost iskorišćavanja radne snage.

Zatim, u članu 4. smatramo da treba dodati novi stav sledeće sadržine a to je da pojedina odredba ugovora o radu kojima su utvrđeni nepovoljni uslovi rada od uslova utvrđenim zakonom i opštim aktom smatraju se ništavim. To je vrlo bitna konstatacija. Mislim, može se dogoditi da ugovor o radu sadrži odredbe koje mogu nepovoljnije da budu za zaposlene i za to bi trebalo da takve sve odredbe bile ništave a zatim iza toga odmah i još jedan stav 5. ako se to dogodi znači u slučaju stava 4. ovog člana, primenjuju se odredbe zakona, odnosno opšte ... znači odredbe ugovora se niste.

Zatim, u članu 7. radni odnos može da se zasnuje sa licem a ne sa osobljem i naša formulacija bi bila sledeće sadržine „koje ima opštu zdravstvenu sposobnost i najmanje 15 godina života i ispunjava druge uslove za rad na određenim poslovima utvrđenim odgovarajućim aktom poslodavca“. Smatramo da odrednica od 18 godina je nedefinisana, jer se u sledećem stavu već pominje starosna granica od 15 do 18 godina i, naravno, još jedan stav koji vrlo bitno može da pomogne, a to je da se radni odnos za lice mlađe od 18 godina života može da zasnuje uz pismenu saglasnost roditelja i staraoca. To je veoma bitno, jer su to deca ili kategorije ljudi koji nisu potpuno poslovno sposobni i oni ne mogu da zaključuju ugovore. Zatim, kažem, naravno ako takav rad ne ugrožava njihovo zdravlje, moral, obrazovanje i tako dalje.

Nikako ne može da se prihvati stav 4. gde se pominje da mogu deca od 12 do 15 godina starosti budu angažovana po nekih 6 sati, to je sigurno konstatacija koja ne bi trebala da se prihvati.

Takođe, mora da postoji jedna odrednica ili odredba koja mora zaposlenog da obaveže da kaže poslodavcu sve o svom zdravstvenom stanju, odnosno o drugim okolnostima koji bitno utiču na obavljanje poslova za koje se zasniva radni odnos ili mogu da ugroze život i zdravlje drugih lica. Ovde u ovom zakonu takva odrednica ne postoji, a može da se dogodi da lice koje zasnuje radni odnos iz zdravstvenih ili nekih drugih razloga može da napravi štetu drugim zaposlenima pored sebe kada sutra bude u radnom odnosu.

Znači, sledeća odrednica bi bila znači vezana za ovo da u slučaju ako zaposleni ne postupi u skladu sa ovim napred iznetim, da poslodavac može da raskine ugovor o radu.

Zatim, definicija – ugovor o radu, takođe po našem smatranju i mišljenju nije baš najpovoljnija, možda bi bila bolja da je ugovor o radu pravni osnov zasnivanja radnog odnosa i nikako ne možemo prihvatiti da ugovor o radu može da bude zaključen u usmenoj formi obzirom na sadržinu samog ugovora i ozbiljne posledice samog ugovora, usmena forma zaključenja ugovora je neprihvatljiva.

Nedostaje poglavlje o vrstama ugovora o radu jer bi trebalo sigurno precizirati ugovor o radu sa svim mogućim zaposlenima. Recimo, ugovor o radu sa direktorom, ugovor o radu sa maloletnim licem, ugovor o radu sa stranim državljaninom, ugovor o radu sa kućnim pomoćnim osobljem i tako dalje, i tako dalje. Znači, to su sve ugovori koje bi trebalo specifično nabrajati u zakonu da ne bi bilo problema sutra kada se oni budu zaključivali.

Sama sadržina ugovora u članu, SLS smatra da bi trebalo recimo u članu 10. stav 1.2 osim ovoga što je definisano, znači podaci za zaposlenog, ime i prezime i kvalifikacije.... trebalo bi da stoji stručna sprema i zanimanje zaposlenog. U istom članu, stav 1.7 “vreme trajanja ugovora za rad”, ne nego „ugovora o radu na određeno vreme“ jer na ne određeno vreme apsurd je odrediti ugovor o radu, jer ne možemo mi to definisati. Zatim 1.8. visina osnovne plate, te neki dodatak ili drugi prihod, ali nisu rečeni rokovi za isplatu zarade. Znači, naš predlog je da se mora precizirati rok kada se mora izvršiti isplata zarade.

Još jedan možda stav, vreme trajanja dnevnog i nedelnog radnog vremena, zatim član 13. definicija da je početak rada neadekvatna, možda stupanje na rad je mnogo bolje.

U članu 14. stav 2, probni rad ne može da traje 6 meseci, jer reči ćete 6 meseci je dug period, mislim da bi trebalo 3 meseca, jer 6 meseci jednostavno iskoristimo radnika i onda kada ga probamo, kažemo nisi zadovoljio i doviđenja, idi sada kući. Mislim da to nije baš u redu.

Takođe, otkazni rok ovde je premali u stavu 3. – 2 dana. Mislim da bi 5 dana bilo dovoljno.

Takođe, odredbe koje se tiču radnog odnosa na određeno vreme, radnog odnosa za obavljanje poslova sa povećanim rizikom i radnog odnosa sa nepunim radnom vremenom manjkaju u ovom nacrtu zakona.

Sto se tiče pripravnika i člana 15. trebalo bi da se definiše da sva radna mesta ne mogu da zasnuju radnici ili zaposleni u svojstvu pripravnika, već samo neka radna mesta koja normativnim aktom poslodavaca treba da budu pripređena, znači i to je definicija koja fali, možda jedna primedba obzirom da pripravnik dolazi na posao da obučava se, ali trebalo bi da primi i neku nadoknadu a ne da to bude samo zaštita ili osiguranje na radnom mestu.

Zatim član 16. stav 1. zaposleni se određuju na radno mesto. Trebalo bi da reč adekvatna bude „raspoređuje“ i to isto u celom tekstu nacrtu zakona.

Zatim, što se tiče radnog vremena, preformulacija određivanje radnog rasporeda ne odgovara, određivanje radnog vremena i odmah zatim u stavu 1. istog člana raspored radnog vremena i početak i završetak radnog vremena, njega određuje poslodavac. Zatim trebalo bi da se definiše koliko traje radna nedelja, tu nije definisano, pet radnih dana, zatim radni dan, po pravilu osam radnih sati i tako dalje, i tako dalje, zatim poglavlje o preraspodeli radnog vremena, to određuje poslodavac i to nije baš najbolje rešeno, zatim opet kažem tamo gde postoji reč „raspored“ trebalo bi da stoji „radno vreme“.

Kod poglavlja V, gde su odmori i izostanci, reč “izostanci” bi trebalo da se izostavi i da se stavi „odsustva“ i odmah zatim član 27. „odmor za vreme radnog rasporeda“, adekvatno je „odmor u toku dnevnog rada“.

U članu 29, dnevni odmor piše da je najmanje 11 časova neprekidno, mislim da bi 12 bilo bolje, ne znam zašto 11. Isto je to što se tiče nedelnog, preformulacija bi trebalo „neprekidno“ a ne „neprekidnih časova“.

Zatim, što se tiče godišnjeg odmora, član 36. “Godišnji odmor se može koristiti od dva ili više belova”. To nije u reku, jer trebalo bi, onda bi tokom čitave godine delovi da se podele i onda svakog meseca bi mogao da se koristi godišnji odmor. Pravilnija je formulacija da se godišnji odmor koristi u dva dela. Ovo „više delova“ trebalo bi da se briše.

“Odsustvo sa plaćanjem” trebalo bi da se preformuliše u „plaćeno odsustvo“, ali i jedna konstatacija koja je vrlo bitna, to je da u članu 38, stav 1.2 – “tri dana prilikom smrti užeg člana porodice”. Mišljenja smo da postoji i dodatak „teže bolesti članova“. Znači i “teže bolesti člana uže porodice”....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit parlamentar për integritim, ftoj deputeten Vezira Emrush ta marrë fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Ja sam pažljivo slušala sve svoje kolege i vidim da su se svi trudili maksimalno da daju doprinos u vezi Nacrta zakona o radu.

Sada ja, kao zadnja, jako je teško da neke konsultacije usmerim za ovaj zakon kada je u pitanju da bude što pozitivniji i što primenljiviji na našim prostorima.

Ovaj nacrt zakona o radu je bio pre potreban našem društvu i ja mogu da kažem da nije tačno da uredba UNMIK-a nije bila sprovodljiva, samo je bila velika greška što to nismo praktikovali da sprovodimo. Bila su velika kršenja na terenu kada je u pitanju bio rad i radni odnos, kada je u pitanju bio odnos poslodavca i radnika i ovaj zakon je možda i zakasnio, možda je trebalo da bude prvi posle nezavisnosti.

Zašto ovo kažem? Zato što ovaj zakon je praktično bazični zakon gde se određuje forma, ljudska forma, ljudski resurs, kada je u pitanju rad i radni zadaci, a znamo da se ekonomsko pitanje i socijalno pitanje rešava putem ovog zakona – Zakona o radu.

Kada je sam zakon o radu, ja moram da kažem i pored toga što se maksimalno potrudio gospodin ministar da lobira za ovaj zakon, da ga prihvatimo anas, što nisam protiv, i maksimalno se isto potrudio naš predsednik komisije, koji je isto imao stav da se privati, a pošto sam i ja član te komisije, ja sam malo više pažnje obratila ovom zakonu. Neću da se bavim članovima i stavovima, ali mogu jedno da kažem da je možda jedan od najslabijih zakona i najsiromašnijih zakona u regiji. Zašto ovo kažem? Zato što mi gradimo jedno kulturno društvo, jednu državu koja mora prvo regijski da se uskladi a onda da ide zajedno sa regijom u Evropu.

Mi znamo kakva se događanja ovde zbivaju u zadnje vreme, to neću da oduzimam vremena poslanicima, ali hoću samo da dam do znanja. Ovako, kada je naš zakon o radu, koji danas imamo kao predmet razmatranja, on ima samo 12 poglavlja i 97 člana, dok zakoni u regiji, kao što je Republika Hrvatska imaju 47 poglavlja i 257 člana. Zakon o radu Bosne ima 151 član i 36 poglavlja. Zakon Srbije 287 člana i 52 poglavlja. Zakon o radu Republike Crne Gore 180 člana i 32 poglavlja. Zašto sam ovo nabrojala? Zato što su to zemlje regije i vidimo da je ovaj zakon praktično prepolovljen. Znači, sam nacrt zakona ne daje jasnu sliku, nemamo definisanu sliku sistematizacije i nivelizacije za zapošljavanje. Zašto ovo kažem? U ovoj slici se definiše odnos poslodavca i radnika. Neću da zamaram opet kakvi su uslovi ovde na Kosovu kada je u pitanju, kada se po prvi put zasniva radni odnos pripravički, gde je odužen od 6 na godinu dana, dok je u regiji najviše 6 meseci, gde nije definisano pristup kada imaju, zašto kažem sistematizacija sa školskom spremom, gde u ovom zakonu mora da postoji nomenklatura poslodavca i radnika. Zašto ovo kažem? Zato što postoji broj, kao što je roba na tržištu i ljudski faktor i roba. Znači, ovaj zakon nema osnovnu azbuku za sprovođenje. Nema osnovnu azbuku za dijalog, socijalni dijalog između radnika i poslodavca kada će biti kršenja prava radnika, kršena prava poslodavca i nešto što hoću jako važno da pomenem, nema definisanu sliku kada su u pitanju javna

preduzeća, društvena preduzeća, privatna preduzeća, gde mora da ima javnu predstavku i privatizovana preduzeća kada se menja poslodavac koji treba da preuzima radnike i pod kojim uslovima.

Zakon nema osnovnu stvar kada je u pitanju isto otpuštanje kolektivno. Nema definisano, mi vidimo od dve, od jedne do pet plata da primaju radnici od dve do 30 godina staža, u rasponu neću da zamaram opet kolege, sigurno su čitale. Eh, ovaj zakon šta nema? Nema zakonsku platformu o otpremnini. Nužna otpremnina. Nema zakonsku platformu o akcijama, o deonicama. Zašto? Zato što nisu definisane, nisu odvojena javna društvena i ostala preduzeća gde zakon mora da ima podzakonska akta za sva ova preduzeća.

Mora se definisati poslodavac, mora se definisati radnik, mora se definisati odsustvo, mora se definisati plata, to su stečena prava, mi znamo da imamo po 30 i nešto godina zaposlene radnike koji će izgubiti praktično sa ovim zakonom stečena prava.

Pravo na penziju je pojednostavljeno i stavljeno pod istim brojem od 65 godina. U regiji žene sa 60 godina imaju pristup penzijskim fondovima i to moramo da obratimo pažnju. Kada je u pitanju porodijsko bolovanje, tu je napravljena velika diskriminacija. Samo se plaćaju 3 meseca, sve što treba da plati naša država, naš zavod je izbegao obavezu za plaćanje, samo mesec dana, što znači da država ne gleda pozitivno na kapacitet svojih radnika i na prava porodilja i u opšte radnika. Fondovi moraju da postoje, moraju da se namenski koriste i da ih oformimo preko budžeta koštanja ovog zakona.

Jako je smešno da kažem 1.800.000 za ovaj zakon, da nam danas neko potraži jedna pozorišna predstava, mi smo ovo jako raspoloživi da odvojimo neka sredstva donatorska da damo, mi moramo da dodemo do pravih sredstava da napravimo dobru matematiku, koliko ljudi imamo i kako želimo da planiramo naš natalitet i da kažem mortalitet kada su u pitanju penzije.

Jako velike stvari nisu sistematizovane, analitički se nije prilazilo, matematički, neka prosta matematika konobarska, tako da je stvarno žalosno kada su u pitanju sindikati, sindikalne organizacije, pravo radnika, da ima pravo samo preko inspekcije za rad i pravo preko suda. Mi znamo da u sudovima po 20, po 10 godina leže takvi predmeti, jednostavno radnik ne može da ostvari prava preko ovih organa koje trenutno samo imamo na papiru. Mi moramo neke stvari da definišemo u zakonu, da kažemo da pojačamo službu za zapošljavanje pri zavodu, pri Ministarstvu za zdravstvo i osiguranje. Ovaj zakon nema definisano pored osnovne plate osnovna načela za penzijsko i socijalno osiguranje, kada je u obavezi poslodavac, znači nisu definisane... Toliko se žurim da neke stvari dam i dotaknem. Nisu definisane osnovna načela kolektivnog ugovora i moramo jednostavno, ja ću sama, i u ime naše Grupe maksimalno da se potrudim da dam doprinos za ovaj zakon i da analiziram kako je u regiji, kako je kod nas. Mi svaka davaja, kada je u pitanju na primer odlazak na godišnji odmor ili kada je u pitanju bolovanje su skraćena 70%, 80% je zakonsko pravo koje sleduje radniku, 80% je i prvi stepen kada ide u penziju, ovde je sve skraćeno 70%, sve je jednostavno na sniženoj ceni, tako da ovaj zakon ne brani prava niti radnika, niti poslodavaca. Moramo da imamo dobar konstruktivan zakon, jer sa dobrim zakonom i poslodavac zna kakvo tržište rada ima. Mi smo tržište rada sa ovim zakonom samo još više iskomplikovali, tako da nismo jasni i nećemo mnogo da postignemo prema investitorima. Investitor zna da je u regiji..., mi moramo da uskladimo sa regijom, da uđemo sa sistematizacijom i nivelizacijom sa regijom, da investitor ili da kažem poslodavac zna kada dolazi na naše tržište koje obaveze ima prema radniku, zaštiti, platama i ostalo. Ja ću ovo ponovo da kažem da ćemo maksimum da damo, lično i ja za ovaj zakon, kada je amendentiranje i ostalo, ne bi volela da kasni ovaj zakon i apelujem da se što pre uz ovaj zakon donese Zakon o socijalnom i penzijskom osiguranju kako bi mogli da radimo ovu platformu, jer znamo da je to ...

(Ndërprerje nga regia)

KRYESUESI: Ju faleminderit! Kalojmë në fjalën e deputetëve sipas radhës. Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli, le të përgatitet deputetja Drita Maliqi.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të respektuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përfaqësues të sindikatave,

Ligji që po e shqyrtojmë është i një rëndësie jetike për mijëra punëmarrës të vendit tonë që punojnë tash e sa kohë në kushte, që iu kanë diktuar punëdhënësit, por edhe qindra punëdhënësve lojal ndaj ligjit si dhe shtetit që dëmtohen nga tregu i zi i punës apo parregullsitë tjera që dalin nga mungesa e këtij ligji.

Duke përshëndetur në emër të Partisë Socialiste të Kosovës ardhjen në shqyrtim të këtij ligji, më lejoni që t'i jap vërejtjet për disa lëshime që kanë ndodhur gjatë përpunimit të këtij ligji me bindjen se me këto vërejtje do të bëjnë ligjin edhe më të zbatueshëm.

Sot në Kosovë ka mijëra punëmarrës që punojnë pa kontratë. Ligji që po e shqyrtojmë, veç tjerash ka për qëllim të ndalojë këtë, por nëse lihet paragrafi 2 i nenit 9 kështu siç është, kam bindjen se nuk rregullojmë shumëçka. Dhe aty është kështu, po citoj: "Përveç rasteve kur kontrata lidhet në formë verbale për një periudhë më të shkurtër se 1 muaj, punëdhënësi duhet t'i ofrojë të punësuarit brenda 1 muaji nga lidhja e kontratës një deklaratë me shkrim për kushtet e kontratës. Kjo do të thotë kështu kontrata e shkruar jepet brenda një muaji dhe ne këtu pikërisht këtë po e bëjmë, po e ndalim kontratën verbale dhe jemi duke shqyrtuar si të rregullohen kontratat me shkrim dhe kjo duhet të lidhet me shkrim për mendimin tim prej 1 deri 3 ditë. Në të kundërtën do të vazhdojë mbajtja e punëtorëve pa kontratë në punë. E para, do t'u jepej mundësia edhe disa sipërmarrësve që të mbajnë punëtorë nga një muaj në punë dhe pas një muaji kur vjen koha e nënshkrimit të kontratës, t'i ndërrojnë punëtorët me të tjerë pa marrë asnjë obligim ligjor ndaj tyre. Sot në Kosovë ka shumë raste që veprohet kështu. I marrin në punë dhe për arsye përfitimi kryesisht për shkak të pjesës nga detyrimet i ndërrojnë pas një kohe. E dyta, nëse mbetet kështu siç është, sa herë që Inspektorati i Punës të gjejë punëtorë pa kontratë në ndërmarrje, punëdhënësi ka hapësirë të arsyetohet se punëmarrësi ende nuk i ka bërë një muaj duke punuar dhe ka kohë që do t'ia dorëzojë kontratën me shkrim. Kështu, përveç punëmarrësit, dëmtohet edhe shteti nga shmangia e punëdhënësit nga detyrimet ligjore ndërsa, nga ana tjetër, edhe punëdhënësit lojalë dëmtohen nga ky çrregullim që shkakton kjo formë joligjore e veprimi.

Te përmbajtja e kontratës në punë, në nenin 10, paragrafi 2, ku thuhet se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nuk ka nevojë të thuhet se për nevojat e punëdhënësve do të përgatisë, por thjeshtë thuhet se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale lëshon mostrat e kontratave të punës dhe vazhdon pastaj neni siç është këtu.

Neni tjetër që mendoj se krijon parregullsi, është neni 22, Puna më e gjatë se orari i plotë i punës, paragrafi 4. Shumë mirë është precizuar neni 1, se me kërkesën e punëdhënësit, punëmarrësi duhet të punojë më gjatë se orari i punës, jashtë orarit të punës, është fjala, më shumti 8 orë në javë. Kjo është mirë e definuar. Por, në paragrafin 4 nuk është precizuar se deri në sa orë mund të punojë punëmarrësi me kërkesën e vetë. Pse po e them këtë? Nëse lihet pa u përcaktuar kohëzgjatja, do të lihet hapësirë për sipërmarrësin që të gjejë persona në nevojë të madhe që punojnë me orar të stërzgatur edhe në dëm të shëndetit të tyre, nga e cila gjendje do të përfitonte punëmarrësi, duke iu shmangur obligimeve ligjore që dalin nga marrja e numrit të nevojshëm të

punëtorëve për vëllimin e punës që e ka. Prandaj, duhet edhe këtu të dihet me saktësi se më së tepërmi punëmarrësi jashtë orarit të punës sa duhet të punojë e këtu do të ishte mirë të lihet njësoj 8 orë punë në javë, për shtesë është fjala.

Neni 44, paragrafi 5.3, të Mbrojtja e të rinjve, thuhet: “Në mjedis jo të shëndoshë, i cili p.sh., shprehja “për shembull” që është përdorë në ligj, kjo po pajtohem të gjithë, kjo duhet të hiqej, shembuj ilustrativ nuk ka në ligje, edhe kjo po dihet.

Neni 66, ku flitet për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ka mbetur pa u rregulluar sipas standardeve të kohës së sotme. Ndërprerje e marrëdhënies së punës, thuhet në paragrafin 1.6 të këtij neni, bëhet, po citoj: “Nëse i punësuar është dënuar me burg sipas aktgjykimit përfundimtar të gjykatës”, që është në rregull shumë, por në këtë nen thuhet se “kontrata e punës ndërpritet edhe në rastet kur i punësuar i dënuar është liruar me kusht”. Ky domethënë është jashtë burgut. Mendoj se jo për të gjitha rastet kjo do të ishte e drejtë. Punëtori nuk mund të kthehet në vendin e punës nëse vepra penale ka të bëjë pikërisht me vendin e punës së tij ose lidhur me punën, por mendoj se jo në rastet tjera, duhet mu specifikuar. Merreni me mend, tash ne po e marrim ky që po lirohet prej burgut, nuk i jepet shansi të vazhdojë punën, ndërsa ky që është dënuar dhe mbetet në burg, megjithëse në burg, do të punojë, ju e dini, madje edhe mund të fitojë sipas Ligjit për sanksionet penale, që jemi duke e punuar këtu. Ky nen, për mendimin, tim duhet të rregullohet pa tjetër ndryshe.

Neni 69, Ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit, paragrafi 1.4, mendoj se le vend për arbitrazh të punëdhënësit në prishjen e kontratës me punëmarrësin. Punëdhënësi mund t’i ndërpresë kontratën, thuhet në ligj, po citoj: “Punëdhënësi mund t’ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në rastet kur i punësuar është fajtor për sjellje joserioze”, thuhet në këtë paragraf. Sjellje jo serioze duhet të hiqet, për mendimin tim, sepse është krejt subjektive kur i duhet punëdhënësit serioz i punësuar dhe kur jo. Mjafton të lihet si në vijim fjalia në paragraf, se ndërpritet kontrata në rastet kur i punësuar është fajtor për shkelje të detyrimeve që dalin nga kontrata e punës ose që lidhen me punën. Përmirësim i ngjashëm duhet të bëhet edhe në nenin 4 të të njëjtit nen.

Te koha e pagesës, koha e pagesës duhet precizuar, duhet të bëhet prej 1 deri më 3 ose 1 deri 5, këtu nuk është precizua. Ju e dini që shumë punëtorë nuk paguhën nga 2 – 3 muaj sepse nuk është kjo hiq e precizuar dhe punëdhënësi shumë lehtë i ikë detyrimit, i thotë punësuarit – ne nuk e kemi këtë të rregulluar, unë ty gjithsesi do të paguaj, por ju e dini se ka shumë konflikte të tilla sot, të cilat ende janë të parregulluara. Ne pikërisht duhet ta rregullojmë me ligj, jo me kontratë, me kontratë po se po, kur rregullohet me ligj, atëherë kontrata si element duhet ta përfshijë pa tjetër. faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Drita Maliqi, le të përgatitet deputeti Shkumbin Demaliaj, i fundit para pauzës.

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti kryesues! Përsëndetje!

Ligi për punën ka mangësi të shumta. Ky ligj frikoj që do të gjejë zbatim dhe do të zbatohet në plotësi, sidomos në sfera të caktuara të sektorit privat. Po i lexoj disa nga shqetësimet e një grupi punëtorësh të një kompanie private të sigurimeve të KEK-ut, i cili më është drejtuar si ligjvënës dhe deputete e këtij Kuvendi.

Po e citoj një pjesë të shqetësimeve të tyre, që kanë dhe janë të inkorporuar drejtpërdrejt me këtë ligj:

“Të nderuar deputetë,

Jemi një grup i rëndomtë i ish punëtorëve të sigurimit të KEK-ut, ne kemi një hall, nuk kemi as ku të ankohemi, prandaj vendosëm t’jua dërgojmë këtë shkresë ju, të paktën na merrni parasysh. Kemi ngelë edhe ne të themi -Jemi Kosovë. Më 1 mars 2004 na kanë privatizuar, e ka fituar tenderin një kompani private për të na menaxhuar, ajo ishte VDG, e cila kompani në start na i hoqi nga pagat 10 euro dhe triskat e ushqimit na i përgjysmoi. Filluan dënime, suspendime, maltretime dhe vendosëm ta formojmë një sindikatë për t’i mbrojtur të drejtat e tona nga dikush. Mirëpo kot, ankesën e parë që e bëri kryetari i sindikatës për ne, ai u largua nga puna dhe nuk u kthye më kurë. Përderisa ne po përballeshim me vuajtje, ai zotëria e bëri pallatin 6 katesh me restorant, me fushë futbollit, me diskotekë e me të gjitha. Prej 1 marsit 2007, ne kemi punuar pa kontratë pune deri më 1 mars 2010, ku iu dha shërbimi i sigurimit edhe një kompanie tjetër “Besa Security”, i cili në start na joi nga paga edhe plus nga 40 euro. A mos, vallë, ne duhet me ia bë pallatet çdo kompanie që vjen këtu, a mos, vallë, fëmijët tanë duhet të vuajnë gjithmonë, a mos ,vallë, fëmijët tanë duhet t’i mbajnë mall gjërat elementare për jetë”.

Ky ligj, të nderuar deputetë, në shumë raste të tilla që ndodhin çdo ditë në Kosovë, jemi skeptikë që me këtë strukturë që e posedon, do t’i mbrojë në kuptimin e plotë të fjalës të drejtat elementare të punëtorëve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra prezentë,

Kolegë deputetë,

Me qenë se është duke u diskutuar radhazi dhe shumë çka është përsëritur, koha e pauzës është afruar, do të mundohem që të jem shumë i shkurtër, por konkret.

Te fushëveprimi i projektligjit, në radhë të parë na vjen mirë që pas herës tetë, tentimit për t’u kaluar ky projektligj në Kuvendin e Kosovës, me arsye jo të favorshme për punëtorët edhe punëdhënësit kosovarë, në këtë rast, them sot, besojmë se do ta kalojmë dhe ligji të shkojë në shqyrtimin e dytë edhe të kalohet me gjithë vërejtjet që i kemi dhënë edhe ne si grup parlamentar, por edhe deputetët që po i japin.

Kur flasim te fushëveprimi i ligjit, te neni 2.4 përcaktohet se kush nuk i nënshtrohet këtij ligji, po duhet të dihet mirë se tani në këtë rast iu ka dhënë edhe një mundësi në përjashtim nga Rregullorja 2001/27, një mundësi më e madhe me këtë projektligj që i nënshtrohen këtij ligji edhe arsimi, edhe shëndetësia, edhe shumë mekanizma tjerë publikë, që në të kaluarën nuk kanë qenë, po duhet të futet që nuk i nënshtrohen edhe Forca e Sigurisë së Kosovës, Policia, Agjencioni për Inteligjencë dhe shumë mekanizma tjerë, duhet të përcaktohen me ligj se këta nuk i nënshtrohen këtij ligji sikur janë përcaktuar misionet diplomatike ndërkombëtare dhe tjera që veprojnë në Kosovë.

U fol shumë për pushimin e lehonisë, është mirë që gjatë shqyrtimit të dytë të rritet kohëzgjatja, se është një kohë shumë e shkurtër, sepse fëmija vetëm për ato 6 javë, po edhe 60 javë, edhe 6 muaj, edhe 2 vite është i vogël, edhe pse Qeveria e Kosovës nuk ka menduar asnjëherë deri më tash ta parashih pranë vetes, ta krijojë një fond për mbrojtjen e fëmijëve, që me ato mjete që ata fëmijë mbrohen, familja e tyre, të punësuarit në këtë rast, mund të kenë mundësi që t’i ofrojnë një kujdestar atij fëmije që të rritet në kushte më të mira, sepse janë mjete që shteti i destinon apo shtesat që i garantohen atij fëmije për mirëqenien e tij gjatë asaj periudhe.

Te neni 77, është e përcaktuar, thotë, mbrojtja e të punësuarit në gjykatë. Nëse të punësuarit nuk i është realizuar kërkesa e tij nga punëdhënësi, i cili vlerëson se janë shkelur të drejtat e tij, ai mund të iniciojë kontest pune pranë gjykatës. Në këtë rast shihet se për mbrojtjen e të drejtave edhe mbikëqyrjen e këtij ligji është Inspektorati i Punës. Me qenë se e kanë futur, është rasti kur edhe Inspektorati nuk e ka shqyrtuar kërkesën e tij, atëherë mund t'i drejtohet gjykatës, po kontest punë pranë gjykatës kompetente. Është mirë që të përcaktohet cila gjykatë, të përcaktohet se cila gjykatë i shqyrton këto, raste sepse kemi shkallshmërinë e gjykatave, edhe si trup ekzekutiv që është Inspektorati i Punës, duhet ditur se në cilën shkallë mund të ankohen punëtorët, edhe punëdhënësi, në këtë rast, është mirë të caktohet shkalla e gjykatës se kur po thuhet kompetente, po mbetet kapitulli i gjerë në këtë rast.

Është neni 81, Masat ndëshkuese. Shqiptimi i masave ndëshkuese lidhur me shkeljen e dispozitave të këtij ligji nga punëdhënësi, Inspektorati i Punës do t'i shqiptojë konform Ligjit për Inspektoratin e Punës. Është e vërtetë se Inspektorati i Punës edhe me këtë ligj mund të fuqizohet, që deri më tani nuk e ka pasur, po kanë qenë në vetë rregulloren masat e dënimit që janë përcaktuar. Thuhet këtu në pikën 4 të nenit 89, se duhet të inicohet që me një akt nënligjor Ministria e Punës i harmonizon këto veprime dhe përcakton shkallën e gjobave, po është mirë që të përcaktohet një afat kohor kur duhet të përfundojë ky akt nënligjor ose të futet në ligj direkt sasia e gjobave për shkak se me këtë ligj prej 100 deri 10.000 euro, apo duke u rritur dyfish dhe trefish që përcaktohet me ligj, inspektorët e punës në këtë rast mund të keqpërdorin para punëdhënësve dhe punëmarrësve, në këtë rast, mund ta keqpërdorin pozitën e tyre dhe të përfitojnë, të korruptohen, është rast për ata që s'e dinë.

Është mirë që mekanizmi i Inspektoratit të Punës të bëhet organ i Kuvendit, sikur që është bërë Komisioni për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, komision i pavarur, për shkak se këtu ka të hyra marramendëse, sepse deri më tani arsyeja e Ministrisë po edhe e Qeverisë ka qenë se është kostoja e me këtë rast vetëm përfiton buxheti i Kosovës. Kur flitet për mjetet që derdhen nga dënimet dhe gjobat, që ato të shkojnë direkt në buxhetin e Kosovës, është mirë që të shkojnë në xhirollogarinë e Inspektoratit të Punës, po në këtë rast deri në fundin e viti buxhetor t'i dorëzohen buxhetit të Republikës së Kosovës për shkak se mund të humbin shumë konteste nëpër gjykata, që nuk janë cilësuar drejt dhe gjykata vendos ndryshe, atëherë duhet të kthehen ato mjete në qoftë se pala ka fituar kontestin derisa të përcaktohet shkallshmëria e tyre.

Nuk kisha shkuar më gjatë, zoti kryesues, me qenë se me padurim po presim të dalim në pauzë. Faleminderit, besoj se edhe punën që do ta ketë komisioni funksional, po edhe komisionet tjera, ne si grup parlamentar dhe si deputetë veç e veç, do të japim maksimumin e duhur. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deri në orën 15:00 pauzë. I pari për fjalë është deputeti Ismajl Kurteshi, i dyti deputeti Rexhep Hoti dhe i treti deputeti Arsim Bajrami. Për fjalë janë të paraqitur edhe 15 deputetë. Faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë me punimet e seancës së Kuvendit. Ju lutemi, i zëni vendet e punës!

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës. Fjalën e ka deputeti Ismajl Kurteshi, le të përgatitet deputeti Rexhep Hoti.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetjet për të gjithë të pranishmit!

Unë do të fokusohem në disa çështje të cilat nuk kanë ndonjë implikim buxhetor dhe të cilat, si duket, në ligj nuk janë përfshirë.

Një ndër çështjet të cilat unë nuk i kam vërejtur në ligj, është se nuk është paraparë institucioni i konkursit, si mjet për punësimin e punëtorëve, sidomos në sektorin publik, e që është një mjet i domosdoshëm për punësim.

Një çështje tjetër, po ashtu me rëndësi që i mungon këtij ligji, është mospërcaktimi i statusit të praktikantëve ose të atyre që quhen nxënës ose shëgërt, do të thotë, ligji nuk është marrë as me këtë çështje.

Në nenin 9 të këtij ligji, ku thuhet se “kontratat e punës mund të lidhen në formë të shkruar apo verbale”, unë konsideroj se kjo pjesa “apo verbale” duhet të hiqet, pasi që ne jetojmë ende në një ambient ku marrëveshjet verbale shpesh edhe nuk i respektojmë dhe përherë dëmtohen punëtorët, ata më të dobëtit.

Në nenin 22, ku bëhet fjalë për punën më të gjatë se orari i rregullt i punës, përveç tjerash thuhet se “në raste të jashtëzakonshme, me rritjen e vëllimit të punës dhe në raste të tjera mund të zgjatet orari i punës”. Mendoj se do të duhej me ligj të përcaktohet se cilat raste quhen të jashtëzakonshme, kurse pjesa tjetër të hiqet, do të thotë të hiqet “me rritjen e vëllimit të punës dhe në raste të tjera” sepse nëse mbeten këto në ligj, atëherë plotë arsye do të gjenden që punëtorëve t’ju zgjatet orari i punës.

Në nenin 38, ku bëhet fjalë për mungesën pa pagesë, do të thotë pushim pa pagesë, në këtë nen duhet të caktohet maksimumi i mungesës pa pagesë, do të thotë duhet të jetë një kohë e caktuar dhe jo kështu koha e pacaktuar deri në pafundësi.

Dhe, po ashtu, një çështje që e konsideroj shumë të rëndësishme e që i mungon këtij projektligji, ky projektligj nuk e përcakton formën e mbajtjes së evidencës së punëtorëve nga punëdhënësi. Pra, nuk obligohet punëdhënësi që ta ketë Librin amë apo dosjet personale dhe nuk përcaktohet kohëzgjatja e ruajtjes së evidencës. Konsideroj se ligji duhet t’i obligojë punëdhënësit që ta mbajnë një evidencë në formë të shkruar në letër dhe të caktohet një kohë relativisht e gjatë e ruajtjes së këtyre shënimeve, të cilat do t’i nevojiten secilit punëtorë në një kohë të caktuar.

Dhe, krejt në fund, pa dashur t’i përsëris ato që i thanë të tjerët, në nenin 48, përveç të tjerash thuhet se pagesën për lehona e bëjnë punëdhënësit, gjë që konsideroj se i dëmtojnë të punësuarat jo vetëm gjatë pushimit të shtatzënisë, por kjo do të ketë efekte edhe në mos punësimin e grave të reja për t’iu ikur edhe pagesave, sidomos nga ndërmarrësit privatë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet!

Fjalën e ka deputeti Rexhep Hoti, le të përgatitet deputeti Arsim Bajrami.

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Lirisht mund të vlerësojmë se Projektligjin për punën, të cilin e kemi në shqyrtim, është një ndër të arriturat më fundamentale të institucioneve të cilat, më në fund, dëshirojnë të merren seriozisht me këtë problem. Është një çështje dhe një akt, për mendimin tim, jashtëzakonisht i madh, pavarësisht se realizimi i projektligjit edhe në dëshirën e marketingut politik, edhe në dëshirën e atyre që seriozisht dëshirojnë të japin kontributin e tyre, është shumë i vështirë. Është e kuptueshme se përmes këtij projektligji rregullohen dhe përcaktohen të drejtat ekonomike,

sociale dhe profesionale të punëmarrësve dhe të punëdhënësve, përmes të cilit rregullohen të drejtat, detyrimet, marrëdhënia e punës, procedurat e gjërat e tjera.

Projektligji, të cilin sot po e shqyrtojmë është jashtëzakonisht mirë që konceptimin e rregullimit të marrëdhënies së punës e bën mbi baza të kontraktuara, pra kolektive dhe individuale, por duke lënë hapësirë të rregullimit autonom dhe kontraktues të niveleve të ndryshme, si të nivelit shtetëror, të ndërmarrjes apo individit. Ajo që konsideroj që është boshtore për këtë projektligj, është e dhëna se kemi zgjidhje të balancuar midis punës dhe kapitalit. Dispozitat e projektligjit në fjalë anojnë më shumë kah ekonomia e tregut, por pa i lënë anash specifikat dhe elementet e natyrës sociale, çka do të thotë tregu i punës, mënyra e rregullimit dhe përgjithësisht kemi të bëjmë me konceptimin e djathtëzimit mbi zgjidhjen e çështjes sociale, në këtë rast edhe të punësimit përgjithësisht të tregut të punës. Ne e dimë se aspekti social i rregullimit të kësaj çështje në Evropë gjithkund është zgjidhur përmes konceptit djathtëzimit, domethënë aspekti social, përjashtuar shtetet skandinave. Në këtë drejtim, edhe Kosova s'mund të bëjë përjashtim. Kjo do të thotë se ky akt ligjor vë në pah të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve dhe punëdhënësve me qëllim të stimulimit të investitorëve vendorë dhe të huaj. Sigurisht që as punëtorët, as punëdhënësit nuk do të jenë shumë të kënaqur me zgjidhjen dhe përmbajtjen e projektligjit në fjalë, sepse interesat e tyre jo rrallë janë të kundërta dhe personale.

Gjithashtu, është me rëndësi të theksojmë se për shumë çështje të cilat rregullohen me dispozitat e këtij akti ligjor, është lënë në mundësi të punëdhënësve dhe të punëmarrësve që t'i rregullojnë vetë.

Me qenë se sot Kuvendi i Republikës së Kosovës e shqyrton në lexim të parë, në parim pajtohem, por duhet të themi edhe t'i marrim shumë normale edhe ndërhyrjet politike dhe buxhetore në kuadër të këtij projektligji, të cilat janë shumë serioze si nga institucionet financiare ndërkombëtare, ashtu edhe nga to të brendshme, pra nga buxheti i Kosovës, por konsiderojmë që është jashtëzakonisht e mbarë që shteti i Kosovës përfundimisht ta aprovojë këtë ligj. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami, le të përgatitet deputetja Mimoza Ahmetaj.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Pa dyshim që ardhja e këtij ligji në leximin e parë paraqet një ngjarje të rëndësishme, sepse ka kohë që pritet ky ligj dhe pritjet kanë qenë të arsyeshme sepse nuk kemi pasur një ligj bazik që rregullon marrëdhënien e punës. Duke i dhënë një përkrahje parimore këtij ligji, në pajtim edhe me karakterin e leximit të parë, unë do t'i jap disa vërejtje parimore, kurse vërejtjet konkrete pastaj do t'ia deponoj komisionit funksional me rastin e admendamentimit.

Fillimisht, dëshiroj të angazhohem që të definohet saktë qëllimi i këtij ligji, edhe pse neni 2 i ligjit tregon se cilët sektorë të të punësuarve i përfshin. Unë mendoj se në leximin e dytë duhet të precizohet, sepse ne kemi krijuar diversitetin e të punësuarve. Me vetë faktin se me shumë ligje tjera të veçanta kemi rregulluar marrëdhënien e punës për kategori të veçanta, atëherë duhet të identifikohet qartë objekti i këtij ligji.

Siç e dini, tani administratën publike e kemi rregulluar me ligje për shërbimin civil dhe për paga, po ashtu edhe kategori tjera që dalin nga shërbyesit civilë pritet të rregullohen me ligje të veçanta dhe detyrë e parë është që me këtë ligj të dihet saktësisht se cilët të punësuar rregullojnë statusin

e tyre, sepse unë bisedova edhe me ministrin, përafërsisht 300.000 njerëz kanë marrëdhënie pune, edhe pse nuk janë të dhënat ekzakte dhe, sipas një përlllogaritje të përafërt, nga ky ligj do të fitojmë vetëm 50%, sepse 50% marrëdhënien e punës do ta rregullojnë me ligje të veçanta. Ligji thotë se do të rregullojë marrëdhënien e punës të të punësuarve në sektorin privat dhe publik, ndërmarrjet privat dhe publike, si dhe të punësuarit në sferën e shëndetësisë dhe të arsimit në nivelin qendror dhe në nivelin lokal. Por, unë do të shtoja, jo të gjithë të punësuarve në shëndetësi dhe në arsim, sepse për mjekët dhe arsimtarët ekziston ligji i veçantë, i cili rregullon statusin e këtyre dy kategorive, sepse këto dy kategori me miratimin e ligjit kanë dalë nga sfera e shërbyesve civilë.

Unë kam një brengë që ne nuk do të mund ta përcjellim dinamikën dhe do të vonohemi me këto ligje të veçanta që rregullojnë marrëdhënien e punës në këto sfera të veçanta. Po e zëmë, të gjithë jemi pajtuar që profesorët e të gjitha kategorive, nga shkolla fillore deri te universiteti, nuk janë shërbyes civilë, po unë po frikohem do të krijojmë një vakuum, që do të na duhet kohë derisa ta punojmë legjislacionin sekondar, që të rregullohet saktësisht marrëdhënia e punës, njëjtë është me mjekë, njëjtë është me policë, njëjtë është me doganierë dhe ne po e bëjmë një lloj fragmentarizimi të rregullimit të statusit të tyre, kështu që në leximin e dytë do të ishte mirë që ne të saktësojmë saktësisht se cilat kategori të punëtorëve përfitojnë nga ky ligj.

Përndryshe, ligji është në bazë të dy koncepteve, konceptit të ekonomisë së tregut dhe një koncepti të një shteti social, që është mirë, sepse pa marrë parasysh orientimin djathtistë apo majtistë, unë s'kisha për të hyrë në ideologji këtu, sepse do të gaboja, sepse është ende herët për të dhënë gjykime për karakterin ideologjik të qeverisjes. Unë mendoj që do të ishte mirë të bëhet një kombinim i parimeve të ekonomisë së tregut, që janë parime kushtetuese dhe parime të një shteti demokratik, po parime të një shteti të fortë social, një shteti social i cili kujdeset për pozitën e punëtorëve dhe unë mendoj se në këtë ligj ka hapësirë ende për të dhënë garancione sociale për të drejtat e punëtorëve, në mënyrë që punëtori me lidhjen e marrëdhënies së punës të sigurohet sa i përket të drejtave në punë dhe të sigurohet sa i përket statusit të vet social.

Kam vërejtur një parregullsi, do të thotë, është një kaptinë ku thuhet hierarkia mjedis ligjit, kontratës kolektive dhe kontratës për marrëdhënien e punës, as që duhet të ekzistojë kjo kaptinë, sepse sistemi juridik e njeh epërsinë e ligjit në raport me aktet nënligjore dhe nuk ka nevojë në këtë ligj të na shpjegohet që kontrata kolektive është akt më i vogël se ligji, sepse ajo dihet, është parim i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë dhe mendoj që nuk ka nevojë për gjëra që caktohen me ligje të tjera, këtu të përcaktohen.

Çka i mungon këtij ligji? I mungon parimi i mosdiskriminimit apo atë që ekspertët e drejtës së punës e quajnë – parimi i gjasave të barabarta. Është një parim edhe në konventat evropiane, edhe në Kushtetutë, ku thuhet që çdo vend i punës është i arritshëm në kushte të barabarta për secilin, pa marrë parasysh pozitën sociale, kualifikimin dhe të dhënat tjera. Nuk vërehet kjo frymë e këtij parimi, që është parim universal i konventave të punës në këtë ligj dhe unë do të sugjeroja që në leximin e dytë ky parim të vendoset në hyrje të ligjit, unë mendoj në nenin 4, dhe pastaj kjo frymë e barazisë në punësim të përcillet çdo kund, është diçka që është edhe standard i Bashkimit Evropian.

Një çështje tjetër, operohet me punësim në kohë të caktuar, operohet me terma. Siç e dini, te Ligji për shërbimin civil ne kemi futur konceptin e karrierës, do të thotë, një person i punësuar një herë në shërbimin civil e ka kontratën e përhjetshme dhe tanimë dihet se shërbyesit civil marrin kontrata të përhjetshme, jo kontrata njëvjeçare, kështu që angazhohem që maksimalisht të përjashtojmë nga ligji punësimet e përkohshme, punësimet sezonale dhe të jepet mundësia që

nëse dikush një herë është punësuar me një konkurs publik, atëherë ai të jetë i siguar gjithë jetën me të drejtat e veta të punës.

Gjithashtu, mungon instrumenti i punësimit, mungon institucioni i konkursit dhe mendoj se konkursi është instrument që ofron parimin e gjasave të barabarta.

Sa u përket disa çështjeve kontestuese, që u përmendën nga shumica e deputetëve, siç është kohëzgjatja e pushimit të lehonisë, pastaj kohëzgjatja e pushimeve mjekësore dhe çështje tjera, i dimë kufizimet buxhetore, i dimë se këto çështje drejtpërdrejtë e kondicionojnë koston e ligjit, mirëpo ne duhet të keni parasysh edhe realitetin e Kosovës, duhet t'i kemi parasysh rrethanat në të cilat po kalojmë, nuk mund të marrim praktikën e shteteve të zhvilluara që kanë institucione të forta edukative, institucione tjera sociale. Ne jemi një shoqëri e re, një shoqëri në ndërtim dhe mendoj që duhet të jemi fleksibil edhe sa i përket zgjatjes së pushtimit të lehonisë, edhe sa i përket asistencave gjatë pushimeve shëndetësore dhe këto çështje duhet t'i shqyrtojmë me kujdes duke pasur parasysh rrethanat e Kosovës, jo gjithmonë me klishe apo me standarde të Bashkimit Evropian.

Përgjithësisht gjykoj se projektligji është i mirë dhe jam i sigurt se me amendamentimin që do të pasojë, por edhe me debatin publik, me kontributin e gjithë aktorëve, duke përfshirë edhe sindikatat, ne do ta bëjmë një ligj të mirë edhe pse pritjet e sindikatave dhe të opinionit të gjerë kanë qenë që ky do të jetë një kod i punës, jo një Ligj i punës, po për faktin se ky do të kapë vetëm 50% të punësuarve, atëherë nuk mund të jetë kod, sepse rregullon vetëm një pjesë të njerëzve që kanë marrëdhënie të punës. Mendoj që do të kemi një ligj të mirë dhe kjo do të krijojë një siguri juridike, do të krijojë një siguri për punëmarrësit, por edhe punëdhënësit. Në mënyrë të veçantë po shpresojmë, i nderuari kryesues, që do të vendos një rend sa i përket sektorit privat, ku aty – këtu kemi edhe raporte skllavërie, domethënë aty – këtu të punësuarit nuk trajtohen me rregulla publike, nuk trajtohen me ligje, po me kutet e pronarit apo me kritere të tjera dhe unë mendoj që pikërisht Inspekcioni i Punës do të ketë për detyrë që me rastin e implementimit të ligjit ta monitorojë sa po zbatohet ky ligj në sektorin privat, për të shmangur abuzimet, keqtrajtimet sepse, pa marrë parasysh që ky është sektor privat, nëse dikush punësohet, ai i ka të drejtat që ia garanton ligji dhe këto të drejta duhet t'i mbrojmë me instrumente ligjore.

Edhe një herë përkrah ligjin në parim dhe do të angazhohem që në leximin e dytë të plotësohet me amendamente përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Mimoza Ahmetaj, le të përgatitet deputetja Sanije Aliaj.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet edhe një herë për të gjithë!

Mendoj se ardhja e ligjit të tillë, Ligjit të punës do t'i krijonte favore të mëdha Kosovës, së pari, si shtet. Pa i marrë parasysh të gjitha ato të cilat deri më tani u thanë, po e përmend edhe një detal, i cili nuk u vu në pah nga parafolësit e mi. Është marrëveshja për punësimin e shtetasve tanë jashtë vendit, gjë e cila deri më tani Kosovës i ka paraqitur vazhdimisht problem sepse shtetasit kosovarë apo Kosova nuk ka mund të krijojë marrëveshje me shtetet tjera me qëllim të punësimit të shtetasve kosovarë jashtë vendit.

Tani do të ndalem te disa nga vërejtjet të cilat unë i nënvizova gjatë fjalimit të deputetëve, të cilët dhanë deklaratimet e tyre në sesionin e pjesës së paradites.

E para, më bëri shumë përshtypje që shumë nga deputetët të cilët përfaqësojnë partitë djathtiste apo pretendojnë se i përfaqësojnë këto parti djathtiste, gati shumica e fjalimeve të tyre ishin majtiste me qëndrimet se pushimi i lehonisë duhet të jetë 12 muaj, 6 plus 6, 18 muaj e tjerë e tjerë, domethënë është një kontradiktë shumë e madhe mes asaj që pretendojnë se janë dhe asaj të cilën sot e paraqitën.

E dyta, u përmend deklarata financiare dhe dilemat e mëdha që i ngrit kjo deklaratë financiare se Qeveria do të jetë apo jo në gjendje që këtë ligj ta implementojë. Unë ndjej të nevojshme ta them se deklarata financiare e cila neve na ka ardhur, është nga data 26 mars e vitit 2010. Vetëm t'i rikujtoj deputetët dhe opinion e gjerë se javën e kaluar kryeministri i Kosovës ka nënshkruar një marrëveshje me Fondin Monetar Ndërkombëtar për një kredi në vlerë prej 111.000.000 eurosh, me të cilën parashihet, përveç të tjerash, edhe përfshirja e disa nga ligjeve jetike, siç është Ligji për veteranët e luftës, Ligji për invalidët, si dhe Ligji për punën.

Një tjetër vërejtje që e kam, është edhe në lidhje me deklaratën e deputetes më herët që e tha në lidhje me cilësinë e ligjit dhe u përmendën ligjet e punës të shumë shteteve të regjionit. Ndjej të nevojshme ta them se rëndësia dhe cilësia e një ligji nuk mund të vlerësohet mbi bazën e numrit të neneve që ai ligj i përmban. U përmendën shtetet, si Mali i Zi, Shqipëria, Serbia, Maqedonia dhe për numrin e neneve që i kanë ato ligje. Unë ndjej të nevojshme ta them se ligjet e punës të të gjitha këtyre shteteve të cilat edhe ne i kemi parë, në vete përmbajnë përveç Ligjit bazë të punës, edhe Ligjin për organizimin sindikal, Ligjin për grevën, Ligjin për punësimin e shtetasve të huaj, gjëra të cilat ne në Kosovë i kemi të ndara me ligje veç e veç, nuk janë të gjitha të inkorporuara brenda Ligjit të punës.

Në parim, e mbështes këtë projektligj, me shpresë se disa nga amendamentet të cilat sot u përmendën nga shumë deputetë, do të përfshihen. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

I ftoj deputetët që me ndërhyrjet e tyre ta zgjojnë vëmendjen e Kuvendit dhe mos të hyjnë në debate në përcaktime se afati ose kohëzgjatja e lehonisë përcakton cila parti është e djathtë a e majtë. Deputetja Sanije Aliaj e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Driton Tali.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Konsideroj se sot është një ditë e veçantë se Kuvendi po e shqyrton Projektligjin e punës. Projektligji i punës është akt ligjor bazik dhe sistemor që rregullon përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin privat dhe publik, pra pretendohet të rregullohen në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe përmbajtjesore të drejtat dhe përgjegjësitë e punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe procedurat për realizimin e tij në përputhje me rregullat e ekonomisë së tregut dhe tregun e punës.

Dispozitat e Projektligjit të punës zbatohen edhe për të punësuarit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligje të veçanta, për të punësuarit me shtetësi të huaj dhe personat pa shtetësi të cilët janë punësuar te punëdhënësi në territorin e Republikës së Kosovës. Është për t'u vlerësuar se dispozitat e kontratës kolektive dhe të aktit të brendshëm, kontratës së punës së punëdhënësit duhet të jenë në harmoni me Projektligjin e punës. Nevoja për këtë projektligj është e madhe, sepse eliminon dukuritë e shumta të kundërligjshme, të cilat dukuri janë të përditshme në marrëdhënien e punës në mes të punëdhënësi dhe punëmarrësi, siç janë: mospërmblidhja e kushteve të nëpunës, mospërmblidhja e ambientit të punës, mos themelimi i sistemit të mbrojtjes sociale shoqërore dhe ekonomike të të punësuarit.

Në materialin përcjellës të projektligjit jepet informacioni shpjegues se gjatë hartimit të Projektligjit të punës janë konsultuar konventat e ndryshme ndërkombëtare të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës, si dhe direktivat - sigurimet specifike të legjislacionit të Bashkimit Evropian. Po ashtu, thuhet se projektligji nuk është në kundërshtim me parimet themelore të *acquis communautaire*. Por, në anën tjetër thuhet edhe kjo se projektligji është larg nga arritja e qëllimeve të legjislacionit të Bashkimit Evropian. Pra, me këtë rast unë përshëndes procedimin e Projektligjit të punës në lexim të parë, por në anën tjetër kam bindjen se rregullimi i krijimit të marrëdhënies së punës me këtë projektligj bëhet përkohësisht, sepse projektligji nuk plotëson standardet ndërkombëtare për themelimin e marrëdhënies së punës. Është për çdo kritikë lëshimi që ndodhet në faqen 9 të materialit se projektligji është në përputhshmëri me dukjen dhe formën standarde të legjislacionit që përdoret nga IPVQ-të. I drejtohem ministrit, zoti ministër, IPVQ-të janë e kaluara jonë, tani i kemi institucionet dhe legjislacionin e Republikës së Kosovës.

Sipas këtij projektligji, marrëdhënia e punës duhet të themelohet me orar të plotë, me kohë të caktuar dhe të pacaktuar. Me këtë projektligj rregullohet edhe pushimi i lehonisë dhe përkujdesja e veçantë dhe shumë çështje të tjera.

Unë do të ndalem në nenin 48, që rregullon pushimin e lehonisë. Me këtë rast do të potencoj se nëse është në interes të vendit rritja e natalitetit, interesimi për mbrojtjen e shëndetit të nënës në fazën e riprodhimit, e në mënyrë të veçantë interesi i madh për të rritur fëmijë të shëndoshë, kjo dispozitë të ndryshohet. Paragrafi 1 i nenit 48 rregullon 12 javë pushim për lehonën. Unë propozoj që paragrafi 1 i nenit 48 të ndryshohet. Femra e punësuar, pra përafërsisht të jetë kështu. Femra e punësuar të gëzojë të drejtën 6 muaj pushim të plotë dhe 6 muaj me orar të shkurtuar. Edhe pse kërkohet buxhet për t'u realizuar ky nen, nëse has në mirëkuptim propozimi im, atëherë edhe paragrafët tjerë të këtij neni të harmonizohen me paragrafin 1 të nenit 48.

Paragrafi 6 i nenit 48 rregullon se lehona gëzon 70% të pagës së të punësuarës, të realizuar në vitin e fundit. Ky paragraf mendoj se është diskriminues për nënën e re. Kur dihet se ajo mu në këtë kohë ka nevojë të madhe për të rritur fëmijë në mënyrë të shëndetshme, por në anën tjetër a thua ajo nuk ka kontribuar me punën e vet për të mirën e shoqërisë që të gëzojë pagën e plotë për aq sa zgjatë pushimi i lehonisë.

Projektligjin e përkrah në parim, sepse është nevojë që kjo fushë, pra fusha e rregullimit të marrëdhënies së punës të rregullohet me ligj, por është edhe një vërejtje e Raportit të progresit nga Komisioni Evropian.

Shpresoj që ky projektligj do të plotësohet në komisionet funksionale pas debateve dhe dëgjimeve me amendamente dhe ligjet të cilat janë miratuar në Kuvendin e Kosovës, siç është Ligji për shërbyesit civilë, Ligji për grevat, Ligji për organizimin sindikal të harmonizohen me Projektligjin e punës që të jenë më lehtë të zbatueshëm.

Dhe, në fund krejt, kërkoj që projektligji të jetë në harmoni me konventat ndërkombëtare të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës, se vetëm atëherë do t'i plotësojë standardet bashkëkohore për themelimin e marrëdhënies së punës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputetja Teuta Hadri.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti kryesues, më falni, mua më duhet të kthehem te pika tre, duke pasur parasysh gjithë atë që u tha në media me aq pasion nga Qeveria, sidomos nga ministri i Ekonomisë dhe Financave lidhur me këtë marrëveshjen për kredinë me IDA-n. Dhe ja, tash, ende ne nuk e kemi kuorum dhe koalicioni qeveritar ...

KRYESUESI: Deputet, unë ta tërheq vërejtjen, që 3 orë jemi në pikën e katërt të rendit të ditës, i kemi edhe 8 deputetë të lajmëruar për fjalë. Unë ju lus, temë është, pikë e rendit të ditës shqyrtimi në parim. Ju lus, e dini çka do të thotë shqyrtimi në parim dhe ju lus që t'i përmbaheni pikës së rendit të ditës – Shqyrtimi në parim i projektligjit. Faleminderit!

DRITON TALI: Faleminderit për këto sqarime, ishin shumë të mirëseardhura, zoti kryesues, po megjithatë unë insistoj se është shumë me rëndësi për qytetarin e Kosovës që të dihet se kuorumin nuk është në gjendje ta bëjë koalicioni qeveritar, i cili ka më shumë se 70 deputetë, nuk i kanë në Kuvend të Kosovës për momentin...

KRYESUESI: Deputet, unë jam i detyruar ta marrë fjalën, këtë mundesh t'ua thuash qytetarëve në konferencë për shtyp. E ke të drejtën, urdhëro mbaje në holl konferencën për shtyp, të lutem, kthehu në pikën e rendit të ditës. I lus deputetët t'i përmbahen parimit që jemi duke shqyrtuar në parim një projektligj, pra vërejtjet parimore që i kemi në te. Urdhëro!

DRITON TALI: Po, tash është e drejta juaj kryesues të ma merrni edhe fjalën, nëse mendoni se mund të ma merrni, por megjithatë unë e thashë atë që e pata ta them, gjithmonë duke pasur parasysh atë që u tha në opinion deri më tani. Me lejen tënde, po kthehem tash në ligj, po iu kthehem komenteve të mia.

Të nderuar të pranishëm, unë shpresoj se kryesuesi nuk u irritua aq shumë po, sidoqoftë, gjatë gjithë këtij teksti të ligjit të cilin po e diskutojmë më duhet ta them se shumë gjëra u thanë sa i përket këtij ligji dhe pak ka mbetur për t'u thënë, por janë disa që mendoj se nuk u thanë.

Kemi nga neni 2 e tutje, thuhet se në vend të “punëmarrësit” gjithmonë përdoret shprehja “i punësuar”. I punësuar mund të jetë edhe punëdhënësi edhe punëmarrësi. Mendoj se fjala adekuate duhet të jetë “punëmarrësi” për ta diferencuar nga “punëdhënësi”. Pra, kemi të bëjmë me punëdhënësin dhe punëmarrësin, jo punëdhënësin dhe të punësuarin për shkak se në këtë rast të dytë janë të punësuar, shpresoj nëse punojnë në orarin e punës.

Pastaj, e kemi në nenin 3, thuhet se pjesëtarët e familjes së ngushtë numërohen vëllai e motra, ndërsa sa më kujtohet, familja e ngushtë në disa ligje që i kemi aprovuar këtu, numërohet bashkëshorti, fëmijët dhe prindërit, domethënë nuk është në familjen e ngushtë edhe vëllai edhe motra. Tash, mbase ka mund të jetë edhe në raste të ndryshme, në raste specifike në përshkrim, por megjithatë nëse e mbajmë kontinuitetin me ligje të tjera, familja e ngushtë është ajo siç përcaktohet.

Të kthehem edhe te disa çështje të vogla teknike, po them, për shkak se shumë gjëra u thanë. Kemi neni 7, paragrafi 2, mendoj se të moshës 15 deri 18 vjeçare, të cilët mund të punësohet për punë të lehta, si shpjegohet apo si pasqyrohet puna e lehtë. Mendoj se në vokabullarin tonë shqip duhet të jetë edhe “punë të lehta fizike”, mendoj se këtu aludohet në “punë të lehta fizike” dhe “punë të rënda fizike” dhe mungon ajo fjalë.

Në nenin 9, pika 8, mendoj se për lexuesin e rëndomtë nuk është shpjeguar mirë puna e detyrës specifike, e cila nuk mund të zgjatë 120 ditë brenda një viti dhe tash duhet të jetë edhe një shtesë,

varësisht nga natyra e punës për shkak se puna fizike mund të jetë edhe ndryshe. Po them, mungojnë shpjegimet më konkrete.

Pastaj, kemi te neni 48, ku flasim për pushimin e lehonisë dhe këtu gjithnjë flitet për nënat të cilat lindin një fëmijë, por ka edhe raste kur kemi të bëjmë me nënat që lindin dy fëmijë binjakë, por edhe më shumë dhe çfarë të bëhet me to, nuk është paraparë me ligj. Dihet se nuk është njëjtë sikurse të jesh nënë e një fëmije apo nënë e binjakëve, trinjakëve e tjera e tjera, që nëna natyrë di t'i bëjë edhe këto dhe nuk është paraparë me këtë ligj.

Pastaj, flasim për nenin 68 dhe 69, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, këtu thuhet nga i punësuari, që në realitet duhet të jetë punëmarrësi dhe punëdhënësi. Thuhet se punëdhënësi mund ta ndërpresë marrëdhënien e punës për shkak të sjelljes joserioze. Këtu shtrohet pyetja çka është “sjellja joserioze”. Duhet të përcaktohet, pra, kur janë ato shkeljet e rënda të detyrave të punës, mendoj unë.

Neni 63, kompensimi proporcional i dëmit punëdhënësit të përcaktohet me ligj. Nuk ma merr mendja që ka ndonjë ligj në botë që mund t'i përcaktojë dëmet për shkak se kjo është çështje më shumë e ekspertëve të lëmisë përkatëse dhe dëmet dallojnë varësisht nga ajo se cili ekspert apo në cilën lëmi e jep mendimin e vet. Kjo nuk mund të rregullohet me ligj, të paktën unë nuk ka hasur në botë që mund ta rregullojë një ligj dëmin përkatës për shkak se nuk ka ligj në botë që mund t'i parashoh të gjitha dëmet dhe lartësinë e dëmeve.

Pastaj, kemi edhe nenin 75, largimet, më duket pak u prek kjo – largimi kolektiv nga puna, që thuhet se nuk duhet të kthehen, pra jo nuk duhet, por duhet të ... çështjet obligative dhe domosdoshme e tjera e tjera. Pata edhe gjëra të tjera të them, por shumicën i thanë, zoti kryesues.

Unë përsëri po them se me të vërtetë nuk ka kuptim që Qeveria me gjithë atë pasion të propagandojë për kredi dhe në fund të mos jenë të koalicionit qeveritar në Kuvend të pranishëm. Gjithmonë opozita t'ua bëjmë kuorumin, është me të vërtetë jo serioze. Po më vjen keq, po e di që ti do të ofendohesh, do të irritohesh prej këtyre fjalëve, po kjo është realiteti, i nderuari zoti kryesues. Faleminderit!

KRYESUESI: Nuk më la përshtypje gjë ajo farë vërejtje e jotja fare, kështu që mos u mërzit për atë punë. Teuta Hadri e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Naim Rustemi.

TEUTA HADRI: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Projektligji i punës është një ndër ligjet më të diskutuara si në Parlament, si në Komisionin parlamentar të Shëndetësisë, në tryeza publike pune, takime me përfaqësuesit e sindikatave, përfaqësues civilë dhe ka bërë një maratonë të gjatë plotë dy mandate parlamentare dhe ka ardhur sot përsëri në këtë mandat të tretë parlamentar, me shpresën se do të gjejë përkrahjen e deputetëve, për miratim.

Projektligj i punës po e bën një bazë të mirë për rregullimin e marrëdhënies së punës në Kosovë për sektorë që i përfshinë në vetë. Ky ligj ka qenë shumë i nevojshëm dhe i domosdoshëm për veprim dhe plotësimin e gjithë infrastrukturës të shumë ligjeve tjera që përfshinë rreth vetes.

Deri më tani është mbuluar me një Rregullore të UNMIK-ut 2001/27 dhe është përbërë nga 28 nene në tërësi. Ky fakt tregon se ka pasur shumë zbrastëira të theksuara në këtë fushë dhe në të shumtën e rasteve ka pasur shkelje drastike të të drejtave të punëtorëve. Prandaj, rëndësia e këtij

projektligji qëndron se ky projektligj që e kemi para vetes është ligj bazik dhe sistemor për fushën që e rregullon. Në krahasim me ligjin e kaluar, ku nga 28 nene që ka pasur, projektligji është më i kompletuar dhe ka përfshirje më të gjerë dhe po përmbush obligime ligjore më të plota se në projektligjin e kaluar me 28 nene, ndërsa tani janë 97 nene, që do të thotë është përfshirje më e gjerë e të drejtës së punëtorëve në marrëdhënien e punës së krijuar.

Por, ajo që më shqetëson mua, besoj edhe deputetë të tjerë, si dhe do t'i shqetësojë edhe të gjithë qytetarët tanë, është se përsëri ky ligj ka ardhur para nesh jo i plotë, ku neni 48 në praktikë është diskriminuar e drejta e lehonave për shfrytëzim të pushimit të lehonisë dhe e drejta për pushim mjekësor është zvogëluar në 10 ditë. Ky ligj sot është bërë edhe më diskriminues se vetë rregullorja e UNMIK-ut, e cila deri më tani pushimin e lehonisë e ka pasur 6 muaj, që do të thotë 3 plus 3 dhe atë e kemi fituar me mundë nga Ministria e Punës në mandatin e kaluar, e di zoti Selmanaj, si ish ministër i Punës, se është punuar aq shumë për këtë ligj për t'u bërë nga 3 muaj në 6 muaj dhe sa kritika kemi pasur si deputetë pse e kemi lejuar edhe atëherë 6 muaj, ndërsa sot kemi vetëm 12 javë. Mendoj se ky është një diskriminim i hapur dhe me pasoja për gratë dhe popullin tonë, që do të sjellë pasoja në zvogëlimin e natalitetit në Kosovë, që ka rrënie të dukshme nga viti në vit. Si arsyetim të kësaj që po e them, të nderuar deputetë, në vitin 2000 – 2009 numri i lindjeve në Kosovë ka qenë 39.901, tani këtë vit e kemi 27.718, që do të thotë 11.000 lindje më pak, ku me përqindje llogaritet 29%, e që në krahasim me vendet e tjera, si Zvicra e ka 6% rënien e natalitetit, Gjermania e ka 13%, a Kosova për çudi, këtë rënie e ka më shumë se 29%. Kjo do të thotë shumë dhe keq. As politikat serbe në atë kohë, me gjithë arsenalin e kontraktivëve të sjellë si mjete falas në Kosovë atëherë, qoftë si kontraktivë oral, qoftë intramuskular, apo edhe në formë të IUD-eve, nuk ka sjellë një rënie të tillë të natalitetit, e mos pyesim se askush nuk e di, as ne vetë që punojmë në gjinekologji, se sa është numri i aborteve i plotë i kryer, qoftë në klinikat publike apo ato private, që gratë tona janë të detyruar ta bëjnë për ta ruajtur atë vend të punës, që mos rrezikohen ta humbasin apo për t'u larguar nga kriza ekonomike dhe tryeza e varfërisë që po mbretëron në familjen kosovare.

Gratë janë më të diskriminuara në punësim dhe përfshijnë 12% të punësimit në Kosovë më pak se meshkujt dhe askënd s'e pengon kjo, veç gruan. Janë më të shfrytëzuara nga familja, nga burri dhe shoqëria në përgjithësi dhe askënd se pengon kjo.

Prandaj, të nderuar deputetë, miratimi i këtij ligji mund të bëhet në parim, mbetet që Komisioni i shëndetësisë të punojë me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, bile kur të ketë nevojë edhe me Qeverinë, për të gjetur një rrugë buxhetore që pushimi i lehonisë të jetë një vit, kështu e kanë edhe vendet në rajon që na rrethojnë, Shqipëria e ka një vit, Mali i Zi një vit, Serbia një vit, e pse të diskriminohen si gra në rajon për këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Naim Rustemi e ka fjalën, le të përgatitet deputetja Nerxhivane Dauti.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, i nderuar zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Shumë vërejtje u thanë deri më tani nga kolegët e mi, megjithatë ende jam i rezervuar për disa prej komenteve të drejtpërdrejta dhe teknike, po para se të bëjë listimin e këtyre vërejtjeve, unë kisha dashtë të them që ndoshta ishte dashur të vendoset aty një nen me të cilin i ndalohet Qeverisë që të nxjerrë udhëzim administrativ për ndryshimin e ligjit, sepse sot me fillimin e seancës zëvendëskryeministri e manipuloi opinionin publik kur tha se me udhëzim administrativ ka pasur të drejtë të nxjerrë atë udhëzim administrativ që e ndryshon Ligjin e prokurimit publik. Sa për hatër të drejtësisë dhe për vetëdijësimin e të tjerëve se megjithatë deputetët e kryejnë punën e tyre ndershem dhe ashtu siç duhet, po e përsëris: Neni 24.4 i Ligjit të prokurimit publik,

ja këtu e tregon saktë, pavarësisht nga dispozitat, vetëm në rastet kur është kontratë me vlerë të madhe, personi që është i autorizuar të nënshkruaj sipas nenit 24.1 ose 24.2, mundet që për qëllime ceremoniale t'i lejojë edhe një zyrtari tjetër të lartë publik. Me fjalë të tjera, për vlera me kontrata të mëdha mbi 100.000 euro sepse ligji e ka definuar. Tendencia e sotme për manipulim ka qenë tendencë jo e ndershme, sepse kjo tendencë nuk reflekton mirë në ndërtimin institucional të Kosovës. Veprime të tilla janë veprime shkatarrake që tregojnë për nivelin profesional të politikëbërjes, që tregojnë frustrim dhe mungesë konfidence tek Qeveria, që po lë përshtypje se çdo herë po humb pak nga pak kontrollin mbi situatën me vendimmarrje si me telekomandë, pa u brengosë për konsekuenca sa që vendimet mund të sjellin duke krijuar kaos në sistem, kështu që edhe ligjet që ne sot po i diskutojmë, të themi se nuk ka të drejtë t'i ndryshojë me udhëzim administrativ. Ekziston, është parim i përgjithshëm juridik, të gjithë ata juristë që punojnë në Qeveri e dinë se ligji nuk ndryshohet me udhëzim administrativ, është shkelje flagrante e ligjit edhe kërkohet nga Kryesia e Kuvendit që të marrë veprim që të ruaj sistemin juridik në Kosovë.

Tash po u kthehem vërejtjeve të mia konkrete. Në faqen 12, neni 9.10, të punësuarit mund të mos i takojë, të punësuarit për një punë specifike nuk i takon e drejta në pushim mjekësor dhe të drejtat e tjera të përcaktohen me kontratë kolektive dhe kontratë të punës. Unë propozoj të shtohet fjala “mund”, “mund të mos u takojë”, mos të jetë pak sa me orientim negativ, të jetë me orientim pozitivë kundrejt të drejtave dhe përgjegjësive të punëtorëve.

Në faqen 16, neni 13.1, propozoj që të fshihet kjo pikë, pika 2, “në qoftë se i punësuar nuk e fillon punën në ditën e caktuar me kontratën e punës, do të konsiderohet se nuk ka themeluar marrëdhënie të punës” të fshihet krejt, është e vetëkuptueshme dhe s'ka nevojë të thuhet hiq.

Gjithashtu, në faqe 16, te pika 14.3, po më duket se janë pakë 2 ditë para se të qitet prej pune një punëtor t'i jepen vetëm 2 ditë, t'i tregohet paraprakisht. Propozoj që të zgjatet kjo kohë së paku në një javë.

Faqe 31, neni 33, thuhet se festat që bien në ditët e punës, nuk llogariten si ditë pushimi vjetor. Propozoj që festat që bien në ditë jo të punës, të llogariten në javën ku janë ditët e punës. Me fjalë të tjera, punëtorët të kenë mundësinë e transferit të festës zyrtare, festa zyrtare nëse bien në ditë jo të punës, të bartet në javën në ditët e punës, sepse edhe kjo është një praktikë ma merr mendja që edhe po përcillet në Kosovë, por edhe përcillet edhe nëpër vende të tjera.

Gjithashtu, në faqe 34, po më duket paksa e lehtë kjo, “i punësuar ka të drejtë të mungojë nga puna 2 ditë në rast të martesës së tij”. Propozoj që nga një javë bile pushim t'i jepet kur të martohet dikush, s'shkon askush në punë për 2 ditë, kish për të qenë ligji më i implementueshëm.

Këto janë vërejtjet e mia, po edhe një herë po i kthehem bisedës fillestare. Kërkoj nga Kryesia e Kuvendit që të komunikojë me Qeverinë dhe t'ua ndalojë praktikën e dëmshme për organizimin e jetës institucionale në Kosovë, që të mos u lejojë të ndryshojnë ligjin me udhëzime administrative. Ekzistojnë procedurat me të cilat ndryshohet ligji, ligji mund të amendamentohet s'ka asnjë problem, por me udhëzim administrativ të ndryshohet ligji, kjo me të vërtetë është shkatarrake.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nerxhivane Dauti e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Gani Buqica.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra të pranishëm,

Ligji i punës është një ligj me rëndësi të veçantë për Republikën e Kosovës, ligj për të cilin jam interesuar që të shqyrtohet në Kuvend e për të cilën kam parashtruar dy herë pyetje parlamentare, prandaj e përshëndes Ministrinë e Punës për sjelljen e këtij ligji në shqyrtim në Kuvend.

Qëllimi i Projektligjit të punës është krijimi i raporteve të mirëfillta në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit, si dhe krijimi i dispozitave ligjore nga marrëdhënia e punës në përputhje me rregullat e ekonomisë së tregut dhe të tregut të punës.

Projektligji për punën rregullon çështjet më të rëndësishme nga fusha e punës dhe punësimit që kanë të bëjnë me kushtet për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin privat dhe publik, mbrojtjen dhe sigurinë në punë, ndërprerjen e marrëdhënies së punës, liritë dhe të drejtat sindikale për të punësuarit dhe çështjet tjera që gërshetohen me këto të theksuara.

Edhe pse theksohet se ky projektligj është hartuar duke u mbështetur në 6 direktiva evropiane, si ajo e Këshillit të Evropës 99/70 të vitit 96 dhe pas direktiva të tjera që kanë të bëjnë me rregullativën e organizimit të kohëzgjatjes së punës, me punën me orar të përgjysmuar, sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit gjatë punës. Megjithatë, duhet theksuar se Projektligji nuk mbulon të gjitha aspektet e legjislacionit evropian, por është e nevojshme të vazhdohet në hartimin e akteve normative me qëllim të përafrimit të legjislacionit me parimet kryesore të *acquis communautaire*.

Projektligji i punës ka rëndësi të veçantë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, si një akt ligjor bazik dhe sistemor, i cili mbulon një fushë të rëndësishme, e cila gjer më tani është rregulluar me rregullore jo përmbajtjesore, që kanë rregulluar raportet në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Projektligji i propozuar sjell ndryshime të rëndësishme në lëmin e marrëdhënies së punës, të cilat i konsideroj të rëndësishme dhe të dobishme, por megjithatë konsideroj se duhet bërë në disa nene edhe riformulime përkatëse me qëllim të precizimit më të mirë jo vetëm të teknikës juridike, por edhe të çështjeve thelbësore të marrëdhënieve të punës që rregullohen me këtë projektligj.

Kështu, ndryshime dhe formulime propozoj në nenin 9, paragrafi 1 dhe 2, që ka të bëjë me kontratën e punës.

Në nenin 16, paragrafi 4, te caktimi i të punësuarit në vendin e punës.

Në nenin 38, paragrafi 1 pikat 1,2 dhe 3, që rregullojnë çështjet e mungesës me pagesë, ku në rastin konkret propozoj në vend të 2 dhe 3 ditë, propozoj 3 dhe 5 ditë. Pastaj në nenin 48, paragrafi 1, që rregullon pushimin e lehonisë, konsideroj se duhet ndryshuar sepse kohëzgjatja e këtij pushimi është shumë e shkurtër. Në paragrafin e nenit 50, paragrafin 2, që ka të bëjë me pushimin e lehonisë për humbjen e fëmijës në kohëzgjatje prej 45 ditësh, konsideroj se duhet zgjidhur koha e pushimit. Në nenin 88, propozoj që ky nen të titullohet kontrata kolektive e jo ashtu siç është propozuar në Projektligjin e punës.

Duke marrë parasysh rëndësinë e veçantë që ka Ligji i punës për sistemin juridik të Republikës së Kosovës, e mbështes projektligjin e propozuar në shqyrtim të parë, duke konsideruar se vërejtjet dhe sugjerimet e paraqitura do të merren parasysh në fazën e amendamentimi të këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca, le të përgatite deputeti Hajdin Abazi.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Padyshim, sot është një ngjarje e rëndësishme për punën e Kuvendit të Kosovës meqë Qeveria e ka proceduar Projektligjin për marrëdhënien e punës. Unë desha vetëm t'i jap disa shpjegime, përkatësisht miratimin tim për këtë ligj dhe të falënderoj në përgjithësi deputetët për frymën konstruktive që e patën gjatë diskutimit të këtij projektligji.

Unë pajtohem me shumë vërejtjet që u dhanë këtu nga kolegët deputetë, ishin vërejtje parimore, të arsyeshme dhe nuk kisha dëshiruar t'i përsëris, mirëpo desha vetëm të saktësoj për hir të informimit të opinionit publik se Ligji për punën është një detyrim kushtetues dhe shtetet e ndryshme i kanë rregulluar këtë fushë në mënyra të ndryshme. Për problemet si problemi i lehonisë ose ndonjë problem tjetër, nuk ka në Evropë një ligj unik që i rregullon këto çështje në mënyrë unike. Mirëpo, si kategori kushtetuese, e drejta në punë është një e drejtë natyrore, është një drejtë etike, morale, juridike dhe politike dhe ato shtete të cilat e garantojnë në dispozita kushtetuese të drejtën në punë, ato shtete pastaj marrin edhe obligime ndaj të punësuarve që janë dhe e rregullojnë në mënyrë më specifike të drejtën në këtë fushë të veprimtarisë njerëzore. Kurse ka shtete tash, në përfundim, në demokraci të avancuara që nuk e njohin të drejtën në punë, por e njohin të drejtën për të jetuar, dhe pikërisht të gjitha ato shtete që si dispozitë kushtetuese e kanë të drejtën për të jetuar të çdo qytetari të vetë, ato pastaj e kanë edhe politikat sociale dhe ligjet e punës ndryshojnë në thelb gjatë hartimit të këtyre ligjeve. Për shembull, nëse në kushtetutën tonë do të njihej e drejta për të jetuar, shteti do të merrte obligim ndaj çdo qytetari që të sigurojë minimumin jetik, kurse në Kosovë në kushtetutën tonë nuk ekziston kjo dispozitë. Dhe, unë, duke qenë si ithtarë i një demokracie liberale me fytyrë sociale, mendoj se ne duhet të gjejmë një rrugë të ndërmjetme dhe në procedimin e mëtutjeshme të ligjit në konsultim edhe me grupet e interesit, edhe me sindikatat të avancojmë të drejtat e punëtorëve në Kosovë në përgjithësi dhe të bëjmë një ligj që të jetë edhe në korelacion, në harmoni me ligjet përfaqësues të Bashkimit Evropian.

Toleranca e Bashkimit Evropian në këtë drejtim është shumë më e madhe se për disa ligje tjera për arsye se një ligj i tillë varet edhe nga fuqia ekonomike e shtetit në momentin në të cilën ligji aprovohet. Duke e trajtuar ligjin si një dokument dinamik dhe duke i trajtuar proceset në Kosovë si procese dinamike, unë besoj se në të ardhmen e afërt të drejtat e punëtorëve në Kosovë do të avancohen dhe ligji duhet t'i ketë parasysh dhe duhet t'i disponojë edhe disa dispozita për disa të drejta të cilat për momentin nuk mund të realizohen, mirëpo që në të ardhmen e afërt, kur ta kemi një zhvillim më të mirë ekonomike, ato të jenë në ligj dhe të fillojnë të aplikohen.

Sa i përket pushimit të lehonisë, pavarësisht se jam ithtarë që pushimi i lehonisë të jetë më i madh, desha të informoj opinionin e gjerë publik se shtetet të cilat kanë probleme demografike, kanë një politikë tjetër sa i përket pushimit të lehonisë. Kurse ne, pavarësisht se nataliteti në Kosovë është në rënie, akoma nuk jemi në atë fazën kur mund të themi se kemi problem me natalitetin dhe probleme demografike, kështu që isha angazhuar që së paku një ligj të jetë një periudhë 9 mujore e lehonisë.

Desha të paraqes vetëm një problem, që është problem më shumë etik. Çka nëse pushimi i lehonisë është shumë i gjatë dhe punëmarrësit nuk dëshirojnë t'i pranojnë femrat në punë pikërisht për shkak të pushimit të lehonisë. Mund të jetë në përpjekje tona për të përkrahur një grua nënë, në anën tjetër mund të ketë edhe efekte kontraproduktive, se në shumë shtete ku pushimi i lehonisë është i gjatë, punëmarrësit hezitojnë të punësojnë femra në punë dhe mund të jetë kontraproduktive. Kjo është e para.

Kurse, një problem tjetër që është i natyrës etike, është problemi i grave të papunësuar. Ne kemi në Kosovë shumë gra të cilat kanë dëshirë të punësohen, por nuk mund të arrijnë deri te vendi i punës dhe çfarë të drejtash gëzojnë ato në rastin kur linden. Ky ligj duhet kuptuar si ligj, pushimi i lehonisë duhet kuptuar si një pushim i cili bëhet për shkak të fëmijëve e jo për shkak të grave. Unë mendoj se në këtë kuptim fëmijët të cilët nuk i kanë nënat e punësuar, janë të diskriminuar, kurse gratë të cilat nuk janë të punësuar, janë dy herë të diskriminuara, një herë pse nuk kanë qasje në vend të punës dhe, në anën tjetër, nuk marrin kurrfarë ndihme nga shteti.

Do të thotë, unë e thashë qysh në fillim, fryma ishte shumë konstruktive dhe besoj që në amendamentim e mëtutjeshëm të ligjit, ligji do të marrë një formë të pranueshme dhe do të jetë një ligj i mirë. Unë në parim e përkrah ligjin.

Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Faleminderit!

Rrumbullakoni nga 5 minuta, mendoj se mjaftë janë. Hajdin Abazi, le të përgatitet deputeti Ibrahim Gashi.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Ne të gjithë jemi dëshmitarë se në realitetin tonë, sidomos në fushën e punësimit, ka pasur jashtëzakonisht shumë probleme të punësimit në mënyrë të parregullta, njerëzit që punojnë dhe nuk kanë kontrata pune, nuk kanë pasur kurrfarë të drejtash, nuk kanë pasur mbrojtje, nuk kanë pasur siguri. Ne dimë raste kur njeriu në vend pune ka humbur krahun ose në kryerje të detyrës e ka humbur edhe jetën dhe kurrfarë kompensimi nuk u është siguruar atyre. Për më tepër, nuk ka qenë e rregulluar as marrëdhënia e punës se si mund të ndërpritet ajo dhe sidomos në sferën private, pronari kur ka dashur i ka thënë punëtorit – nesër nuk ke çka vjen në punë. Të gjitha këto përbëjnë atë gamën e të drejtave të qytetarëve tanë që kanë qenë jashtëzakonisht të diskriminuar dhe pa kurrfarë mbrojtjeje. Meritë e këtij ligji është se pikërisht këto çështje do t'i rregullojë dhe në radhë të parë do t'i rregullojë kushtet dhe kriteret për themelimin e marrëdhënies së punës, do ta përcaktojë me ligj orarin e punës dhe jo sikurse që i konvenon një pronari ose punëdhënësi, kur në vend se të ketë 8 orë, punojnë nga 12 orë ose edhe 16 orë dhe pagat janë tepër diskriminuese dhe, mbi të gjitha, për herë të parë tash me ligj do të rregullohet mbrojtja dhe siguria në vendin e punës të të punësuarve. Po ashtu, do të rregullohet edhe kompensimi i pagave dhe i koeficienteve, si dhe me këtë rast do të sigurohet edhe e drejta se në çfarë kushtesh dhe rrethanash mund t'u ndërpritet puna si nga ana e punëdhënësit, ashtu edhe nga ana e punëmarrësit. Këto janë disa të drejta elementare që duhet secili punëtorë t'i gëzojë në vendin e punës. Por, mbi të gjitha, këtu rregullohen edhe liritë dhe të drejtat sindikale të të punësuarve për arsye se sindikatat tona duhet vërtet të kenë një fuqi më të madhe dhe të mund t'i mbrojnë të gjithë të punësuarit.

Pikërisht se ligji synon t'i rregullojë dhe në mënyrën e vet t'i rregullojë të gjitha këto që kanë qenë të parregulluara deri më tash, konsideroj se jo vetëm është një pritje që nga paslufta e këndeje e të gjithë atyre që janë të punësuar, por edhe meriton elozhe për arsye se për herë të parë do të vihen mbi bazat ligjore sistemi që do të rregullojë se si do të funksionojë marrëdhënia e të punësuarit kundrejt punëdhënësit dhe anasjelltas, si dhe të drejtat dhe sidomos mbrojtja e të drejtave të punës dhe siguria në vendin e punës.

Nga kolegët e mi u dhanë një sërë vërejtjesh, sugjerimesh, pjesa dërmuese e të cilave ishin me vend dhe unë i përkrah, prandaj në to nuk do të ndalem, vetëm se dua të theksoj se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, që i mbetet ndoshta edhe komisionit funksional, por edhe gjithë ne si deputetë

të japim kontributin tonë se si do të rregullohet çështja, sidomos për ata që janë në marrëdhënie pune nga paslufta e këndej për arsye se janë bërë shumë të padrejta në këtë drejtim, ka shumë ankesa dhe nuk kanë pasur një rregullim ligjor si të bëhet kjo. Do të thotë, ligji sa për të hyjë në fuqi, në radhë të parë do të niset nga gjendja e atyre që janë në marrëdhënie të punës dhe vërtet shpresoj se në këtë drejtim do të merren masa me një dinamikë shumë të madhe që të rregullohet dhe të bëhet ligji funksional.

Është e vërtetë se sidomos çështja e kompensimit të punës pas orarit, të punës së natës, të punës së ditëve të vikendit, të festave e të tjera u është mohuar e drejta të punësuarve që t'i gëzojnë ato të drejta tani ligjore, pa pasur mundësi në ndonjë mënyrë tjetër t'ju mohohen, kurse kur ndonjë punëtor heq dorë nga pushimi, ai punon sepse ka dhe do të ketë interes që ajo punë t'i shpërblehet dhe përqindjet që janë të përcaktuara tani këtu, ato janë të qarta dhe askush nuk mundet këto të drejta më t'ua mohojë atyre, por do të jenë automatikisht funksionale.

Konsideroj se ligji, bazuar në kushtet dhe rrethanat tona, i plotëson kushtet themelore që duhet t'i ketë dhe ne duhet të përpiqemi që aty – këtu ta përmirësojmë edhe pak. Mirëpo, ne duhet të jemi të qartë, ne as nuk i kemi kushtet materiale, do të thotë nuk kemi buxhet shtetëror, as nuk kemi industri që të krahasohemi me vendet e perëndimit dhe të kërkojmë që ne automatikisht të jemi të nivelit çfarë janë ato. Mjafton me këtë ligj që po iniciohet dhe do të niset rregullimi i të gjitha të drejtave që përmenden në këtë ligj dhe me kohën, krahas krijimit të kushteve të mira, ne jemi deputetë ose gjeneratat e tjera që do të jenë deputetë, do të kujdesen që t'i avancojnë të drejtat ashtu që të jenë vërtet funksionale dhe të ketë mundësi realizimi i tyre.

Prandaj, unë jo vetëm do ta votoj, në parim, por do ta votoj me gëzimin më të madh, sepse me këtë rast qindra mijëra punëtorëve të Kosovës do t'u jepet ajo e drejtë që padrejtësisht u është marrë thajse që 10 vjet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit: Ibrahim Gashi e ka fjalën, le të përgatitet Zylfije Hundozi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sigurisht që edhe unë i bashkohem konstatimit të parafolësit se me gëzim është pritur në Kuvendin e Kosovës Projektligji i punës, një ligj i shumë pritur me të drejtë sepse të gjitha shoqëritë në tranzicon, edhe Kosova në tranzicionin e saj të vonshëm është përballur me një abuzim të të drejtave më elementare të punëtorëve ndoshta për mungesë të këtij ligji, por unë nuk mendoj që vetëm për mungesë të këtij ligji, po mbase edhe për mungesë të vullnetit të punëdhënësve për të zbatuar edhe atë legjislacion i cili ka qenë në fuqi, që sado i mangët që mund ketë qenë, megjithatë ka qenë më i mirë edhe ashtu si ka qenë, po të respektohej.

Sigurisht që shumica e parafolësve, kolegëve, kanë evidentuar plotësimet eventuale që mund të pësojë ky ligj gjatë këtij diskutimi deri në aprovimin final. Unë do të ndalem mbase edhe mund të kërkoj falje, nëse diçka përsërisë për pjesën që nuk isha në seancë, po ligji duhet të jetë më fleksibil dhe të ketë parasysh gjendjen e ekonomike dhe sociale në të cilën aktualisht është Kosova, si shtet i ri. Unë e kuptoj që shumica e ligjeve që i kemi aprovuar dhe që do t'i aprovojmë, janë marrë nga diku, nuk janë krejt burimore, po janë mbështetur në modele të shteteve të caktuara dhe natyrisht ajo pjesa më e vështirë e jona është që ato ligje të akomodohen në rrethanat e shtetit të Kosovës, të mund t'i akomodojmë. Këtu mendoj që ky ligj ndoshta për një nuancë nuk përmbush shumë atë komponentin e mbrojtjes së punëtorëve në një vend kaq të varfër dhe në një tranzicion kaq të egër nga një shoqëri, ta quajmë socialiste, në një kapitalizëm, që për mua është para monopolistik dhe që është mjaftë i vrazhdë. Për shembull, do të ndalesha

te pushimi i lindjes, është mjaftë rigid ligji për të cilën po diskutojmë dhe së pakut mund të bëhej, për shembull, që pjesa e vazhimit të pushimit të lindjes pa pagesë të jetë më e gjatë, për dy arsye.

E para, shumë nëna të posalindura kanë dëshirë që të jenë me fëmijën e tyre pak më gjatë edhe me koston e humbjes së të ardhurave për një periudhë. Dhe, e dyta, për shembull nga 12 javë të bëhet 24 javë kjo mundësi, dhe e dyta, punëtorët që merrem për zëvendësimin e tyre, është vështirë që të merren punëtorë për një kohë tepër të shkurtër, në vend që të merren për 9 muaj apo për një vit dhe këtu nuk dëmtohet mendoj buxheti i Kosovës, por ligji bëhet më fleksibël për ata që dëshirojnë.

Pastaj, është neni 62 i ligjit, që për mua lë hapësirë, pra i ka disa zbrazëtira ky ligj, ku punëdhënësi prapë mund të shkelë të drejtat e punëtorit, mund t'i shmanget këtij ligji pa paragjykuar edhe aktet tjera nënligjore që mund t'i japin hapësirë edhe më shumë. Për shembull, neni 62, për dëmin e shkaktuar në punë nga i punësuar, nuk ka një dispozitë të saktë e cila ka të bëjë me konstatimin e shkaktarit të dëmit. Kjo diqysh anashkalohet dhe vlerësimi vjen prej punëdhënësit, ai e vlerëson se është shkaktuar dëmi i kësaj apo i asaj përmase.

Neni 68, prapë te ndërprerja e kontratës së punës, në fakt neni 69 paragrafi 1.2, një prej mundësive të ndërprerjes së kontratës së punës janë me arsyetimin, me motivin se i punësuar nuk është i aftë t'i kryej detyrat e punës dhe këtë vlerësim prapë e bën punëdhënësi, i cili në kualifikimin e tij, në vlerësimin e tij mund të jetë i njëanshëm dhe mund ta ndërrojë punëtorin me këtë justifikim, pa pasur ndonjë kontroll tjetër që e vlerëson a është apo nuk është ai punëtor i aftë.

Largimi i përkohshëm nga puna, prapë është një dispozitë që i lë hapësirë punëdhënësit që në këto përkufizime ligjore që jepen në këtë ligj, prapë lehet hapësirë për interpretim që mund të shkojë në favorin e punëdhënësit. Natyrisht, ajo që e evidentoi njëri nga deputetët, paragrafi 9.2 lidhur me kontratën verbale, ajo është një hapësirë tepër e madhe që i lehet punëdhënësit për ta shfrytëzuar këtë ligj dhe për të vazhduar me kontrata një muajsh, në vend të kontratave që kanë qenë punësim me kontratë në vepër, si e kemi pasur deri më tash. Tash kjo është një diçka e tillë, veç e modifikuar për një muaj, që mund të zgjatet pa kufi derisa inspekcioni të shkojë t'ia matë kohën sa ka qëndruar i njëjti punëtor.

Këto kishin për të qenë ato vërejtjet që janë thënë në një mënyrë apo në një mënyrë tjetër, edhe unë u mundova t'i them në mënyrë kontekstuale një farë mënyre për ta përmirësuar aq sa dimë dhe mundemi një draftligj i cili ka mund të jetë edhe më i mirë, gjithsesi, ka mund të jetë edhe më kompatibil me vendet e rajonit dhe më gjerë që e kanë një farë mënyre, janë në këtë trajektore të zhvillimit edhe ekonomik, edhe shoqëror, edhe politik, siç është Kosova. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Zylfije Hundozi e ka fjalën, le të përgatitet deputetja Nekibe Kelmendi.

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegë të nderuar,

Kjo është e treta herë që Projektligji për punë vjen në lexim të parë në Parlament. Deri tash është punuar me Rregulloren e UNMIK-ut, e cila edhe pse i vetmi legjislacion për punën, nuk është zbatuar në praktikë dhe punëtorët kanë qenë me mëshirën e punëdhënësve, duke mos qenë në gjendje t'i realizojnë të drejtat e tyre. Kjo pohohet edhe në Raportin e progresit të Komisionit Evropian, citoj nga raporti: "Legjislacioni për punën zbatohet dobët dhe sindikatat nuk janë

aktive në dialogun social”. Shkaku i kthimit në Ministri të Punës dhe të Mirëqenies Sociale të këtij projektligji dy herë me radhë, ka qenë se kostoja buxhetore për implementimin e këtij ligji ka qenë e madhe, por edhe sot në këtë projektligj nuk kuptohet qartë se sa do të kushtojë implementimi i këtij ligji, kështu që edhe ky version i projektligjit mund të kalojë në leximin e parë e pastaj të kthehet prapë në Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale.

Në pjesën ku arsyetohet kostoja buxhetore, pranohet haptas se për shumicën e sektorëve nuk kemi të dhëna për shtesat dhe pagesat e tyre nga buxheti aktual, gjë që nuk mund të besoj se këto të dhëna ekzistojnë, por si duket nuk ka pasur kush t’i llogarisë, ndoshta me këto arsyetime është dashur të fshihet kostoja e vërtetë buxhetore e këtij projektligji.

Një shkak tjetër i kthimit të këtij projektligji prapë në Ministri është me pretekst se nuk do t’i tërheqë investitorët e huaj për shkak se është më i favorshëm për punëtorin se sa për punëdhënësin. Nuk është vetëm Ligji për punë ai i cili do t’i tërheqë investitorët e huaj, por në rend të parë është sundimi i ligjit dhe zhdukja e korrupsionit, e përmbushja e këtyre kushteve në Kosovë është larg.

Diçka që është pritur një kohë të gjatë të rregullohet me këtë ligj, ka qenë edhe pushimi i lehonisë, që gati të gjithë deputetët e përmendën këtu. Me këtë projektligj shkurtohet pushimi i lehonisë dhe prej 6 muajve, si ka qenë deri më tash, bëhet 3 muaj, gjë që është e papranueshme për arsye se fëmija 3 muajsh ushqehet me gjë. Kjo është gjë e rregulluar me Ligjin për ushqimin e foshnjës me gjë, ku preferohet që fëmija të ushqehet me gjë gjer në një vit, e ekskluzivisht vetëm me gjë deri në 6 muaj. Nëse e marrim parasysh orarin e punës, foshnja duhet të rrijë 8 orë pa qumështin e nënës, gjë që do ta dëmtojë shëndetin fizik dhe psikik të saj. Një psikiatër i njohur ka thënë: “mi jepni nënat e mira dhe do t’ju krijoj kombin më të mirë”. Nga ana tjetër, çerdhet publike i marrin fëmijët vetëm nga mosha njëvjeçare, gjë që rrjedh se edhe efikasiteti i femrës, e cila e ka lënë foshnjën 3 muajshe që të kujdeset dikush tjetër për te, nuk do të jetë efikase në punë, por edhe nuk do të lindë më. Nëse i shohim statistikën, nataliteti në Kosovë ka rënë shumë dhe me këtë projektligj, nëse aprovohet, do të bjerë edhe më shumë. Këtë lukës, ne si komb i vogël nuk mund t’ia lejojmë vetes.

Një çështje tjetër që nuk është precizuar në këtë projektligj, është se ceket mirë se kur fillon marrëdhënia e punës, por nuk thuhet se kur mbaron, edhe pse ndoshta do të ceket në ndonjë ligj tjetër, por është e domosdoshme të dihet se kur fillon marrëdhënia e punës dhe kur mbaron ajo.

Unë, personalisht e përkrah, në parim, miratimin e tij dhe besoj se neni ku përfshihet çështja e lehonisë do të ndryshohet nga komisioni funksional. Faleminderit!

KRYETARI: Prezentë janë 67 deputetë, kartela janë 84. unë kisha kërkuar nga ju kolegët edhe nga administrata, të hiqen kartelat që nuk janë prezentë deputetët.
Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Unë mendoj se ligji në përpunim e sipër më tutje duhet t’i përfshijë të gjitha parimet themelore që parashihen me Organizatën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Punëtorëve apo ILO-s, në mënyrë që të dalë një ligj vërtet shumë i mirë, kurse më konkretisht do të ndalem në disa nene apo pika të neneve.

Fjala është për nenin 66, sipas të cilit me pikën 1.5, thuhet: “Në ditën e dorëzimit të aktvendimit të plotfuqishëm për vërtetimin e humbjes së aftësive të punës, i pushon marrëdhënia e punës”. Mund të mos jetë ai invalid mbi 75% kur duhet t’i pushojë marrëdhënia e punës. Mund të jetë me një shkallë të invaliditetit më të ulët dhe të dërgohen në vend tjetër pune, e jo menjëherë t’i ndërpritet marrëdhënia e punës.

Nga ana tjetër, pika 1.6 e të njëjtit nen thotë: “I punësuar është i dënuar me burg ose është liruar me kusht, sipas aktgjykimit përfundimtar”. Nëse është i dënuar me burg, për shembull, për kundërvajtje prej 60 ditësh ose 15 ditësh, a do të thotë kjo se ai duhet ta humb marrëdhënien e punës? Unë mendoj se jo dhe duhet të fshihet. Gjithashtu, edhe nëse lirohet me kusht prej gjykatës, ai nuk largohet nga puna, mund ta vazhdojë punën prapë. Prandaj, pika 1.6 duhet të fshihet e tëra. Gjithashtu duhet të fshihet edhe pika 1.7, sepse thotë – me vendimin e gjykatës kompetente, vendim që pason ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Gjykata nuk është ajo që dikujt ia ndërprente marrëdhënien e punës, ajo vetëm vlerëson nëse marrëdhënia e punës është ndërprerë në mënyrë të drejtë apo jo të drejtë. Pra, i mbron të drejtat e punëtorëve e jo t’ua shkelë të drejtat punëtorëve. Dhe, më në fund, gjykata nuk është punëdhënëse në rastet e punëdhënësve privatë dhe nuk mund as t’ju ndërpresë marrëdhënien e punës punëtorëve.

Te neni 69, thotë: “Ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit”. Punëdhënësi mund ta ndërpresë sipas kësaj pike, pika 1.5.1 thotë: “I punësuar është fajtor për përsëritjen e një keqsjelljeje”. Pse të merret kjo keqsjellje, çka na kupton ajo keqsjellje? Kjo lejon arbitrarizëm, kjo lejon njëanshmëri te punëdhënësit privat. Prandaj, duhet me këtë ligj sa më pak t’u lejohet hapësirë punëdhënësve privatë që t’i përdorin arbitrarizmat apo njëanshmëritë, apo edhe keqpërdorimet e të drejtave të punëtorëve.

Nga ana tjetër, kur jemi te procedura disiplinore, mendoj se gjithmonë punëtorit duhet t’i mundësohet e drejta për të angazhuar mbrojtës për mbrojtjen e të drejtave të tij gjatë zhvillimit të procedurës së punës dhe njëkohësisht të marrë pjesë gjatë procedurës edhe një përfaqësues i sindikatës, i cili gjithashtu duhet t’i mbrojtë të drejtat dhe e ka për detyrë t’i mbrojtë të drejtat e punëtorit në punë.

Dhe, në fund, më duket se pragu i moshës për fitimin e të drejtës për t’u punësuar është ulë shumë në moshën 15, madje për punë më të lehta edhe në moshën 12 vjeçare. Atëherë, ne po i stimulojmë fëmijët që mos të shkollohen, por të punësohet, madje as shkollën e mesme mos ta kryejnë. Duhet shikuar mirë se prej cilës moshë mund të fitojë të drejtën për punë. Kjo është e rregulluar edhe me norma ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Faleminderit, se po shoh se janë lodhur, s’po dëgjon askush, sa për transkript fola mjaft.

KRYETARI: Faleminderit!

E keni një kartelë tepër diku. Jo, po e saktësojmë prezencën, në mënyrë që ta dimë, ta kemi parasysh.

Vazhdojmë me procedurën e votimit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 74 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin e punës.

Në bazë të Rregullores, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional, dhe komisionet e përhershme.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve, nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Pika e radhës është:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Punës së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, zotin Fehmi Mujota, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë projektligjin.

MINISTRI FEHMI MUJOTA: I nderuar kryetar,

I nderuar ministër,

Zonja deputete, zotërinj deputetë,

Sot para jush sjell Projektligjin për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës, përkatësisht nenin 14.1 të Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ku parashihet struktura dhe organizimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës, që përmban 2500 pjesëtarë aktivë, 800 pjesëtarë rezervë.

Tani, para jush kemi sjellë Projektligjin që rregullon aktivizimin e komponentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, që do të ketë 800 pjesëtarë.

Mbi bazën e këtij ligji, ne plotësojmë edhe më tepër bazën ligjore për funksionimin e mirëfilltë, sipas kushtetutës, të Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe mundësohet aktivizimi në kohën e paraparë sipas dinamikës dhe planit që tanimë është miratuar.

Prandaj, më lejoni që në pika të shkurtra t'ju njoftoj që miratimi i këtij ligji nënkupton se do të ketë edhe një ndikim buxhetor, që sipas vlerësimeve tona është diku 7.1 milionë euro, buxhet ky i cili do të harxhohet përbrenda tri viteve në periudhën kohore 2010 - 2013. Për vitin e parë, buxheti është i garantuar në Ministrinë tonë, ndërsa për 2 vitet e tjera, po ashtu, është paraparë në Kornizën afatmesme të shpenzimeve buxhetore.

Gjithashtu, dua t'ju njoftoj që ligji është në kuadër të Kornizës ligjore të Qeverisë së Kosovës dhe jemi në afatin e duhur për ta bërë këtë punë, por para gjithash duhet të plotësojmë një kriter që në kohën e duhur të mund të bëjmë rekrutime të këtij komponenti rezervë, që është element i qenësishëm për të përmbushur të gjitha kapacitetet tona të sigurisë.

Prandaj, buxheti që do të shpenzojmë për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë përfshinë: uniformën dhe pajisjet tjera personale për secilin pjesëtarë të Forcës së Sigurisë të komponentit rezervë, përfshinë afatësimet profesionale dhe stërvitjet e tjera, po ashtu përfshinë ambientimet, përkatësisht vendosjen e njerëzve në kazerma dhe në ambient të punës, si dhe do të ketë edhe një angazhim tjetër, i cili nënkupton se buxheti do të shpenzohet edhe për armatimin, për municionin dhe pajisjet tjera që iu duhen pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë.

Po ashtu, më lejoni që para jush të konstatoj se ligji është punuar bashkërisht me këshilltarët e NATO-s dhe është në pajtueshmëri të plotë me standardet e NATO-s. Po ashtu, ky ligj tanimë ka

kaluar të gjitha fazat e diskutimit dhe janë pjekur të gjitha kushtet që të aprovohet, si dhe janë bërë përgatitjet për komponentin rezervë sipas planit tonë dhe me miratimin në Kuvendin e Kosovës, ne do të mund të fillojmë menjëherë në fazën e rekrutimit të këtyre pjesëtarëve, që nënkupton se të gjitha kushtet e rekrutimit të pjesëtarëve rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës janë të ngjashme me ato të pjesëtarëve aktiv, si dhe garanton të drejtën e mbajtjes së punëve të rregullta të çdo pjesëtari i cili do të mund të bëhet pjesëtar i kësaj force të sigurisë. Ne jemi të hapur për Komisionin, për Forcën e Sigurisë së Kosovës, që do të bëjë amendamentimin e këtij ligji në çdo kohë që të japim kontributin tonë për plotësimin e elementeve shtesë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Komisioni, nuk e do fjalën, jo? Gjylnaze Sylja e ka kërkuar fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë ka mbajtur mbledhjen dhe i ka propozuar Kuvendit që në parim ta përkrahë këtë projektligj. Ka pasur vetëm disa vërejte të vogla teknike. Ky është vendimi i komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Ramadan Avdiu e ka fjalën.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës me vëmendje e ka shqyrtuar Ligjin për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe konsideron se sot para vetes kemi një projektligj shumë të rëndësishëm që rregullon dhe plotëson kornizën ligjore që ka të bëjë me Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Ligji derivon nga Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe përcakton rregullimin e shërbimit për pjesën rezervë të FSK-së, pjesë e strukturës e FSK-së, e cila shërben brenda dhe jashtë vendit për sigurimin e paqes dhe në raste të emergjencave.

Me këtë rast, unë do të dëshiroja që ta përgëzoj Qeverinë në përgjithësi dhe Ministrinë e FSK-së në veçanti, e cila ka hartuar një draft jashtëzakonisht të mirë dhe gradualisht po shkon drejt rrumbullakimit të strukturimit të plotë të Forcës së Sigurisë.

Projektligji është më se i domosdoshëm sepse në mungesë të tij akoma nuk ka filluar procesi i krijimit të pjesës rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Projektligji përcakton detyrat dhe obligimet e pjesëtarit rezervë të FSK-së, si dhe mënyrën e rekrutimit dhe të drejtat e tij.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës konsideron se në procedurën e mëtejme të ligjit, ky ligj duhet të harmonizohet në aspektin gjuhësor, ngase ka dallime në të tri gjuhët, e po ashtu duhet të shihet edhe zëvendësimi i nocionit “komponenti” me fjalën “pjesë” dhe rrjedhimisht që ndryshohet edhe emri i projektligjit nga Ligji për komponentin rezervë të FSK-së në Ligji për pjesën rezervë të FSK-së.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet fuqishëm këtë projektligj dhe zotohet se deputetët e PDK-së do të angazhohen seriozisht në procedurën e mëtejme gjatë shqyrtimit në komisione funksionale.

Po ashtu, unë i ftoj edhe kolegët deputetë që ta votojnë këtë ligj më së të nevojshëm për strukturimin dhe rrumbullakimin e ndërtimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës si forcë mbrojtëse e vendit tonë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Më falni, unë dua t'ia tërheq vërejtjen një deputeteje që po do ta tregojë prezencën e shoqes së saj duke e vendosur kartelën, le ta heq. Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kush e donë fjalën? Kryetari i grupit, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Duke e ditur që këtë duhet ta them në fund, po e them në fillim për të mos e zgjatur. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet, në parim, miratimin e këtij projektligji, duke konsideruar si projektligj të rëndësishëm në vazhden e kompletimit të infrastrukturës ligjore për Forcën e Sigurisë dhe në përgjithësi për Ministrinë e Forcës së Sigurisë dhe kontributin e vet do ta japë nëpërmjet deputetëve në komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AAK-së, Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Po e shoh që Gani Koci diçka po kundërshton, po unë desha ta lus kolegun Avdiu – a tha PDK-së a PTK-së. Faleminderit!

Ligji të cilën po e shqyrtojmë, Projektligji pra për komponentin rezervë të FSK-së është një projektligj shumë i rëndësishëm duke marrë parasysh se Forca e Sigurisë së Kosovës në shtetin tonë të ri, me demokraci të re, si institucion i sigurisë ka një rëndësi të veçantë. Prandaj, rregullimi ligjor ose krijimi i infrastrukturës ligjore për funksionalizimin e forcës së sigurisë ka një rëndësi të madhe. Në fund të fundit, kjo rregullohet edhe me pakon e Ahtisarit dhe kjo çështja e rezervës del në të vërtetë edhe nga ligji bazik që është Ligji për Forcën e Sigurisë.

Aktualisht, në Kosovë janë 800 pjesëtarë të Forcës rezervë të Sigurisë. Përndryshe, projektligji është i punuar mirë, është i shkurtër dhe është lehtë i kuptueshëm.

Projektligji rregullon statusin e pjesës rezervë, angazhimet e rezervës së FSK-së brenda dhe jashtë vendit, qoftë në situata të paqes apo në situata të emergjencës. Atë çka kisha dashur është se këtë të drejtë për të qenë pjesëtar i forcës rezervë e ka çdo qytetar i Kosovës i cili plotëson kushtet përkatëse, e që në një mënyrë mund ta kombinojë rolin e angazhimit të tij në siguri me karrierën civile. Prandaj, angazhimi i këtij qytetari në forcën rezervë është me të vërtetë një punë dytësore. Vlera e forcës rezervë, ashtu siç e projekton edhe ky projektligj, është se është një forcë lehtë e disponueshme për një kohë të shkurtër për nevoja të caktuara. Vlera tjetër është se shpenzimet janë më të vogla, që do të thotë se po të bëhej rekrutimi i anëtarëve të rinj, kostoja buxhetore do të ishte shumë e madhe në krahasim me rekrutimin e forcës rezervë. Pos kësaj, mund të sjellin edhe cilësi në forcën e sigurisë pasi që në shumtën e rasteve mund të kenë edhe përvojën e nevojshme.

Projektligji rregullon jo vetëm statusin e forcës rezervë dhe angazhimet, por edhe të drejtat individuale të pjesëtarëve, përcakton kushtet dhe kalimin nga forca rezervë në atë aktive dhe anasjelltas. Brenda vitit, siç është përcaktuar me ligj, pjesëtarët mund të shërbejnë 36 ditë, por në angazhimet jashtë vendit, në periudhën 3 vjeçare mund të shërbejnë edhe deri në një vit.

Po ashtu, është paraparë parimi i të drejtave të cilat i gëzojnë edhe pjesëtarët aktivë, që do të thotë trajtohen me të njëjtat ligje dhe rregullore, duke përfshirë në të vërtetë edhe të drejtën për punësim. Me qenë se janë të parapara stërvitjet për pjesëtarë rezervë, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës propozon që institucionet e edukimit të inkurajojnë që të zhvillojnë politika standarde për studentë rezervistë.

Vërejtjet e veçanta të grupit tonë janë se çështja e mobilizimit në nenin 8.2, përcaktohet nga dy autoritete, thotë se: “Mobilizimin mund ta bëjnë presidenti ose ministri, mund të urdhërojnë mobilizime”. Sipas mendimit tonë, duhet të jetë e qartë kur do ta bëjë këtë presidenti dhe ku ministri, ose duhet të caktohet njëri nga autoritetet, presidenti ose ministri i FSK-së.

Neni 8.5, përcakton nxjerrjen e Rregullores për angazhimin dhe mobilizimin e rezervës, por për t’u zbatuar këto dispozita saktë në praktikë, duhet të përcaktohet koha. Ne propozojmë që kjo kohë për nxjerrjen e rregullores nga Ministria e Forcës së Sigurisë të jetë 6 muaj.

E njëjta vlen edhe për nenin 9.2, që përcakton kushtet dhe procedurat e kalimit nga komponenti rezervë në atë aktiv dhe anasjelltas. Propozojmë që rregullorja nga Ministria të nxirret brenda 6 muajve. Këtë e konsiderojmë për shkak se mund të paraqitet nevoja imediate për shfrytëzimin dhe angazhimin e kësaj force.

Janë paraparë, gjithashtu, edhe gjjobat e caktuara në rast të shkeljes, të cilat ekzekutohen nga Inspektorati i Punës. Këto gjjoba janë 2000 deri në 5000 euro. Grupi Parlamentar i Aleancës mendon se duhet saktë të përcaktohet në cilin rast të shkeljeve përcaktohet niveli i gjjobës, në cilin rast të shkeljes do të jetë 2000 euro gjjoba dhe në cilat raste 5000 euro.

Në aspekt të pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së, realisht ky projektligj nuk përcaktohet me legjislacionin e BE-së me qenë se kjo është çështje e anëtareve të veçanta të shteteve të BE-së.

Në fund, shprehim brengosjen sidomos në aspektin e kostos së projektligjit. Ministri theksoi se ky projektligj kushton 7.1 milionë euro, por për vitin 2010 janë paraparë diku vetëm gjysmë milionë euro për angazhimet operative. Prandaj, do të thotë se për dy vitet tjera duhet të gjendet mënyra që brenda Kornizës afatmesme të shpenzimeve të sigurohet edhe sasia tjetër, gjegjësisht buxheti për t’u funksionalizuar kjo forcë.

Në parim, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, Gani, replikë, a!

GANI KOCI: Jo, si gjysmë replikë, zoti kryetar, vërtet po kemi problem në shqiptimin e akronimeve dhe meqë po na përcjell ky problem, është mirë të thuhet emërtimin e plotë, për shembull, Partia Demokratike e Kosovës ose Posttelekomi e tjera e tjera, sepse kemi PTK, PDK dhe kemi KTP dhe po i themi kështu, tani mund të ngatërrohemi në këto shkronja edhe mund t’u japim kuptime të ndryshme që vërtet s’dimë tani t’u gjejmë zgjidhje. Në rastin konkret, nuk di, po në këtë rast zonja Gjylnaze ose zonjusha Gjylnaze nuk e ka pasur me mua, më duket, me kënd, nuk e di.

KRYETARI: Kundër replikë, Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Zoti kryetar,

Mua më vjen mirë që Gani Koci një herë u pajtua me mua, për ku ta di sa vjet. Sido që të jetë, është një përparim. Ndërsa, unë e ceka që kolegu im Ramadan Avdiu, ndoshta pati të drejtë

Ganiu që tha se duhet të përmendet i gjithë akronimi Partia Demokratike, se më të vërtetë mua më tingëlloi sikurse deputetët e PTK-së dhe, unë, thjeshtë desha t'i ndihmoj kolegët. Faleminderit!

KRYETARI: Po, Trusti dhe PTK-ja janë bërë shumë tërheqës, tash, nuk kemi faj. Vazhdojmë. Në emër të AKR-së Suzan Novobrdaliu e ka fjalën. Unë e pata një shkresë. Mirë, fjalën e ka kryetari i grupit, deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!
Grupi Parlamentar i AKR-së e mbështet projektligjin në fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të LDD-së, deputetja Drita Maliqi.

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti kryetar!
Edhe Grupi ynë Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar me vëmendje të posaçme Projektligjin për komponentin rezervë të Forcave të Sigurisë të Republikës së Kosovës. Edhe ne, si Grup Parlamentar, e përkrahim në parim dhe kontributin tonë do ta japim në komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Zylfi Merxha e ka fjalën.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zoti kryetar i Parlamentit të Republikës së Kosovës, doktor Jakup Krasniqi, ju përshëndes juve edhe stafin e juaj, po ashtu ministrat që i kemi aty, na kanë zbukuruar çardakun!
Kur flitet për Forcat e Sigurisë të Republikës së Kosovës, duhet të qohem në këmbë, kemi 2500 ushtarë, njëri prej tjetrit më i bukur, më i ri, më i disiplinuar dhe kemi 800 pjesëtarë rezervë. Mirëpo, të gjithë janë, çka të duash, veç që nuk kanë shkuar deputetët e Parlamentit të Kosovës të shohin diçka që s'kanë parë kurrë dhe askund s'kanë për të parë çka ka ushtria jonë e Kosovës.

Ushtria jonë e Kosovës, janë çuditur edhe oficerët e NATO-s që punojnë me ta. Për atë, ky ligj është një ligj më i miri i cili deri më sot ka ardhur edhe e përshëndes. Pse e përshëndes? Sese në atë ligj askush nuk përmendi që ka 111 pjesëtarë të pakicave në atë ushtri, domethënë është ushtri e të gjithëve kosovarëve, jo vetëm e disave. Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit, deputet!
Në emër të SLS-së, deputeti Slobodan Petroviq e ka fjalën.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, predsedniče!
U ime Samostalne liberalne strane mi u načelu podržavamo predlog zakona.

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të Grupit për Integritet, Vladimir Todoroviç e ka fjalën.

VLADIMIR TODOROVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!
Parlamentarna grupa za Integraciju prihvatiće se ovaj zakon u celosti.

Diskutim i dorëzuar me shkrim

TEUTA HADRI: Forca e Sigurisë së Kosovës është institucioni i ri i shtetit të Kosovës, i krijuar pas pavarësisë së saj. Edhe pas dy viteve të pavarësisë së Kosovës, kjo forcë ende nuk ka arritur ta bëjë strukturimin dhe plotësimin e gjithë strukturës së saj si forcë sigurie e kompletuar e një shteti me të gjitha komponentet e saj si forcë sigurie e qytetarëve dhe e shtetit të Kosovës, siç i kanë forcat e sigurisë së shteteve tjera në botë.

Kompletimi i strukturës së saj si struktura përbërëse aktive rezerve nuk ka qenë i mundshëm për t'u bërë dhe vepruar si komponentë e plotë vepruese nuk ka qenë e mundur të veprojë pasi nuk ka pasur asnjë akt ligjor që rregullon këtë fushë të veprimtimit.

Projektligji për FSK-në, komponentin rezervë të FSK-së, rregullon një fushë të re të strukturës së FSK-së, si strukturë e re e veprimtimit brenda trupës së FSK-së, do të krijojë hapësirë veprimi dhe fushe më të gjerë veprimi, që me ligj do të sigurohej veprimtaria e saj dhe shtesën me një numër prej 800 trupave pjesëtarë si trupa rezervë.

Prandaj, me këtë akt ligjor dhe me miratimin e këtij ligji do të përcaktohen kushtet dhe të gjitha procedurat e nevojshme për t'i rregulluar të drejtat dhe përgjegjësitë e ushtarëve rezervë, statusin e tyre dhe përgatitjen e tyre për trajnim dhe mobilizim si pjesëtarë rezervë të FSK-së si pjesë përbërëse e plotë e saj.

Qeveria e Kosovës duhet t'i kushtojë rëndësi të veçantë kësaj strukture rezerve dhe vetë FSK-së si strukturë mbrojtëse e qytetarëve të Kosovës dhe shtetit të saj, si shtet i ri, për të garantuar jetën të qetë dhe siguri qytetarëve të saj.

Mendoj se buxheti dhe kostoja buxhetore për vitin 2010 dhe 2013 është caktuar 7.1 milion euro, ku kryesisht ky buxhet shërben për pagesën e 800 pjesëtarëve të FSK-së për 36 ditë, për ushqim, pajisje uniforma, municion, si dhe trajnime të ushtarëve. Ne, para një jave, si grup i deputetëve patëm rastin të bëjmë vizitë te FSK-ja. Me sytë tanë pamë se FSK-ja ka nevojë të madhe si për zgjerim dhe kompletim të strukturës së saj. FSK-ja ka dëshmuar për përgatitjen e saj, me kuadra të përgatitura gjatë ndihmës që ka dhënë me rastin vërshimeve në Shqipëri, ku me gatishmërinë e saj tregoi se është forcë serioze për të siguruar jetën e qytetarëve në raste emergjencash jo vetëm në Kosovë, por edhe për të ndihmuar jashtë Kosovës vendeve dhe qytetarëve tjerë që kanë nevojë. Për këtë pati edhe falënderime edhe nga përfaqësuesit ndërkombëtarë.

Prandaj, Qeveria duhet mendojë mirë dhe buxheti i FSK-së të rritet më shumë se është caktuar dhe paraparë me këtë projektligj dhe të bëhen shtesa dhe përmasime edhe në planin e shpenzimeve afatmesme

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë, shkojmë në votim, lus regjinë dhe deputetë të përgatiten për votim, votojmë tash:

Në sallë kemi 67 deputetë, kartela 80.

Konstatohet se me 63 vota "për", asnjë "kundër", asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për komponentin rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Në bazë të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë, si komision funksional, dhe komisionet e përhershme.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve, nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e radhës është pika gjashtë:

6. Shqyrtimi i parë i projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis

Në bazë të nenin 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim.

Ftoj ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zotin Mahir Yagcilar, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë projektligjin.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Nxjerrja e Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis është e nevojshme për faktin se me ligjin ekzistues shumë çështje nuk janë të përfshira, duke filluar nga përkufizimet, si dhe përafrimi me direktivën e Komisionit Evropian në fushën e politikës së mjedisit.

Projektligji ka për qëllim të adresojë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me krijimin e një strukture komplete gjithëpërfshirëse dhe përmbajtjesore të shtjelluar në projektligjin në fjalë për rregullimin e administrimit të resurseve mjedisore në harmoni me normat dhe direktivat e Bashkimit Evropian.

Propozimi për ndryshimin e Ligjit të tanishëm për vlerësimin e ndikimit në mjedis është bërë me qëllim të harmonizimit të ligjit me direktivat evropiane. Pas analizimit të ligjit të miratuar, është konstatuar se nuk është në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian, siç është neni 6.1 dhe 6.2, nuk dëshiroj të citoj.

Ndryshimi është propozuar me qëllim të delegimit të përgjegjësive edhe të nivelit lokal, përkatësisht delegimin e përgjegjësive te komunat, siç ishte paraparë me Ligjin e ri të mbrojtjes së mjedisit.

Propozimi për ndryshimin e Ligjit të VNM-së është bazuar dhe në rekomandimet e misionit homolog vlerësues mbi mjedisin, të përbërë nga dy ekspertë nga Komisioni Evropian.

Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis është i nevojshëm për të rregulluar procedurat për identifikim, vlerësim, raportim dhe administrim të ndikimeve mjedisore të një projekti të propozuar, me qëllim që të sigurohet konsiderimi i plotë i të gjitha informatave relevante mjedisore.

Ky ligj është në përputhje me rregulloret evropiane të kësaj fushë. Së bashku me aktet nënligjore që do të nxirren në bazë të këtij ligji, ofrohet bazë për zbatim të plotë të standardeve evropiane.

Të nderuar deputetë,

Sa i përket strukturës, ky ligj përmban 42 nene, 6 krerë me 3 shtojca teknike. Duke kaluar përmbajtjen e krerëve, dëshiroj të shtoj se ky draftligj ka 3 shtojca: Shtojca e parë përmban listën e veprimtarive dhe projektet të cilat duhet t'i nënshtrohen procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis, Shtojca e dytë përmban veprimtaritë dhe projektet të cilat duhet të nënshtrohen sipas rastit dhe kriteret nga shtojca 3. Shtojca 3 ka të bëjë me kriteret e përzgjidhjes së projekteve,

karakteristikat e projektit vendndodhja e zbatimit të projektit dhe karakteristikat e ndikimit të mundshëm.

Duke ju falënderuar për vëmendje, dëshiroj t'ju uroj të gjithëve edhe 5 Qershorin – Ditën e Mjedisit, e cila është nesër. Faleminderit!

KRYETARI: Urime edhe juve, ministër!
Kryetari i komisionit, deputeti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar kolegë deputetë,
Edhe pse ky projektligj pat marrë miratimin formal në mars të vitit të kaluar, është parë si nevojë e domosdoshme që vërtet ky projektligj të ndryshohet dhe në një masë mbi 40% është një ligj që është në harmoni me direktivat e Bashkimit Evropian dhe për shkak që ligji që tani ka ardhur në parlament, krijon mundësi të zbatimit praktik dhe është një ligj i kompletuar në të gjitha pikëpamjet.

Qëllimi i këtij projektligji është që të bëjë parandalimin apo zbutjen e ndikimeve negative të projekteve të propozuara, qofshin ato publike ose private. Andaj, ftoj deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta votojnë këtë projektligj, që koincidon me Ditën ndërkombëtare të ruajtjes së mjedisit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Selville Halimi e ka kërkuar fjalën.

SEVILLE HALIMI: Faleminderit, kryetar!
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,
Grupi Parlamentar i partisë Demokratike ka shqyrtuar Projektligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe e përkrah, në parim, me ndërhyrje që mendon se duhet të bëhen gjatë amendamentimit. janë në nenin 6, 7, 16 dhe 19. Megjithatë, kontributi do të jepet në komisionin funksional, në parim e përkrahim. Faleminderit!

KRYETARI: faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Myrvete Pantina e ka fjalën.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryetar!
Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës e ka shqyrtuar me kujdes këtë projektligj dhe mendojmë se i njëjti duhet të miratohet, në parim.

Ligji aktual i vlerësimit të ndikimit në mjedis, që rregullon këtë fushë, ka hyrë në fuqi në shkurt të vitit 2009, domethënë relativisht vonë, mirëpo pas konstatimit se ligji aktual nuk e mbulon në tërësi lëmin e administrimit të resurseve mjedisore dhe nuk janë përfshirë detyrimet që dalin nga Direktiva e BE-së 2003/35EC, atëherë ka lindur nevoja për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit ekzistues, kështu që para nesh kemi tani propozimin për këtë projektligj. Kontributin tonë do ta japim në kuadër të komisionit përkatës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Naim Maloku e ka fjalën.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar deputetë,

Ne e kemi shqyrtuar këtë projektligj. Mendoj se deputetët duhet ta dinë se ky projektligj në lexim të dytë ka kaluar më 12.2.2009, pra që është një ligj i ngjashëm ndikimi në mjedis. Pra, brenda këtij mandati Ministria na sjell dy herë ligjin e njëjtë në Kuvend, pavarësisht se ky dallon, ky që po e shqyrtojmë sot, ky projektligj dallon mbi 40% nga projektligji që është në fuqi. Pse e thashë këtë? E thashë për shkak se gjatë këtij mandati qeveritar, praktikisht Kuvendit të Kosovës i vjen dy herë një ligj në shqyrtim. Përveç kohës që e shpenzon Ministria, grupet punuese për hartimin e projektligjeve, kohës që e shpenzojmë ne deputetët për shqyrtim, normalisht edhe vetë Kosova është pa një ligj funksional.

Ia tërheq vërejtjen Ministrisë dhe Qeverisë që para se të vijnë ligjet në shqyrtim në parlament, të jenë të bindur se gjatë mandatit të tyre nuk do të ndryshojnë dhe nuk do të vijnë prapë ligjet e tilla dhe të njëjta në Kuvend.

Shumë prej parafolësve të mi, disa prej parafolësve të mi thanë se është ndryshimi dhe plotësimi, jo ligji e ka titullin Projektligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis, pra kështu na ka ardhur, ka ardhur si projektligj dhe jo si plotësim dhe ndryshim i ligjit ekzistues, që ne e kemi kaluar më 12. shkurt 2009, në lexim të dytë në këtë Kuvend.

Deputetët e Grupit Parlamentar të AAK-së do të votojnë sipas bindjeve të tyre personale. Faleminderit!

KRYETARI: faleminderit!

Në emër të Aleancës Kosova e Re, deputeti Heset Cakolli e ka fjalën.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar,

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis i ka kaluar diçka më shumë se një vit që është aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, por ka lindur nevoja që të ndryshohet ligji ekzistues sepse shumë çështje nuk kanë qenë të përfshira, si për shembull përkufizimet e nevojshme dhe përafrimet me Direktivën e Parlamentit Evropian nr. 2003/35.

Projektligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis ka gjithsej tani VII kapituj me 42 nene. Pra, këtij projektligji i është shtuar një kapitull me 5 nene dhe këto nene rregullojnë mbikëqyrjen inspektuese, ku janë specifikuar të drejtat, detyrat dhe autorizimet e Inspektorit për mbrojtjen e mjedisit.

Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar, do të thotë, këtë projektligj dhe i jep mbështetje, në parim, dhe kërkon që të procedohet në komision funksional dhe përmes anëtarëve tanë gjatë periudhës deri në leximin e dytë do të japim kontributin tonë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputeti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e mbështet, në parim, këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Zylfi Merxha e ka fjalën.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar doktor Jakup Krasniqi, kryetar i Parlamentit Republikës së Kosovës,
Përshëndes edhe stafin e juaj, po ashtu edhe ministrat!

Nuk dua ta zgjasë se kryetari i komisionit tonë, zoti Naseri tha shumë shkurt, ka qenë ligji para këtij ligji, i cili ka qenë shumë i prapambetur, tash është një ligj tepër i rregulluar, i cili është me parimet e Unionit Evropian dhe ne e mbështesim sepse ashtu një ligj s'e kemi pasur, e kemi thash. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Slobodan Petroviq, e ka fjalën.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, predsedniče!

I mi se pridružujemo ostalim političkim klubovima koji podržavaju u načelu ovaj predlog zakona. Zahvaljujem se !

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar për Integritet, Vladimir Todoroviq e ka fjalën.

VLADIMIR TODOROVIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

I naša Grupa za Integracije podržae u načelu ovaj zakon. Hvala!

KRYETARI: faleminderit!

Dhe, deputetja Gjylnaze Syla e ka fjalën, e fundit, nuk u pajtua me fjalën e Naimit.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kisha dashur me ministrin Yagcilar të debatoj lidhur me atë se në vitin e kaluar, zoti ministër, e kemi kaluar këtë Projektligj për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Dua të dijë, cilat dispozita nuk kanë funksionuar, që ju si ministër dhe Qeveri keni propozuar ligjin e ri. Sipas mendimit tim dhe vlerësimit, këto praktika të Qeverisë duhet të pushojnë që të sjellin ligje të reja. Qeveria duhet të mësohet të ndërtojë në atë çka ka, është dashur të sillni ndryshimin dhe plotësimin e projektligjit, në qoftë se keni gjetur se ligji nuk po funksionon, gjegjësisht dispozitat që i keni propozuar, realisht është kjo. Çka nuk ka funksionuar nga dispozitat e ligjit që është kaluar vetëm një vit më parë, a e keni mbikëqyrë mjaftueshëm që të propozoni projektligj të ri? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Shkojmë në procedurën e votimit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash:

Në sallë kemi 74 deputetë, 80 kartela.

Konstatohet se me 62 vota “për”, 6 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione.

- Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe komisionet e përhershme.

Komisioni duhet që brenda 2 muajve, nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës.

7. Rishqyrtimi i Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit

Në bazë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, 17 korrik 2008, dhe të Mocionit të miratuar më 3 tetor 2008, për procedim me ligjet e pashpallura, komisionet parlamentare kanë rishqyrtuar tekstin e Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar për miratim.

Kryetari i komisionit, po më duket se është këtu. Atëherë, vazhdojmë. Fjalën po ia jap deputetit Bajram Kosumi, anëtar i komisionit.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit! Unë po ju informoj që jam i autorizuar të flas në emër të komisionit, prandaj e kërkoja fjalën për këtë projektligj.

Unë dëshiroj vetëm t'ju njoftoj se komisioni ka bërë një punë jashtëzakonisht të madhe me këtë projektligj, diku ka mbajt rreth 9 takime për disa muaj radhazi e besoj se keni parasysh gjithë arsyet pse ka zgjatur kaq shumë puna, pse ka zgjatur dhe është punuar shumë në harmonizimin e disa neneve të këtij projektligji.

Fillimisht, dua të them se projektligji ka bazë juridike me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po ashtu, Divizioni për Buxhet dhe Pagesa i Kuvendit të Kosovës ka hartuar Raportin financiar për projektligjin, ka disa implikime buxhetore, por janë të përballueshme dhe janë të pranueshme. Ndërsa, projektligjin e kemi ndihmuar mendoj edhe me amendamentet që i ka propozuar komisioni, dy komisionet në fakt kanë bërë amendamente – edhe Komisioni për Legjislacion, por edhe Komisioni për Buxhet, janë të harmonizuara në shumicën e rasteve qëndrimet midis këtyre dy komisioneve. Në amendamentet e ofruara është liruar prej disa ngarkesave projektligji i propozuar. Unë po i përmend këtu vetëm disa prej çështjeve.

Është eliminuar trajtimi i veçantë shëndetësor për deputetët, do të thotë nuk kemi lejua asnjë përjashtim në trajtimin shëndetësor të deputetëve me qytetarë të tjerë të Republikës së Kosovës, ose shembulli tjetër, janë eliminuar lehtësirat doganore që kanë qenë të parapara me projektligjin e propozuar, do të thotë deputeti iu nënshtrohet të gjitha kontrolleve doganore sikurse çdo qytetarë tjetër. Po ashtu, është zvogëluar propozimi për pensionin suplementar nga ai që ka qenë në projektligj.

Por, unë kisha dashur ta tërheq vëmendjen tek neni 23, amendamenti 20, për të cilin kemi pasur shumë diskutime në komision dhe nuk ka pasur një qëndrim unik, ka pasur mendime të ndara rreth këtij neni dhe amendamenti. Dhe, këtë po dua vetëm t'ua tërheq vëmendjen edhe juve, si kryetar, edhe deputetëve, që të shikojmë qysh do të votojmë te ky amendament.

Unë i ftoj deputetët e Kuvendit që ta miratojmë Projektligjin dhe amendamentet e propozuara nga të dy komisionet. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, asnjë “kundër” 2 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, 2 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 71 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 68 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 68 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 66 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 65 vota “për”, 1 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 68 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Po ju tregoj që i kemi 2 amendamente dhe të 2-at votojmë, cili të marrë vota më shumë, shkon. Fillimisht, votojmë amendamentin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 55 vota “për”, 3 “kundër” dhe 4 abstenime, votohet amendamenti 12 i propozuar nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Dhe, e kemi amendamentin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, pa mbështetjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Votojmë tash:

Për këtë amendament votuan 28 vota “për”, 12 “kundër” dhe 10 abstenime.

Do të thotë, shkon varianti i amendamentit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Amendamenti 13.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, 2 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Ky amendament është i Komisionit për Buxhet dhe Financa, pa mbështetjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 47 vota “për”, 8 “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 68 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 65 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 61 vota “për”, 2 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “për”, 2 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “për”, 3 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Për shkak edhe të korrektesisë, sepse e përmendi deputeti Kosumi edhe rezultatin nga puna që është bërë në Komision. Sigurisht, po prononcohem edhe vetë për këtë amendament, është mendim edhe i Grupit Parlamentar të LDK-së që të mbetet neni 23, ashtu siç është në ligj, duke njohur statusin e deputetëve të legjislaturave të viteve '90, domethënë edhe vitin 2000. Faleminderit!

KRYETARI: Shkojmë në votim, votojmë amendamentin e komisionit.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 33 vota “për”, 29 “kundër” dhe 7 abstenime, kalon amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “për”, 1 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Votojmë tash, por edhe tash kemi variantin “a” dhe “b”. Fillimisht, votojmë për variantin “a”.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 60 vota “për”, 3 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 22, varianti “a”.

Votojmë edhe për variantin “b”,

Në Rregullore është që duhet të votojmë dhe cili merr më shumë, shkon. Votojmë tash:

Konstatohet se me 29 “për”, 15 “kundër” dhe 11 abstenime, do të thotë shkon varianti i parë “a”, jo varianti i dytë “b”.

Amendamenti 23.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, 1 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, 2 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25.

Ky amendament i ka dy variante. Fillimisht varianti “a”, propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, pa mbështetjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

(Reagime)

Më falni, se e kanë ngatërruar këtë, atëherë. Varianti i parë është propozimi i Komisionit për buxhet dhe Financa, i mbështetur nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi. Urdhëro, Gani Koci e ka fjalën!

GANI KOCI: Zoti kryetar, është puna se kush mund ta trashëgojë ose të përfitojë nga pensioni suplementar nga trashëgimtarët. Ne kemi shkuar me variantin se e përfitojnë fëmijët deri në moshën 22 vjeçare, në qoftë se dëshmojnë se janë në shkollim, dhe jo si ka qenë deri në moshën 18 vjeçare. Është gjithkund që të ndihmohen ata që dëshmojnë që janë në shkollim deri në moshën 22 vjeçare. Unë mendoj që duhet të jetë ky variant dhe të mos ngelet varianti deri në moshën 18 vjeç, si ka qenë propozimi.

KRYETARI: E votojmë propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, i mbështetur nga Komisioni për Legjislacion, variantin “a”.

Votojmë tash:

Konstatohet se për variantin “a” votuan 48 “për”, 11 “kundër” dhe 4 abstenime.

Votojmë variantin e dytë, që e tha deputeti Gani Koci.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, 8 “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet varianti i dytë. Rregullorja është te unë, unë shkoj sipas rregullores.

Amendamenti 26.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 74 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 71 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 71 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 29.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 30.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, 7 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 30.

Amendamenti 31.

Vërejtje nga Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit!

Zoti kryetar, unë bashkë me kolegun, Arsim Bajrami, propozojmë një amendament të ri, neni 32.2 të jetë kështu: “Deputeti i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ish deputeti që merr pensionin suplementar, është i pajisur me sigurimin shëndetësor”. Ky është formulimi që e propozoj unë, bashkë me deputetin Arsim Bajrami. Kërkoj deklaram, sipas Rregullores, të grupeve, si të donë.

KRYETARI: Deputeti, Gani Koci e ka fjalën.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kjo ka qenë një çështje të cilën e kanë trajtuar dy komisionet. Ju e dëgjuat edhe zotin Kosumi, në emër të Komisionit për Legjislacion, dhe vërtet në parim, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka qenë për këtë komponent të këtij stimulimi ose të këtij pensioni suplementar që deputetët, edhe ata që janë aktiv, po edhe ata që e gëzojnë këtë të drejtë, të kenë edhe sigurimin shëndetësor, krahas kësaj. Mirëpo, për shkak edhe të implikimeve të mundshme buxhetore, ndoshta ne jemi tërhequr nga kjo e drejtë dhe prandaj kemi lënë që vërtet Komisioni funksional, Komisioni për Legjislacion të dalë me variantin e vetë dhe është çështje e Kuvendit se si do të duhej të vendoset rreth këtij propozimi. Në parim, unë mendoj se kjo duhet të shkojë bashkërisht me sigurimin shëndetësor, qoftë të deputetëve aktivë ose të atyre që e gëzojnë të drejtën e pensionit suplementar.

KRYETARI: Faleminderit!

Në nenin 57.5 thotë: “Propozimi i amendamenteve që kanë implikime buxhetore i dërgohet Komisionit për Buxhet dhe Financa, i cili duhet të deklarohet në raport, në afat prej 5 ditëve pune nga dita e pranimi”. Do të thotë, amendamenti me Rregullore nuk shkon.

Votojmë amendamentin 31, të komisionit.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 52 vota “për”, 11 “kundër” dhe 7 abstenime, miratohet amendamenti 31.

Amendamenti 32.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 60 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 32.

Amendamenti 33.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 33.

Amendamenti 34.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 34.

Amendamenti 35.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota “për”, 1 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 35.

Amendamenti 36.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 72 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 36.

Amendamenti 37.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 73 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 37.

Amendamenti 38.

Janë dy propozime.

I pari, është i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 61 vota “për”, 5 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet varianti i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Tash votojmë edhe për variantin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 38 “për”, 12 “kundër” dhe 10 abstenime, shkon varianti i parë.

Dhe, kështu kemi votuar për amendamentet. Tani është radha për ta votuar Ligjin në tërësi.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash:

Në sallë kemi 80 deputetë.

Konstatoj se me 74 vota “për”, 2 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit. Ia pafshi hairin!

Pika e radhës:

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për hetimin parlamentar

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për hetimin parlamentar dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë në votim të amendamenteve, ftoj kryetarin, po më duket s’po do ta marrë fjalën! Atëherë, shkojmë në procedurën e votimit.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 74 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 70 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 71 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 73 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 72 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 68 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 72 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 68 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 71 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10, i fundit.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 69 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 10.

Dhe, tani votojmë ligjin në tërësi.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 74 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet Ligji për hetimin parlamentar.

Tani kemi pikën e fundit të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

A e do fjalën kryetari i komisionit? Në emër të komisionit ftoj deputetin Ramadan Gashin, që ta marrë fjalën.

RAMADAN GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Para vetes besoj që i keni dy raporte dhe për atë u paraqita që ta marrë fjalën. Kemi raportin e parë, ku kemi përfshi amendamentimin e Ligjit me 9 amendamente, të cilat nuk janë shumë

përmbajtjesorë, por kryesisht çështje formulimi dhe kemi një raport, sot që e bëmë, për arsye se në nenin 5, në paragrafin 3, Zyra e ICO-s ka bërë vërejtje dhe pas shqyrtimit të sotshëm që bëmë prapë si komision, konstatuam se vërtet edhe ky paragraf nuk ka nevojë të jetë për arsye se në pjesën e parë e citon Kushtetutën, për barazinë e gjuhëve, në pjesën e dytë sikur e qet pak në kundërshtim me pjesën e parë dhe ky tekst ka qenë i ardhur kështu nga hartuesi i ligjit. Ne, si komision, ditën e parë kemi pasur dilema, por e patëm lënë duke menduar se në rast të paqartësive në mes të dy gjuhëve, mund të kontribuojë, por me sqarimet që u bënë më vonë, erdhëm deri te përfundimi se në rast të paqartësive, është Gjykata Kushtetuese ajo e cila bën interpretimin dhe si komision përkrahëm këtë propozim.

Andaj, rekomandimi i komisionit është që të përkrahet propozimi që neni 5 të mbetet vetëm me një paragraf, me paragrafin e parë.

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë, vazhdojmë.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 68 vota “për”, 2 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Do të thotë, votojmë rekomandimin e sotshëm, votojmë nenin 5, sipas raportit qysh është sot.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, 6 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Propozimi i deputeti të Grupit të KDTP, me mbështetjen e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, 1 “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 68 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 68 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7, i ka dy variante

I pari është i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet varianti i parë i amendamentit.

Votojmë edhe variantin e dytë të amendamentit të deputetit Riza Smaka, pa mbështetjen e Komisionit.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 27 vota “për”, 20 “kundër” dhe 8 abstenime, shkon varianti i parë.

Amendamenti 8, i fundit,

Votojmë tash:

Konstatohet se me 73 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 8.

Tani votojmë ligjin në tërësi.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 76 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për “Gazetën zyrtare” të Republikës së Kosovës.

Me këtë e kemi përfunduar seancën e sotme. Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve